

2017

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE



Raporti Vjetor i Veprimtarisë 2017

Tiranë, Prill 2018

Ky dokument përbën Raportin Vjetor të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2017 dhe i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë si insitucioni ndaj të cilit AKEP është përgjegjës për punën e tij .

Veprimtaria e AKEP për vitin 2017 është bazuar dhe udhëhequr në drejtim të plotësimit të rolit, funksioneve dhe objektivave rregullatore të përcaktuara në legjislacionin material për komunikimet elektronike dhe postare dhe zbatimit të politikave të zhvillimit sektorial, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Objektivat e AKEP për vitin 2017 ishin paraqitur në raportin vjetor të vitit 2016 dhe u plotësuan me rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë drejtuar AKEP nëpërmjet Rezolutës së miratuar më datë 04.05.2017 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2016”.

Ky dokument përbëhet nga 6 kapituj dhe në fillim të tij përmban një përmbledhje të informacionit të dhënë në këtë Raport Vjetor.

Kapitulli 1 përmban zhvillimet kryesore në tregun e komunikimeve elektronike në lidhje me shërbimet e ofruara nga operatorët dhe përdorimin e tyre, masat rregulluese nëpërmjet analizave të tregut, dhe punën e AKEP gjatë vitit 2017 në lidhje me administrimin dhe monitorimin e frekuencave, numeracionit si dhe veprimtarinë inspektuese të AKEP për komunikimet elektronike.

Kapitulli 2 përmban një përshkrim të zhvillimeve në tregun postar si dhe veprimtarinë inspektuese të AKEP për shërbimet postare.

Kapitulli 3 përmban informacion për rolin e AKEP për mbrojtjen e konsumatorëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, duke u fokusuar në punën e AKEP për ndryshimet e rregullave të portabilitetit të numrit dhe afatit të ofertave 28/30 ditore të operatorëve celularë.

Kapitulli 4 përmban Statusin e Shërbimit Universal për komunikimet elektronike dhe postare.

Kapitulli 5 përmban informacion mbi menaxhimin dhe kontrollin e brendshëm të AKEP dhe realizimin e treguesve financiare të AKEP.

Raporti mbyllet me Kapitullin 6 që përmban një përmbledhje të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AKEP për vitin 2018, dokument i cili u përgatit dhe u publikua nga AKEP në fund të vitit 2017.

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE	4
1. TREGU I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE.....	11
1.1 ZHVILLIMET E TREGUT	12
1.1.1 Të ardhurat dhe Investimet	12
1.1.2. Shërbime të rrjeteve celulare	16
1.1.3 Shërbimet nga rrjetet fikse	25
1.1.4 Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës	30
1.2 RREGULLIMI I TREGJEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE.....	32
1.2.1 Ankimet për Analizën e tregjeve me shumicë të aksesit broadband	32
1.2.2 Analiza e tregut me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare	33
1.2.3. Analiza e tregjeve me shumicë të telefonisë fikse.....	35
1.3 SISTEMI I AUTORIZIMEVE, ADMISNITRIMI I BURIMEVE TË FUNDME DHE DOMAINIT	37
1.3.1 Regjimi i autorizimeve të përgjithshme	37
1.3.2 Spektri i frekuencave	38
1.3.3 Numeracioni.....	43
1.3.4 Administrimi i domain cc.TLD.al dhe nëndomanët e tij.....	44
1.4 INSPEKTIMI DHE MONITORIMI I SPEKTRIT TE FREKUENCAVE.....	47
1.4.1 Inspektimi i operatorëve të komunikimeve elektronike.....	47
1.4.2 Monitorimi i përdorimit të frekuencave	48
1.4.3 Përmirësimi i mbulimit me sinjal celular në zonat turistike	49
1.4.4 Zhvillimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimi i të drejtës së kalimit.....	50
1.4.5 Projekti “Sistemi kombëtar i monitorimit të spektrit të frekuencave për Shqipërinë”	51
1.4.6 Sistemi i përqëndruar i informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike	52
1.4.7 Kontrolli për sigurinë e rrjeteve	53
2 TREGU I SHËRBIMEVE POSTARE	56
2.1 Ecuria e volumit të shërbimeve postare.....	56
2.2 Të ardhurat dhe investimet në tregun postar	59
2.3 Inspektimi dhe monitorimi i veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare	60
3 MBROJTJA E KONSUMATORIT	62
3.1 Transparenca dhe lehtësia e krahasimit të tarifave	62
3.2 Afati i përdorimit të ofertave mujore (30 ditore) v 28 ditore	62
3.3 Ndryshimet në rregulloren e portabilitetit.....	63
3.4 Ankesat e përdoruesve.....	64

4	RAPORTI PËR STATUSIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL	66
4.1	STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE	66
4.1.1	Propozimi i KE për rishikimin e kuadrit rregullator	66
4.1.2	Përvoja nga implementimi i SHU në vendet e BEREC	68
4.1.3	Përballueshmëria e tarifave: Raportet e ITU 2015-2017	68
4.1.4	Përfundimi i AKEP për Rishikimi i objektit të SHU	70
4.2	STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR	71
4.2.1	Tregues të volumit dhe cilësisë së shërbimit universal postar	72
4.2.2	Tregues të rrjetit dhe shërbimit universal postar	73
4.2.3	Cilësia/standartet e shërbimit universal postar	74
5	MENAXHIMI, KONTROLLI I BRENDSHËM DHE TREGUESIT FINANCIARË TË AKEP	79
5.1	Menaxhimi dhe kontrolli i brendshëm	79
5.2	Raporti për realizimin e treguesve financiare vjetorë të AKEP	81
6	STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT TË AKEP PËR VITIN 2018	88

PËRMBLEDHJE

AKEP ushtron veprimtarinë si organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar sipas përcaktimeve të parashikuara në Ligj nr. 9918, datë 19. 05. 2017 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligj nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Raporti Vjetor i veprimtarisë së AKEP për vitin 2017, i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë si insitucioni ndaj të cilit AKEP është përgjegjës për punën e tij.

Zhvillime të tregut të komunikimeve elektronike

Tregu i komunikimeve elektronike gjatë vitit 2017, ka shënuar zhvillime të rëndësishme të cilat kanë efekte të ndjeshme tek konsumatorët, gjithashtu edhe tek ofruesit e këtyre shërbimeve. Një nga ndryshimet kryesore të ndodhura në tregun celular ishte transferimi i të drejtave të përdorimit të radiofrekuencave nga Plus Communications tek Vodafone Albania dhe Telekom Albania dhe po ashtu mbyllja e aktivitetit të ofrimit të shërbimeve celulare nga Plus Communication më datë 31.12.2017.

Pas një periudhe me të ardhura të qëndrueshme të sektorit në 2014-2016, në vitin 2017 u vu re një rënie e ndjeshme e të ardhurave nga komunikimet elektronike, e cila vlerësohet të jetë shkaktuar kryesisht nga rënia e të ardhurave të shërbimeve me shumicë të operatorëve celularë. Të ardhurat totale të sipërmarrësve nga komunikimet elektronike për vitin 2017 vlerësohet¹ të jenë 37 miliardë lekë, që përbën një reduktim me rreth 13% në krahasim me vitin 2016, kur të ardhurat ishin rreth 42.4 miliardë lekë.

Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve në rrjetet celulare u reduktuan me 12% ndërsa të ardhurat nga rrjetet fikse u reduktuan me 14%. Të ardhurat totale nga shërbimet me pakicë në rrjetet celulare në vitin 2017 arritën në 17.2 miliardë lekë, që përbën një rritje të vogël me 0.4%. Rënia më e madhe e të ardhurave të operatorëve celularë ka ndodhur në të ardhurat e shërbimeve me shumicë, ku të katër operatorët kanë shënuar rënie të ndjeshme. Turrja e ndjeshme e të ardhurave me shumicë ka ardhur kryesisht për shkak të rënies së madhe të trafikut hyrës ndërkombëtar (rreth 44%) dhe rrjedhimisht të të ardhurave nga terminimi i këtyre thirrjeve (rreth 3.4 miliard lekë), duke ndikuar negativisht edhe në nivelet dhe normat e fitimit të operatorëve celularë, për shkak të peshës së lartë të këtyre të ardhurave në të ardhurat totale dhe fitimet e kompanive celulare. Rënie të ndjeshme të trafikut hyrës ndërkombëtare dhe të ardhurave nga terminimi dhe tranzitimi i këtyre thirrjeve ka pësuar edhe Albtelecom si operator rrjeti fikse.

Ecuria e investimeve në rrjete celulare tregon se në dy vitet e fundit ka pasur një rënie të ndjeshme të investimeve, e ndikuar edhe nga diz-investimet e Plus (shitja e asetëve). Duke hequr efektin e Plus rezulton se investimet e tre operatorëve në infrastrukturë rrjeti celular u

¹ Të dhenat financiare për vitin 2017 në këtë raport janë sipas të dhënave të deklaruara nga 4 operatorët kryesorë dhe me vlerësim nga stafi i AKEP për operatorët alternativë të rrjeteve fikse, të dhënat e të cilëve janë objekt saktësimi në kohën e përgatitjes së këtij raporti.

reduktuan me rreth 2.6 miliardë lekë në 2016 dhe u rritën me 892 milionë lekë në 2017. Ndëkohë investimet e Albtelecom në infrastrukturë rrjeti fiks në dy vitet e fundit ishin në nivel 730-740 milionë lekë/vit.

Numri i përdoruesve aktivë (përdorim në 3 muajt e fundit të vitit) të telefonisë celulare në vitin 2017 arriti në rreth 3.2 milionë që përbën një rënie me 5.9% në krahasim me vitin 2016. Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në Internet të paktën një herë gjatë vitit 2017 ishte rreth 3.3 milionë, ndërsa numri i përdoruesve aktivë (përdorim të Internetit në tre muajt e fundit) ishte rreth 2 milionë, që përbën rritje vjetore me 22.2% dhe 17.6% respektivisht. Penetrimi për popullsi i përdoruesve aktivë celularë të aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G në fund të vitit 2017 arriti në 72% krahasuar me 60% në fund të vitit 2016.

Në vitet 2016-2017 vihet re një rritje e ndjeshme e trafikut hyrës kombëtar në rrjetet celulare (efekti i masës rregulluese të mos-diskriminimit në thirrjet on-net/off-net) dhe përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband (efekti i fillimit të ofrimit të shërbimeve 4G). Numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband celular ka rritje vetëm me 65% në 2013-2017, por volumi i të dhënave është rritur më shumë se 18 herë gjatë kësaj periudhe. Rritje të ndjeshme këta tregues kanë patur edhe në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, ku numri i përdoruesve të shërbimeve 3G/4G është rritur me 20%, ndërsa volumi i të dhënave është dyfishuar. Rënie të ndjeshme ka pasur terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, me 44% në vitin 2017 krahasuar me vitin paraardhës, por me një rënie rreth 4 herë në krahasim me vitin 2013.

Gjatë vitit 2017, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 160 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 34 mesazhe SMS në muaj dhe ka konsumuar rreth 2.06 GB në Internet broadband. Për këtë konsum mesatar një përdorues aktiv celular ka paguar mesatarisht 509 lekë/muaj (me TVSH) dhe rreth 3.12 lekë/minutë (me TVSH).

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2016 ishte rreth 248 mijë, ndërsa në 2017 arriti në rreth 244 mijë, që përbën një rënie me 2%. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2017 arriti në 8.6%, që është shumë më e ulët se vendet e zhvilluara (rreth 40%), rreth dy herë më e ulët se mesatarja botërore (15.2%), madje më e ulët edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%).

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pasur reduktim të ndjeshëm në 5 vitet e fundit, shërbimet e aksesit broadband nga rrjete fikse kanë pasur rritje të qëndrueshme vjetore gjatë kësaj periudhe kohore. Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2017 arriti në rreth 294 mijë, që përbën një rritje me rreth 10.5% në krahasim me vitin 2016. Në vitin 2017 norma e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse ishte 37.2% për familje dhe 10.4% për popullsi. Megjithëse numri i pajtimtarëve me akses broadband është në rritje të qëndrueshme, normat e penetrimit janë shumë më të ulëta se në vendet e BE-së dhe të rajonit.

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2017 arriti në rreth 198 mijë, rreth 6.5 % më shumë se në vitin 2016. Në vitin 2017 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin

67% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 34% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

Teknologjia mbizotëruese për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse është DSL e ndjekur nga kabllor koaksial. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuara fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Shpejtësia më e përdorur për akses broadband fikse është 4-10 Mbps me 63% në 2017. Të dhënat tregojnë se proporcioni i pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi më të ulët se 4 Mbps ka ardhur në rënie ndërsa për shpejtësi mbi 4Mbps ka ardhur në rritje.

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918, dhe Rregullores “Për Analizën e Tregut”, gjatë vitit 2017 u fokusua në shqyrtimin e ankimeve administrative për analizën e tregjeve me shumicë të aksesit broadband, përfundimin e procesit të “Analizës së tregut celular” që ishte nxjerrë në këshillim publik në Dhejtor 2016 dhe kryerjen e procesit të analizës së tregut të telefonisë fikse (Këshillim Publik).

AKEP me Vendimet Nr.4 dhe 5, datë 16.02.2017 shqyrtoi ankimet e Altelecom për Vendimet 2701 dhe 2702, datë 22.12.2016, për FNT dhe masat rregulluese, duke mospranuar kërkesat e Altelecom për ndryshimin e këtyre vendimeve. AKEP me Vendimin nr.13, datë 4.05.2017 kreu shqyrtimin e ankimit të Altelecom për vendimet 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016, duke pranuar pjesërisht kërkesën e Altelecom për ndryshimin e këtyre vendimeve. Procesi i shqyrtimit të këtij ankimi dhe vendim-marrjes së AKEP u krye nëpërmjet Këshillimit Publik.

AKEP me vendimin Nr.2699, datë 1.12.2016, miratoi nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*” dhe me Vendimin nr. 2700, datë 22.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*”. Këshillimi publik për të dy dokumentat përfundonte me 7.02.2017 dhe kjo periudhë u zgjat pas pranimit të kërkesës së Vodafone Albania për shtyrje të procesit për shkak të negociatave midis operatorëve celularë për transferimin e radio-frekuencave të operatorit Plus Communication, e cila pritej të sillte dhe një ndryshim në strukturën e tregut celular si dhe në qëndrimet e operatorëve celularë për dokumentat e nxjerrë në këshillim publik nga AKEP.

Procesi i transferimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication përfundoi me miratimin nga Autoriteti i Konkurrencës (AK) më 23.11.2017 dhe AKEP më 13.11.2017 dhe 1.12.2017 të kërkesës së këtij sipërmarrësi dhe sipërmarrësve të tjerë të përfshirë në proces. AKEP pas përfundimit të këtij procesi i kërkoi sërish operatorëve celularë Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Altelecom që në vijim të përfundimit të procesit të konsolidimit të tregut celular, të depozitojnë komentet finale në lidhje me dokumentat e nxjerrë në Këshillim Publik në Dhjetor 2016. Pas marrjes së komenteve finale, AKEP me vendimin Nr.11 datë 22.02.2018 miratoi dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*” dhe me Vendimet nr.12, 13 dhe 14, datë 22.02.2018 përcaktoi tre sipërmarrësit me FNT në tregjet përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet individuale celulare, duke vendosur dhe masat rreguluese përkatëse.

Duke reflektuar zhvillimet në treg gjatë vitit 2017, si dhe ndryshimin e strukturës së tregut nga 4 në 3 operatorë dhe rritjen e indeksit të përqëndrimit të tregut, impakti i masave rregulluese dhe proporcionaliteti i tyre etj, AKEP me miratimin e dokumentit përfundimtar të analizës së tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, vendimeve përkatëse për FNT si dhe masat rregulluese për terminimin e thirrjeve kombëtare, vendosi të nisë dy procese të reja këshillimi publik për “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik nr.2.” dhe “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare - Këshillim Publik”. Afati i Këshillimit Publik të dokumentit për tarifatat e terminimit celular ishte 30 ditë dhe përfundoi më datë 29.03.2018. Ndërsa afati i Këshillimit Publik për dokumentin e analizës së re të tregut celular është 2 muaj (sipas nenit 34 të ligjit 9918) dhe përfundon më datë 28.04.2018

AKEP me Vendimin nr.28, datë 27.12.2017 miratoi nxjerjen në Këshillim Publik të dokumentit: *Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse– Këshillim Publik*. Proçedura e këshillimit publik për dokumentin e analizës së tregut si dhe masave rregulluese të propozuara për FNT, përfshirë rregullimin e tarifave me shumicë për FNT, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës, u krye për një periudhë 2 (dy mujore) dhe përfundoi me datë 28.02.2018.

AKEP me Vendimet Nr.21, datë 30.03.2018 miratoi versionin final të dokumentit të analizës së tregut dhe me Vendimet Nr.22-24 përcaktoi Altelecom, Telekom Albania dhe 67 operatorë Alternativë të rrjeteve fikse si sipërmarrës me FNT për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet e tyre individuale fikse. Në lidhje me metodën e rregullimit të tarifave, AKEP me vendimin nr.25, datë 30.03.2018 miratoi nxjerjen në këshillim publik të dokumentit: *Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendodhje fikse – Këshillim Publik*. Periudha e këshillimit publik për këtë dokument mbyllet më datë 7.05.2018.

Brezi 800 MHz (790-862 MHz) ose ndryshe i quajtur DD1 (Digital Divident 1) me gjithë përcaktimin e vendosur në Planinin Kombëtar të Frekuencave për përdorimin e tij nga operatorët celularë si dhe afatin e parashikuar (30.62017) për kalimin e administrimit të tij nga AMA tek AKEP edhe gjatë vitit 2017 vazhdoi të ishte nën administrimin e AMA deri në përfundimin e procesit të kalimit nga transmetime analoge në transmetime dixhitale. Pas përfundimit të këtij procesi ky brez pritet të bëhet i disponueshëm për futjen e shërbimeve të lëvizshme, nën administrimin e AKEP. Aktualisht, me kërkesë të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, AKEP ka nisur një proces të ri këshillimi publik me palët e interesuara, i cili përfundon në muajin Prill 2018, për të mundësuar dhënien e këtij brezi në përdorim nga operatorët celularë për ofrimin e shërbimeve LTE ose siç njohën ndryshe si shërbimet 5G.

Në vitin 2017 AKEP ka kryer gjithsej 69 inspektime tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm. Gjatë këtyre inspektimeve u konstatua se 40 sipërmarrës ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm (të cilëve ju lanë disa detyra dhe

rekomandime), dhe 12 sipërmarrës nuk kishin zbatuar rregulloret e miratura nga AKEP dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative me gjobë dhe 17 sipërmarrës u çregjistruan sipas ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Gjatë vitit 2017 u arrit të bëhet një përmirësim i rrjeteve me tela në qytetet kryesore të vendit, ku u shmangën rrjetet e komunikimeve elektronike nga rrjetet e energjisë dhe në shumicën e rrugëve kryesore dhe qendra tashmë kanë përfunduar ose është në proces përmbyllja e shmangieve.

AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me AMA-n për marrjen e masave ndaj subjekteve *broadcast* që shkaktojnë interferenca. Njëkohësisht është koordinuar me veprime të përbashkëta me Ablcontrol për mbajtjen në kontroll të brezit të frekuencave, të cilat përdoren për shërbime radionavigimi.

Me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimit broadband në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas marrëveshjes së arritur midis operatorëve mobile përkatësisht: Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albelecom, gjatë vitit 2017 u kryen matje në disa prej zonave turistike dhe do të kryhen matje përgjatë vitit 2018 për verifikimin e tyre sipas specifikimeve përkatëse. Zonat për investime të përbashkëta të operatorëve mobilë për shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve GSM/UMTS/LTE janë Vermosh Qendër, Valbona Qendër, Gërmenj, Kepi i Rodonit, Shkopet, Grykë Nokë. Ndërsa zona për bashkëpunim midis operatorëve mobile për shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve GSM/UMTS/LTE janë: Qafë Shtama, Lura Fshat, Qafa e Vishës, Thethi, Gorica, Tri Porti (Vlorë). Një ndër shkaqet e shtrirjes së verifikimit përgjatë vitit 2018 të marrëveshjes së operatorëve mobile në Republikën e Shqipërisë për zonat e mësipërme është bërë vonesa e marrjes së lejes së ndërtimit të stacioneve nga autoritetet lokale.

Gjatë vitit 2017 ka vijuar bashkërendimi i veprimeve me të gjithë aktorët e interesuar për shkëmbim i informacioni për rrjetin e komunikimeve elektronike. AKEP ka bashkëpunuar me ministrinë përgjegjëse në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 120/2016 për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit.

Sektori postar

Në sektorin e shërbimeve postare ushtrojnë aktivitet Posta Shqiptare si dhe 11 operatorë të tjerë të pajisur nga AKEP me “Çertifikatë të Konfirmimit të Njoftimit” për ofrimin e shërbimeve postare, disa prej të cilëve janë filiale të kompanive të mëdha postare ndërkombëtare si DHL, TNT et.

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2017 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 25 milionë. Numri i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare gjatë vitit 2017 është rritur me rreth 7 % ndërsa numri i përgjithshëm i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ka pësuar një rritje me 2% krahasuar me vitin 2016. Posta Shqiptare sh.a vazhdon të ruajë pozicionin e saj dominues në tregun e shërbimeve postare, duke zënë rreth 94 % të tregut të shërbimit postar kundrejt 6 % që zënë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare. Disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve

postare, në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë: 8.66 objekte postare/banorë; 3,189 banorë për zyrë postar dhe një zyrë postare në 31.94 km².

Të ardhurat në tregun postar rezultojnë të jenë 2,3 miliardë Lekë, duke u rritur me 10% në krahasim me vitin 2016. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,3 miliardë lekë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total rreth 1 miliardë lekë. Pjesa tregut në të ardhura të Postës Shqiptare në vitin 2017 ishte rreth 58% që është shumë më e ulët se pjesa e tregut në volumin e objekteve postare prej 94%. Në vitin 2017 totali investimeve në sektorin postar ishte 251 milionë lekë, me një rritje prej 10%, që është e njëjtë me normën e rritjes së të ardhurave në krahasim me vitin 2016.

Mbrojtja e konsumatorit

Në tregun celular në dy vitet e fundit janë vërejtur disa praktika që kanë dëmtonuar interesin e konsumatorit. Ndër këto ndryshime janë dhe ndryshimet e aplikuara nga Albtelecom, Telekëom Albania dhe Vodafone Albania në Mars 2016 duke reduktuar afatin e përdorimit të ofertave mujore nga 30 ditë në 28 ditë. AKEP po bashkëpunon edhe me AK dhe me Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit, pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe qëndrimi zyrtar i AKEP për këtë çështje është që operatorët duhet të rikthejnë kohëzgjatjen mujore (30 ditore) të vlefshmërisë së paketave tarifore celulare standard *bundle* me parapagim 28 ditore.

KD i AKEP bazuar në problematikat për portabilitetin e numrave në rrjetet celulare, të evidentuara nga ankesat e konsumatorëve, nga mediat si dhe nga sistemi i bazës së të dhënave (përqindje shumë e lartë e refuzimeve të portimeve të numrave celularë), me Vendimin Nr.26, datë 21.12.2017, vendosi nxjerrjen në këshillim publik të disa ndryshimeve në Rregulloren Nr.43 për portabilitetin e numrave. Ndryshimet e propozuara nga AKEP synojnë lehtësimin dhe optimizimin e procesit të portimit të numrave për konsumatorët. Ndër ndryshimet kryesore të propozuara nga AKEP janë: përdorimi i Numrit Personal të Identifikimit si kriteri kryesor i identifikimit të pajtimtarit për procesin e portimit, heqja si kriter refuzimi i kërkesës për portim i mospërputhjes së emrit/mbiemrit të pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit dhënës me atë në kërkesën për portim tek operatori marrës, vendosja e afateve të qarta për operatorin dhënës dhe marrës për procesin e portimit, si dhe kryerjen e portimit brenda 24 orëve/1 dite pune nga kërkesa e pajtimtarit. Periudha e këshillimit publik ishte 26.12.2017-26.01.2018, dhe AKEP pas disa takimeve me operatorët celularë më datë 16.03.2018 miratoi versionin final të ndryshimeve të Rregullores së Portabilitetit. Ndryshimet e miratuara hyjnë në fuqi më datë 1.07.2018.

Statusi i Shërbimit Universal

AKEP në vijim të Planit të Veprimit 2013-2016 për Shërbimin Universal në fushën e komunikimeve elektronike në periudhën Tetor-Nëntor 2016 kreu procesin e këshillimit publik për dokumentin “Statusi i Shërbimit Universal të Komunikimeve Elektronike-Këshillim Publik”. Qëllimi i këtij dokumenti ishte kryerja e procesit të rishikimit të statusit të SHU, duke evidentuar zhvillimet kryesore në këto vite në tregun e komunikimeve elektronike që kanë lidhje me SHU, si dhe trajtimi i nje sërë çështjeve të lidhura me zhvillimin e regjimit

të shërbimit universal në Shqipëri. Pas këshillimit publik, AKEP me Vendimin nr.12, datë 19.04.2017, miratoi dokumentin “Statusi i Shërbimit Universal të komunikimeve elektronike-2017”.

Realizimi i treguesve financiare të AKEP

AKEP në kapitullin 5 të këtij raporti ka dhënë në mënyrë të detajuar realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave për vitin 2017. Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2017 rezulton në shumën 61,6 milionë Lekë, si rezultat i diferencave nga pagesat e sipërmarrësve dhe mosrealizimit/kursimit të disa zërave të miratuar në fondin e shpenzimeve të AKEP. Teprica e akumuluar do të derdhet në Buxhetin e Shtetit sipas dispozitave që përcakton Ligji 9918/2008.

Strategjia dhe plani i veprimit të AKEP për vitin 2018

Me qëllim rritjen e transparencës dhe efikasitetit të punës së AKEP dhe komunikimit me palët e interesuara, AKEP me Vendimin Nr.29, datë 29. 12. 2017, miratoi dokumnetin “Strategjia dhe Planin i Veprimit të AKEP për vitin 2018”. Ky dokument përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike ku do fokusohet puna e AKEP gjatë vitit 2018, të cilat janë dhënë në kapitullin 6 të këtij raporti vjetor.

Dokumenti u përgatit pas seminarit “Strategjia dhe plani i veprimit të AKEP për vitin 2018”, të organizuar nga AKEP në Shkodër më datë 19-20.12.2017, me pjesëmarrjen e punonjësve të AKEP dhe përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës si dhe ekspertë të fushës. AKEP do të vijojë të publikojë në muajin Dhjetor të çdo viti planin e veprimit për vitin pas-ardhës, duke synuar edhe një përfshirje më të madhe të palëve të interesuara në këtë proces.

1. TREGU I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

AKEP gjatë vitit 2017 vijoi punën për rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike, bazuar në parimin e transparencës duke bashkëpunuar me palët kryesore të interesit si operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe Autoriteti i Konkurrencës. Disa nga trendet dhe zhvillimet kryesore të tregut të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2017 ishin:

- Transferimi i të drejtave të përdorimit të radiofrekuancave nga Plus Communications tek Vodafone Albania dhe Telekëom Albania dhe mbyllja e aktivitetit të ofrimit të shërbimeve celulare nga Plus Communication më 31.12.2017;
- Rënia e të ardhurave dhe fitimeve të operatorëve të kryesorë të komunikimeve elektronike.
- Vijimi i rritjes së ndjeshme e përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband dhe rënia e përdorimit të shërbimeve tradicionale të thirrjeve dhe SMS-ve nga rrjete celulare
- Rritje e proporcionit të thirrjeve off-net dhe reduktim i thirrjeve on-net në rrjetet celulare;
- Rritje e lehtë e ARPM dhe ARPU në rrjetet celulare
- Vijimi i rritjes së qëndrueshme e aksesit broadband nga rrjete fikse dhe renies së përdorimit të telefonisë fikse;
- Vijimi i rritjes së përdorimit të paketave të integruara në rrjetet celulare dhe fikse.

Raporti në vijim paraqet tendencat kryesore në tregun e komunikimeve elektronike në lidhje me treguesit financiarë të operatorëve, përdorimin e shërbimeve, tarifat dhe nivelin e konkurrencës në treg.


Proceset e analizave të tregut dhe masave përkatëse rregullatore për FNT dhe qasjen e AKEP për këto procese si rrjedhojë edhe e konsolidimit të tregut celular në Shqipëri, nga katër në tre operatorë, trajtohen në Kapitullin 2.

1.1 ZHVILLIMET E TREGUT

1.1.1 Të ardhurat dhe Investimet

Pas një periudhe me të ardhura të qëndrueshme të sektorit në 2014-2016, në vitin 2017 u vu re një rënie e ndjeshme e të ardhurave nga komunikimet elektronike, e cila vlerësohet të jetë shkaktuar kryesisht nga rënia e të ardhurave të shërbimeve me shumicë të operatorëve celularë. Të ardhurat totale të sipërmarrësve nga komunikimet elektronike për vitin 2017 vlerësohet² të jenë 37 miliardë lekë, që përbën një reduktim me rreth 13% në krahasim me vitin 2016, kur të ardhurat ishin rreth 42.4 miliardë lekë. Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve në rrjetet celulare u reduktuan me 12% ndërsa të ardhurat nga rrjetet fikse u reduktuan me 14%. Ofrimi i shërbimeve nga rrjetet celulare vijon të gjenerojë pjesën më të madhe të të ardhurave të sektorit me rreth 80% ndërsa të ardhurat e gjeneruara nga rrjetet fikse përbëjnë vetëm 20% të të ardhurave totale të sektorit.

FIGURA 1:1 TË ARDHURAT E SIPËRMARRËSVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE (2008-2017)




Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP dhe vlerësime të stafit të AKEP për operatorët alternativë të rrjeteve fikse.

Të ardhurat e katër ofruesve kryesorë të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, Vodafone Albania, Telekom Albania, Albtelecom dhe Plus Communication, përbëjnë 91-92% të të ardhurave të gjithë sektorit të komunikimeve elektronike, dhe ndryshimet në të ardhurat e këtyre operatorëve ndikojnë ndjeshëm në trendin e të ardhurave totale të gjithë sektorit. Të ardhurat e katër sipërmarrësve u reduktuan me 13% në vitin 2017, ku rënie pësuan të ardhurat nga shërbimet celulare me 12% dhe të ardhurat e Albtelecom nga rrjeti fiks u reduktuan përsëri me 15% edhe në vitin 2017.

FIGURA 1.2. SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE TË SIPËRMARRËSVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE (2017)


² Të dhenat financiare për vitin 2017 në këtë raport janë sipas të dhënave të deklaruar nga 4 operatorët kryesorë dhe me vlerësim nga stafi i AKEP për operatorët alternativë të rrjeteve fikse, të dhënat e të cilëve janë objekt saktësimi në kohën e përgatitjes së këtij raporti.



Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP

Të ardhurat e katër operatorëve nga shërbimet e rrjeteve celulare gjatë vitit 2017 pësuan rënie me 12% duke kapur shifrën në 29.7 miliardë lekë, krahasuar me 33.9 miliardë në vitin 2016. Rënia e të ardhurave për operatorët celularë varion nga 8% për Albtelcom në 18% për Plus Communication.

FIGURA 1.3. TË ARDHURAT TOTALE TË OPERATORËVE CELULARË (2004-2017)




Shënim: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP.

Të ardhurat totale nga shërbimet me pakicë në rrjetet celulare në vitin 2017 arritën në 17.2 miliardë lekë që përbën një rritje të vogël me 0.4%. Telekom Albania, Albtelcom dhe Plus Communication, kanë shënuar rritje me 11%, 9% dhe 16% respektivisht, ndërsa Vodafone Albania ka shënuar rënie të të ardhurave me pakicë me 8%.

Rënia më e madhe e të ardhurave të operatorëve celularë ka ndodhur në të ardhurat e shërbimeve me shumicë, ku të katër operatorët kanë shënuar rënie të ndjeshme. Turrja e ndjeshme e të ardhurave me shumicë ka ardhur kryesisht për shkak të rënies së madhe të

trafikut hyrës ndërkombëtar (rreth 44%) dhe rrjedhimisht të të ardhurave nga terminimi i këtyre thirrjeve (rreth 3.4 miliardë lekë), duke ndikuar negativisht edhe në nivelet dhe normat e fitimit të operatorëve celularë, për shkak të peshës së lartë të këtyre të ardhurave në të ardhurat totale dhe fitimet e kompanive celulare.

FIGURA 1. 4. TË ARDHURAT NGA SHËRBIMET ME PAKICË DHE SHUMICË TË RRJETEVE CELULARE 2010-2017




Shënim: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP

Investimet

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e investimeve të katër sipërmarrësve në infrastrukturë të rrjeteve celulare (nuk përfshihen shpenzimet për licenca/autorizime) në periudhën 2010-2017.

FIGURE 1.5 ECURIA E INVESTIMEVE TË SIPËRMARRËSVE NË RRJETE CELULARE (2010-2017)



Shënim: Sipas të dhënave të operatorëve të deklaruar në AKEP.

Ecuria e investimeve në rrjete celulare tregon se në dy vitet e fundit ka pasur një rënie të ndjeshme të investimeve, e ndikuar edhe nga diz-investimet e Plus (shitja e aseteve). Duke hequr efektin e Plus rezulton se investimet e tre operatorëve në infrastrukturë rrjeti celular u reduktuan me rreth 2.6 miliar lekë në 2016 dhe u rritën me 892 milionë lekë në 2017. Ndërkohë investimet e Albtelecom në infrastrukturë rrjeti fiks në dy vitet e fundit ishin në nivel 730-740 milionë lekë/vit.

Nga të dhënat e depozituara nga operatorët vihet re se fitimet neto të raportuara Telekom Albania dhe Vodafone Albania kanë pësuar rënie të ndjeshme duke arritur për herë të parë që prej vitit 2001 në vlera negative të konsiderueshme në vitin 2017. Ndërsa Albtelecom ka pasur humbje neto (rrjet fiks dhe celular së bashku) në nivele 1-2 miliardë lekë në vit që prej vitit 2011.

Megjithë rënien e madhe të fitimeve neto, niveli total i investimeve në rrjet celulare nga tre operatorët celularë dhe në rrjet fiks nga Albtelecom nuk kanë pësuar rënie me magnitudë të ngjashme me fitimet neto të tyre. Investimet në infrastrukturë rrjeti celular kanë pësuar rënie të ndjeshme në vitin 2016, por me rritje sërish në vitin 2017. Ndërsa investimet në rrjetin fiks nga Albtelecom kanë qenë në nivele më të qëndrueshme në dy vitet e fundit. Vlen të theksohet se tre sipërmarrësit në këto vite kanë kryer investime dhe në asete jo-të prekshme si pagesat one-off për rinovime frekuencash 900/1800 MHz (TA dhe Vodafone) dhe blerje të të drejtave të përdorimit të brezave të rinj të frekuencave për ofrim të shërbimeve në rrjete 3G/4G.

1.1.2. Shërbime të rrjeteve celulare

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2013-2017 dhe norma e ndryshimit vjetor në vitin 2017 paraqiten në tabelën e mëposhtëme.

TABELA 1.1: TREGUESIT KRYESORË TË VOLUMIT TË SHËRBIMEVE CELULARE 2013-2017

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	Ndryshimi 2017/2016
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:						
– Sipas kartave SIM	5,282,350	4,928,784	4,777,885	5,160,060	5,392,964	4.5%
– Përdorues aktivë	3,685,983	3,406,772	3,442,665	3,360,888	3,460,171	3.0%
Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:						
– Totali	1,231,259	1,576,877	2,049,072	2,739,550	3,345,045	22.1%
– Përdorues aktivë	1,231,259	907,975[1]	1,297,281	1,686,354	2,030,978	20.4%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	6,769,300,966	7,301,024,035	7,381,147,348	6,793,769,155	6,619,674,715	-2.6%
Thirrje hyrëse kombëtare	335,122,643	596,861,301	1,388,340,601	2,522,840,417	2,893,847,082	14.7%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare	655,124,571	464,550,758	420,253,147	300,227,063	168,753,020	-43.8%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	1,689,200,882	1,826,346,190	1,598,702,865	1,610,322,977	1,400,142,526	-13.1%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	2,529,549	6,269,940	12,740,073	26,753,639	45,901,117	71.6%


Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët, përpunimi AKEP

Nga të dhënat e tabelës vihet re se në periudhën 2013-2017 ka rritje të ndjeshme të përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband si në numër përdoruesish të këtyre shërbimeve dhe në volumin e të dhënave. Ndërkohë përdorimi i shërbimeve tradicionale të rrjeteve celulare ka tendencë rënëse ose rritje shumë më të vogël se ato të aksesit broadband.

Në vitet 2016-2017 vihet re një rritje e ndjeshme e trafikut hyrës kombëtar në rrjetet celulare (efekti i masës rregulluese të mos-diskriminimit në thirrjet on-net/off-net) dhe përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband (efekti i fillimit të ofrimit të shërbimeve 4G). Numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband celular ka rritje vetëm me 65% në 2013-2017 por volumi i të dhënave është rritur më shumë se 18 herë gjatë kësaj periudhe. Rritje të ndjeshme këta tregues kanë patur edhe në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, ku numri i përdoruesve të shërbimeve 3G/4G është rritur me 20%, ndërsa volumi i të dhënave është dyfishuar. **Rënie të ndjeshme ka pasur terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, me 44% në vitin 2017 krahasuar me vitin pararardhës, por me një rënie rreth 4 herë në krahasim me vitin 2013.**

Numri i përdoruesve celularë

FIGURA 1.6 NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË AKTIVË DHE KARTA SIM 2014-2017



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët, përpunimi AKEP

Nga të dhënat e mësipërme, vërehet se treguesit për përdoruesit aktivë të shërbimeve celulare broadband kanë qenë në trend rritës për periudhën 2014 deri në tremujorin e tretë të vitit 2017, për t'u ndjekur nga një rënie e lehtë gjatë tremujorit të fundit të këtij viti. Rritja e këtyre treguesve në terma vjetorë për periudhën 2016 – 2017 ka qenë rreth 20% për përdoruesit aktivë me akses broadband celular dhe rreth 15% për përdoruesit me akses broadband celular dhe telefoni celulare.

Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM (përshirë kartat e dedikuara për të dhëna) në fund të vitit 2017 ishte rreth 5.6 milionë që përbën rritje me 5.7% në krahasim me vitin 2016. Ndërkohë numri i përdoruesve aktivë (përdorim në 3 muajt e fundit të vitit) të telefonisë celulare në vitin 2017 arriti në rreth 3.2 milionë që përbën një rënie me 5.9% në krahasim me vitin 2016. Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në Internet të paktën një herë gjatë vitit 2017 ishte rreth 3.3 milionë, ndërsa numri i përdoruesve aktivë (përdorim të Internetit në tre muajt e fundit) ishte rreth 2 milionë, që përbën rritje vjetore me 22.2% dhe 17.6% respektivisht.

Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G

Numri i përdoruesve celularë që kanë përdorur të paktën njëherë aksesin broadband gjatë vitit 2017 ishte rreth 3.3 milionë krahasuar me 2.7 milionë gjatë vitit 2016, që përbën një rritje me 22%. Numri i përdoruesve aktivë (përdorim 3 muajt e fundit) të shërbimeve me akses broadband nga rrjetet celulare (3G/4G nga aparatet celulare dhe me karta USB/modem) në vitin 2017 ishte rreth 2 milionë apo 20% rritje krahasuar me rreth 1.7 milionë në vitin 2015. Përdorimi i aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G nëpërmjet aparateve celulare përbën rreth 94% të totalit të përdoruesve të këtij shërbimi dhe rritjet e ndjeshme të këtij treguesi

rezultojnë nga kjo kategori, ndërsa numri i përdoruesve nëpërmjet kartave USB/modem në katër vitet e fundit është pothuajse i pandryshuar në nivel rreth 120-128 mijë përdorues.


Penetrimi për popullsi i përdoruesve aktivë celularë të aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G në fund të vitit 2017 arriti në 72% krahasuar me 60% në fundvitin 2016. Të katërt operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rritje të numrit të përdoruesve aktivë të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparatave celulare, ndërsa numri përdoruesve të aksesit broadband celular me karta të dedikuara (Dedicated Data Card) në tre vitet e fundit është në nivel të qëndrueshëm 120-122 mijë.

TABELA 1.2: NUMRI I PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND 3G/4G

	Telekom Albania	Vodafone	Albtelecom	Plus	Total	Norma e penetrimit për popullsi
2011	55,000	228,249	-	-	283,249	10%
2012	240,715	408,998	-	-	649,713	23%
2013	311,566	634,293	285,400	-	1,231,259	43%
2014	225,346	550,196	132,433	-	907,975	32%
2015	375,973	706,880	214,428	-	1,297,281	46%
2016	460,221	921,854	231,321	72,958	1,686,354	60%
2017	613,886	1,030,614	282,077	104,401	2,030,978	72%

Burimi: Sipas të dhënave të depozituara nga operatorët në AKEP

FIGURA 1.7. NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVË TË AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE CELULARE DHE NORMA E PENETRIMIT



Burimi: Perlllogaritje te AKEP sipas të dhënave të depozituara nga operatorë

Rritja e numrit të përdoruesve të aksesit broadband nga rrjetet celulare 3G/4G në vitet e fundit është shoqëruar dhe me rritjen e volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare, si dhe në përdorimin mesatar për përdorues të të dhënave. Në vitin 2017 ritmi i rritjes së trafikut të të dhënave në rrjetet celulare u ngadalësua në 72%, por kjo vjen pas

normave të rritjes 103-148% në 2014-2016. **Në periudhën 2013-2017 volumi i trafikut të të dhënave në rrjetet celulare është rritur më shumë se 18 herë.**

Trafiku telefonik dhe SMS

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2017 ishte rreth 6.6 miliardë minuta, e cila përbën një rënie me 3 % në krahasim me vitin 2016, ndërkohë numri i mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2017 ishte 1.4 miliardë që përbën një rënie të ndjeshme me 13% në krahasim me vitin 2016. Sasia e thirrjeve on-net vijoi me trendin renes me 12% në vitin 2017, ndërsa thirrjet off-net u rriten me 15%. Edhe thirrjet ndërkombëtare patën rënie të ndjeshme në vitin 2017 me 31%. Këto trende të ndryshme të nivelit të thirrjeve sipas destinacionit çuan në ndryshime të mëtejshme në strukturën e trafikut dhe në përafrim të ndjeshëm të sasive të trafikut on-net dhe off-net, siç paraqitet në figurat e mëposhtme.

FIGURA 1.8: STRUKTURA E THIRRJEVE DALESE CELULARE SIPAS DESTINACIONIT





FIGURA 1.9. ECURIA TRAFIKUT MUJOR ON-NET/OFF-NET 2014-2017




Burimi: Përlllogaritje të AKEP sipas të dhënave të depozituara nga operatorë.

Rritjet e ndjeshme të nivelit dhe peshës së thirrjeve off-net në totalin e thirrjeve celulare dhe reduktimet në thirrjet on-net në 2015-2017 kanë ndodhur në vijim të zbatimit të detyrimit të operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifatat e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, që filluan të zbatohen në Korrik 2015 (vendimet e Analizës së tregut në Nëntor 2014 dhe të ndryshuara në Mars 2015).

Rënia e madhe e trafikut të thirrjeve dalëse ndërkombëtare në vitin 2016 – 2017 ka ardhur pas rritjeve të ndjeshme të këtyre thirrjeve në vitet 2014-2015. Këto luhatje shpjegohen me ndryshimet tek ofertat/paketat e operatorëve celularë për thirrjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe për shkak të ndryshimeve në tarifatat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare në vendet e BE-se të cilat përbëjnë pjesë të kostove të thirrjeve dalëse ndërkombëtare për operatorët shqiptarë. Reduktimi i minutave/ofertave për këto thirrje nga operatorët celularë shqiptarë në vitin 2016 ka ardhur për shkak të rritjes së tarifave të terminimit në një sërë vendesh të BE-së për thirrjet ndërkombëtare të origjinuara jashtë vendeve anëtare të BE. Një faktor tjetër i rëndësishëm i reduktimit të thirrjeve dalëse (dhe hyrëse) ndërkombëtare është efekti zëvendësues i tyre me përdorim të komunikimit me aplikacione OTT. Rënia e madhe e trafikut dalës dhe hyrës ndërkombëtare vihet re më mirë në grafikun e mëposhtëm. Sasia totale e thirrjeve dalëse dhe hyrëse ndërkombëtare në vitin 2017 shënoi rekordin më të ulët historik prej vitit 2003.

FIGURA 1.10: ECURIA E THIRRJEVE DALËSE DHE HYRËSE NDËRKOMBËTARE NË RRJETET CELULARE



Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve

Sasia totale e thirrjeve hyrëse (nga rrjetet e tjera) të terminuara në rrjetet celulare në vitin 2017 ishte rreth 3 miliardë minuta, që përbën rritje me 8% në krahasim me vitin parardhës. Terminimi I thirrjeve kombëtare u rrit me 6% për thirrjet nga rrjetet fikse dhe me 15% për thirrjet nga rrjetet e tjera celulare. Ndërkohë sic mund të vihet re dhe nga figura më sipër terminimi I thirrjeve hyrëse ndërkombëtare u reduktua me 44% në vitin 2017. Ndërsa sasia

totale e SMS-ve të origjinuara nga përdoruesit celularë në vitin 2017 u reduktua me 13%, terminimi i SMS-ve u rrit me 10%.

Sic mund të vihet re trendi rritës me ritme të larta i përdorimit të të dhënave është në kah të kundert me trendin e përdorimit të shërbimeve tradicionale të thirrjeve dhe SMS-ve, duke evidentuar efektin zëvendësues të këtyre shërbimeve tradicionale me shërbimet e ofruara nga aplikacionet OTT që mundësohen nga aksesi broadband në rrjetet celulare 3G/4G.

Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë në 2010 deri në 2017, sipas dy treguesit të përdoruesve aktiv. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Njëkohësisht tabela përmban dhe përdorimin mesatar mujor për SMS-të dalëse, si dhe për përdorues aktivë broadband për 2014-2017.

TABELA 1.3. PËRDORIMI MESATAR MUJOR I THIRRJEVE TELEFONIKE CELULARE 2010-2017

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Ndryshimi 2017/2016
Thirrje dalëse	110	130	152	156	172	182	166	160	-4%
Thirrje të marra	124	147	168	167	168	171	169	167	-1%
MOU³	234	277	319	324	341	353	335	327	-2%
SMS Dalese		19	35	39	43	39	39	34	-13%
Trafik Data (GB)					0.55	0.89	1.49	2.06	38%

Gjatë vitit 2017, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 160 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 34 mesazhe SMS në muaj dhe ka konsumuar rreth 2.06 GB në Internet broadband. Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM. Treguesit e përdorimit mesatar të thirrjeve dhe SMS-ve janë me tendencë rënëse gjatë vitit 2017, me rënie nga 1-13%, ndërsa përdorimi mesatar i të dhënave ka rritje të ndjeshme me rreth 38 %.

Pjesët e tregut

Pjesët e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë në periudhën 2011 – 2017⁴ së bashku me indeksin HHI⁵ të përqendrimit janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

³ MOU (Minutes Of Usage)

⁴ Në lidhje me pjesët e tregut, mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve.

⁵ HHI (Herfindahl–Hirschman Index), i matur si shuma e katrorëve të pjesëve të tregut të gjithë lojtarëve të tregut.

TABELA 1.4- PJESËT E TREGUT TË OPERATORËVE CELULARË 2011-2016

		Telekom Albania	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card)	2011	37%	35%	21%	8%	3,052
	2012	33%	36%	25%	5%	3,085
	2013	39%	43%	13%	6%	3,525
	2014	40%	40%	14%	7%	3,399
	2015	34%	42%	16%	8%	3,222
	2016	32%	49%	14%	4%	3,691
	2017	32%	49%	14%	5%	3,676
Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare	2011	34%	48%	13%	6%	3,620
	2012	40%	42%	12%	6%	3,549
	2013	38%	45%	12%	6%	3,600
	2014	34%	46%	13%	8%	3,460
	2015	33%	47%	14%	6%	3,499
	2016	31%	51%	13%	5%	3,724
	2017	34%	48%	13%	6%	3,464
Përdorues aktivë broadband (3G/4G)	2011	19%	81%	N/A	N/A	6,871
	2012	37%	63%	N/A	N/A	5,335
	2013	25%	52%	23%	N/A	3,831
	2014	25%	61%	15%	N/A	4,501
	2015	29%	55%	17%	N/A	4,082
	2016	27%	55%	14%	4%	3,944
	2017	30%	51%	14%	5%	3,708
Thirrje dalëse	2011	37%	51%	10%	2%	4,074
	2012	39%	50%	8%	3%	4,094
	2013	39%	51%	7%	3%	4,180
	2014	34%	50%	11%	5%	3,797
	2015	32%	49%	13%	6%	3,642
	2016	34%	52%	11%	4%	3,940
	2017	34%	48%	10%	8%	3,619
SMS dalëse	2011	27%	64%	8%	1%	4,890
	2012	20%	73%	6%	1%	5,766
	2013	21%	73%	5%	1%	5,796
	2014	19%	66%	5%	10%	4,898
	2015	18%	66%	8%	8%	4,787
	2016	21%	67%	9%	3%	4,988
	2017	25%	60%	10%	5%	4,325
Trafiku të dhëna (Gbyte)	2011	23%	43%	26%	8%	3,099
	2012	27%	54%	14%	5%	3,857
	2013	21%	57%	17%	4%	4,063
	2014	16%	49%	30%	4%	3,632
	2015	18%	51%	29%	3%	3,727
	2016	21%	55%	22%	2%	3,937
	2017	24%	55%	18%	2%	3,970
Të ardhura totale nga	2011	34%	52%	12%	2%	3,987

komunikimet	2012	29%	56%	10%	4%	4,120
	2013	33%	50%	11%	6%	3,744
	2014	34%	48%	12%	6%	3,665
	2015	34%	47%	12%	7%	3,582
	2016	31%	49%	12%	9%	3,522
	2017	30%	49%	12%	8%	3,549
Të ardhura retail	2011	36%	49%	13%	2%	3,882
	2012	33%	50%	12%	5%	3,751
	2013	32%	52%	11%	6%	3,815
	2014	30%	53%	11%	5%	3,926
	2015	28%	54%	12%	5%	3,894
	2016	28%	56%	12%	5%	4,052
	2017	31%	51%	13%	5%	3,746

Burimi: Të dhëna të depozituara nga operatorët pranë AKEP. Përlllogaritja AKEP

Vodafone Albania megjithëse ka pësuar tkurrje të pjesvë të tregut për disa tregues, ai është operatori lider me pjesë tregu në nivel rreth 50% për shumicën e treguesve, duke arritur dhe 55-60% për trafikun e të dhenwave dhe SMS. Megjithëse Plus Communication ka pjesë të vogla tregu, dalja e tij nga tregu më 1.01.2018 pritet të rrisë përqëndrimin e tregut në vitin 2018. Me daljen nga tregu të hyrësit më të ri në tregun celular, AKEP është duke vlerësuar situatën e re në tregun celular nëpërmjet proceseve të Analizave të tregut, duke vënë theksin në marrjen e masave rregullatore që të stimulojnë një konkurrencë efektive dhe përfitime të qëndrueshme të përdoruesve në periudhë afatmesme-afatgjatë nga konkurrenca e drejtë në treg midis operatorëve ekzistues celularë.

Tarifat celulare

Operatorët celularë ofrojnë një sërë shërbimesh dhe paketash tarifore dhe shpesh është e vështirë krahasimi i tarifave për shërbime të veçanta dhe/ose për njësi për shkak të rritjes së përdorimit të shportave (bundles) me një shërbim ose me shumë shërbime (paketa të integruara), e cila përbën dhe një tendencë globale të përmendur dhe nga ITU në raportin më të fundit të vitit 2016. Si edhe në dokumentat e tjerë të AKEP, ecuria e tarifave me pakicë të tregut celular analizohet në dy drejtime kryesore:

- Të ardhura mesatare për minutë/përdorues (ARPM/ARPU);
- Tarifat nominale me pakicë të operatorëve.

Në seksionet në vijim AKEP ka analizuar fillimisht ecurinë e treguesve të ARPM dhe ARPU, dhe më pas të tarifave nominale të operatorëve celularë duke u fokusuar në ndryshimet e kryera nga operatorët celularë në zbatim të detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifat e thirrjeve on-net dhe off-net, tarifat e shërbimeve të aksesit broadband, krahasime të tarifave të segmenteve me parapagim dhe paspagim dhe tarifat për njësi komunikimi.

Treguesit e ARPU (Average Revenue Per User) dhe ARPM (Average revenue Per Minute) masin të ardhurat mesatare të operatorëve për përdorues dhe për minutë, por që njëkohësisht

mund të interpretohen si shpenzime mesatare të përdoruesve celularë, dhe për këtë arsye përdoren edhe si tregues agregatë të ecurisë së tarifave të shërbimeve celulare. Në prezencë të përdorimit të lartë të paketave/ofertave dhe shportave të integruara të shërbimeve me sasi të mëdha shërbimesh të përfshira në pagesat fikse, për përdorues me parapagim dhe me kontratë, ARPM dhe ARPU janë tregues të mirë të tarifave dhe shpenzimeve mesatare efektive që paguajnë realisht përdoruesit celularë.

E ardhura mesatare për minutë (ARPM) matet si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës përkatëse dhe përdoret si përafrues i çmimit që një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike. ARPU e matur si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktivë) gjatë një viti dhe tregon sa lekë shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj.

TABELA 1. 5. ARPM DHE ARPU 2010-2017

Vitet	ARPM (Lekë/Minutë)	ARPU (Lekë/përdorues)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)	ARPU Ndryshimi vjetor (%)
2010	6.49	8,594	N/A	N/A
2011	5.35	8,319	-18%	-3%
2012	3.92	7,132	-27%	-14%
2013	3.13	5,863	-20%	-18%
2014	2.63	5,447	-16%	-7%
2015	2.36	5,125	-10%	-6%
2016	2.53	4,750	7%	-7%
2017	2.60	5,091	3%	7%

Shënim: Vlerat pa TVSH

Nga tabela e mësipërme vërehet se vlera e ARPM ka tendencë ulje nga viti 2010 deri në vitin 2015, dhe në vitin 2016 ka një rritje prej 0.17 lekë/minute, e ndjekur gjithashtu me një rritje prej 0.07 lekë/minutë edhe gjatë vitit 2017. Nga ana tjetër vlerat e ARPU kanë njohur vetëm rënie nga viti 2010 deri në vitin 2016, duke shënuar vlerën 4,750 lekë/përdorues në vit. Në vitin 2017 për herë të parë ARPU shënoi rritje duke arritur në rreth 5,095 lekë/vit.

Në vitin 2017 një përdorues aktiv celular ka paguar mesatarisht rreth 3.12 lekë/minutë (me TVSH), dhe shpenzuar mesatarisht 509 lekë/muaj (me TVSH) për shërbime celulare: 160 minuta thirrje dalëse, 34 SMS dhe rreth 2GB internet.

Niveli i këtyre shpenzimeve mesatare për përdoruesit apo të ardhurash për operatorët në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulët në rajon. ARPU në vitin 2015 në Shqipëri ishte 36.6 euro/vit, që është 23% më e ulët se Letonia

me nivelin më të ulët në BE me 46 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2014⁶ ishte 162.2 euro apo rreth 4.4 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2015.


1.1.3 Shërbimet nga rrjetet fikse

Telefonia fikse

Shërbimet e telefonisë fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 90 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka patur një rënie të vazhdueshme në 2012-2014 ndërsa në tre vitet e fundit është vënë re një qëndrueshmëri e këtij treguesi.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2016 ishte rreth 248 mijë, ndërsa në 2017 arriti në rreth 244 mijë, që përbën një rënie me 2%. Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2017 arriti në 8.6%, që është shumë më e ulët se vendet e zhvilluara (rreth 40%), rreth dy herë më e ulët se mesatarja botërore (15.2%), madje me e ulët edhe se mesatarja e vendeve në zhvillim (10%).

FIGURA 1.11. ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISË FIKSE 2000-2017



Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorët. Përpunimi AKEP

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 48% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe. Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fikse të Albetecom në Tremujorin IV 2017 u reduktua me 20% në krahasim me Tremujorin IV 2016, ndërsa gjatë vitit 2017 një përdorues i rrjetit fikse të Albetecom gjeneroi mesatarisht 52 minuta thirrje në muaj, krahasuar me 65 minuta në muaj për vitin 2016.

Aksesi broadband nga rrjete fikse

Numri i pajtimtarëve

⁶ Të dhënat më të fundit të ARPU për vendet e BE-së të publikuar nga KE janë për vitin 2014.

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pasur reduktim të ndjeshëm në 5 vitet e fundit, shërbimet e aksesit broadband nga rrjete fikse kanë pasur rritje të qëndrueshme vjetore gjatë kësaj periudhe kohore. Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2017 arriti në rreth 294 mijë, që përbën një rritje me rreth 10.5% në krahasim me vitin 2016.


TABELA 1.6. ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË AKESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE 2010-2017

Periudha	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	OA të tjerë	Total Broadband Fiks
2010	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000
2011	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088
2013	73,242	43,430	20,562	15,432	29,890	182,556
2014	82,747	47,480	23,259	28,489	25,956	207,931
2015	97,597	51,093	24,497	31,357	38,326	242,870
2016	109,851	52,442	29,497	37,650	36,939	266,379
2017	120,204	55,860	28,633	46,118	42,808	293,623
Ndryshimi 2017/2016	9.4%	6.5%	-2.9%	22.5%	15.9%	10.2%

Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorët ndër vite. Përpunimi AKEP

Tabela e mësipërme jep në mënyrë më të detajuar ecurinë e numrit të pajtimtarëve me akses broadband në periudhën 2000-2017 si dhe për operatorët kryesorë në treg. Të gjithë operatorët kryesorë vihet re se kanë ecuri pozitive në 3-4 vitet e fundit, përveç Abissnet që ka pësuar një rënie krahasuar me vitin 2016. Albtelecom zotëron 40.9% pjesë tregu, i ndjekur nga Abcom me 19% pjesë tregu në vitin 2017.

FIGURA 1.12- ECURIA E PJESËVE TË TREGUT TË AKESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE (2010-2017)




Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorët ndër vite. Përpunimi AKEP

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi gjatë periudhës 2011-2017. Në vitin 2017 norma e penetrimit të aksesit broadband

nga rrjete fikse ishte 37.2% për familje dhe 10.4% për popullsi. Megjithëse numri i pajtimtarëve me akses broadband është në rritje të qëndrueshme, normat e penetrimit janë shumë më të ulëta se në vendet e BE dhe të rajonit.

FIGURA 1.13 PENETRIMI I AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE SIPAS POPULLSISË DHE FAMILJEVE (2011-2017)



Burimi: Të dhënat e ardhura nga operatorët dhe INSTAT. Përpunimi AKEP.

Bazuar në të dhënat rajonale in 2017 vërehet se qarqet me normat më të larta të penetrimit urban janë Tirana dhe Korca, përkatësisht me nga 26.65% dhe 18.69% ndërsa Durrësi është qarku që ka normën më të lartë të penetrimit rural rreth 12%, ku së bashku me atë urban përbën rreth 9% të popullsisë totale të këtij qarku.

Paketat e integruara (Bundles)

Të dhënat e mësipërme tregojnë se shërbimi telefonik për disa vjet tashmë rezultojnë të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse, ndërsa nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve janë shërbimet e aksesit broadband dhe sidomos shërbimet e integruara. Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa (bundles) të shërbimeve të aksesit në Internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezultojnë të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2017 arriti në rreth 198 mijë, rreth 6.5 % më shumë se në vitin 2016. Në vitin 2017 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 67% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 34% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

TABELA 1.7. NUMRI I PAJTIMTARËVE QË KANË AKSES NË SHËRBIME TË INTEGRUARA

	Totali	Telefoni fikse dhe Internet	Telefoni fikse, Internet dhe TV	Internet dhe TV
2014	119,230	78,419	24,330	16,481
2015	149,833	69,755	71,681	8,397
2016	186,983	76,045	92,932	18,006
2017 T1	188,969	71,438	97,676	19,855
2017 T2	194,285	77,911	95,328	21,046
2017 T3	198,774	77,541	98,817	22,416
2017 T4	198,483	81,660	99,888	16,935
Ndryshimi tremujor	-0.15%	5.31%	1.08%	-24.45%
Ndryshim v-m-v	6.15%	7.38%	7.49%	-5.95%

Gjatë vitit 2017, numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth 7.5 % krahasuar me vitin 2016. Albtelecom pati një rritje me 7 % krahasuar me një vit më parë në shportat triple pay ku 67% e përdoruesve me akses broadband të Albtelecom ishin me paketa trefishe.

Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara në periudhën 2013-2017. Ndërsa në vitin 2013 shumica e pajtimtarëve të Albtelecom ishin me paketa dyfishe (Telefoni dhe Internet) dhe nuk kishte paketa trefishe, në fund të vitit 2017 rreth 67% e pajtimtarëve me akses broadband të Albtelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV).


TABELA 1.8 NUMRI I PAJTIMTARËVE TË ALBTELECOM ME SHËRBIME TË INTEGRUARA (2013-2017)

	2013	2014	2015	2016	2017	Ndryshimi 2017/2016
Numri total i pajtimtarëve me akses broadband	73,242	82,747	97,597	109,851	120,204	9%
Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (TV, Internet, telefoni)	70,961	76,230	93,873	109,034	118,050	8%
Telefoni fikse dhe Internet	70,961	60,939	32,293	33,673	37,783	12%
Telefoni fikse, Internet dhe IPTV		15,291	61,580	75,361	80,264	7%

Teknologjia

Teknologjia mbizotëruese për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse është DSL e ndjekur nga kabllor koaksial. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuara fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Figura e mëposhtëme paraqet shpërndarjen e lidhjeve broadband fiks sipas teknologjisë në Shqipëri. DSL është teknologjia kryesore në Shqipëri, ku pjesa e tregut gjatë vitit 2017 ka pësuar një rënie të lehtë duke shkuar në rreth 52%, krahasuar me rreth 53% të tregut në vitin 2016. Në Shqipëri lidhjet DSL përbëjnë 62% të totalit të lidhjeve broadband fiks dhe shumica e tyre është me kombinim fibër optike + linjë bakri apo FTTN/FTTC.

FIGURA 1.14 LIDHJET BROADBAND FIKS SIPAS TEKNOLOGJISË SHQIPËRI 2017




Lidhjet me fibër optike në Shqipëri (FTTH/B) për vitin 2017 përbëjnë 14% të totalit të lidhjeve, me një rritje prej rreth 3 pikë përqindje (pp) krahasuar me vitin 2016. Lidhjet kabllore në Shqipëri përbëjnë 20%, ku NGA kabllor (DOC SIS 3.0 dhe më shumë) përbën 64% të totalit të lidhjeve kabllore, në krahasim me vitin 2016 kemi një rënie me rreth 1 (pp). Pajtimtarët me lidhje në NGA (FTTx + NGA kabllorë) në Shqipëri përbëjnë 79% të të gjitha lidhjeve broadband, ku shumica e tyre janë në ADSL në FTTN/C, ndërsa në vendet e BE ky proporcion është 35% ku shumica janë VDSL, FTTH/B dhe Cable DOC SIS 3.0.

Shpejtësia e aksesit broadband

Figura e mëposhtme tregon shpërndarjen e pajtimtarëve me akses broadband në internet në rrjetet fikse sipas shpejtësive të përdorura në 2014-2017. Siç mund të vihet re shpejtësia më e përdorur është 4-10 Mbps me 63% në 2017. Të dhënat tregojnë se proporcioni i pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi më të ulët se 4 Mbps ka ardhur në rënie ndërsa për shpejtësi mbi 4Mbps ka ardhur në rritje. Në 2017 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi 4-10Mbps nga 153 mijë në 2016 në rreth 186 mijë në 2017.

Të dhënat e mëposhtme tregojnë se rreth 96% e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse kanë akses me shpejtësi 2Mbps ose më të lartë. Pjesa e pajtimtarëve me shpejtësi më të ulët se 2 Mbps është ulur nga 7% në 2016 në 4% në 2017.

FIGURA 1.15. SHPËRNDARJA E PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND FIKS SIPAS SHPEJTËSISË 2017



1.1.4 Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës

Me qëllim promovimin e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës aktive dhe pasive të rrjeteve fikse AKEP në vitin 2016 ka miratuar një sërë dokumentash si analizat e tregut të LLU, aksesit broadband me shumicë (bitstream) dhe linjave me qira në vitin 2014 dhe 2016, dhe rregulloren për përdorimin e përbashkët të faciliteteve në vitin 2015. Disa prej këtyre masave rregulluese filluan të japin efekt në vitin 2015, dhe në vitin 2016 u vu re një rritje e përdorimit të elementëve aktivë (linja/kapacitete me qira) dhe elementëve pasivë të infrastrukturës së rrjeteve fikse. Gjatë vitit 2017 ofrimi i kapaciteteve me qira nga linja ndërkombëtare pësoi një ulje me 51% krahasuar me vitin 2016, ndërkohë ofrimi i kapaciteteve me qira nga linja kombëtare pësoi një rritje me 194% e shoqëruar me një rritje të kapaciteti total të dhënë me qira me 150% krahasuar me vitin 2016. Gjithashtu një ulje pësoi edhe ofrimi i infrastrukturës pasive si aksesit në dark fiber dhe tubacione, të cilat u ulën me 4% dhe 3% respektivisht. Kontribuesi kryesor në infrastrukturën pasive ka qenë Altelecomi, i cili ka rritur aksesin në 2017 me 945 km dark fiber dhe 69 km tubacione si dhe Abcom me 145 km dhe ATU me 117 km, rritje të dhënies së aksesit në dark fiber. Altelecom është ofruesi kryesor i aksesit me shumicë në elementët aktivë dhe pasivë të infrastrukturës në rrjete fikse. Në vitin 2017, 64% e fibrës optike dhe 97% e aksesit në tubacione janë ofruar nga Altelecom. Vlen të theksohet se Altelecom ka kryer disa reduktime të tarifave me shumicë të aksesit në elementët aktivë dhe pasive të rrjetit.

TABELA 1.9. OFRIMI ME SHUMICË LINJA/KAPACITETE ME QIRA 2014-2017

	2014	2015	2016	2017	Ndryshimi 2017/2016
Ofrim akses në infrastrukturë aktive					
Numri i linjave/lidhjeve të dhëna					
	345	508	532	650	22%
Kombëtare					
	328	489	508	632	24%
Ndërkombëtare					
	17	19	24	18	-25%
Kapaciteti total i dhënë me qira (Mbps)					
	34,793	36,826	44,423	111,234	150%
Kombëtare					
	33,392	35,346	36,464	107,306	194%
Ndërkombëtare					
	1,401	1,480	7,959	3,928	-51%
Ofrim Akses në Infrastrukturë Pasive (Km)					
Dark fiber					
	927	924	1,529	1,466.7	-4%
Akses në tubacione					
	19	61	74	71.5	-3%

1.2 RREGULLIMI I TREGJEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Ligji nr. 9918 parashikon që tregjet përkatëse kombëtare të komunikimeve elektronike dhe produktet përkatëse, të cilat justifikojnë rregullimin ex-ante dhe janë subjekte të rregullimit të veçantë, përcaktohen në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, me parimet e ligjit për konkurrencën dhe kushtet aktuale të tregut shqiptar, duke patur parasysh kërkesat e rregullimit të veçantë në sektor dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve.

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918, dhe Rregullores “Për Analizën e Tregut”, gjatë vitit 2017 u fokusua në:

- Shqyrtimin e ankimeve administrative për analizën e tregjeve me shumicë të aksesit broadband
- Përfundimin e procesit të Analizës së tregut celular që ishte nxjerrë në këshillim publik në Dhejtor 2016
- Kryerjen e procesit të analizës së tregut të telefonisë fikse (Këshillim Publik);

1.2.1 Ankimet për Analizën e tregjeve me shumicë të aksesit broadband

AKEP më 22.12.2016 në përfundim të këshillimit publik për analizën e tregjeve me shumicë të aksesit broadband dhe linjave me qira me Vendimet nr.2701-2704 miratoi versionet finale të dokumentave të nxjerrë në këshillim publik dhe përcaktoi Albtelecom si sipërmarrës me FNT dhe masat përkatëse rregulluese në tregjet e mëposhtëme:

- a. Tregun me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA)*
- b. Tregun me shumicë të aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA)*
- c. Tregun me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA);*

Albtelecom në vitin 2017 ankimoi vendimet nr.2701-2704, duke kërkuar mospërcaktimin e Albtelecom si sipërmarrës me FNT në tregun përkatës me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA) dhe ndryshimin e vendimeve për rregullimin e tarifave me shumicë të aksesit broadband dhe linjave me qira.

AKEP me Vendimet Nr.4 dhe 5, datë 16.02.2017 shqyrtoi ankimet e Albtelecom për Vendimet 2701 dhe 2702, datë 22.12.2016, për FNT dhe masat rregulluese, duke mospranuar kërkesat e Albtelecom për ndryshimin e këtyre vendimeve.

AKEP me Vendimin nr.13, datë 4.05.2017 kreu shqyrtimin e ankimit të Albtelecom për vendimet 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016, duke pranuar pjesërisht kërkesën e Albtelecom për ndryshimin e këtyre vendimeve. Procesi i shqyrtimit të këtij ankimi dhe vendim-marrjes së AKEP u krye nëpërmjet këshillimit publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016”. Këshillimi publik u kryer në periudhën 17.03.2017-17.04.2017, dhe AKEP në Vendimin nr.13, datë 4.05.2018, morri në konsideratë dhe trajtoi dhe komentet e palëve të intresuara si dhe ankimet e disa operatorëve alternativë për këto tarifa.

1.2.2 Analiza e tregut me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare

AKEP me vendimin Nr.2699, datë 1.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare:Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*” dhe me Vendimin nr. 2700, datë 22.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*”.

Dokumenti “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*” përmbante analizën e tregut përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare dhe propozimet e AKEP për operatorët me FNT dhe masat rregulluese për FNT për katër operatorët celularë. Ky dokument përmbante dhe një analizë të detajuar të tregut me pakicë celular duke evidentuar ecurinë e tij në vitet e fundit në lidhje me numrin e pajtimtarëve të shërbimeve celulare, përfitimet e tyre nga përdorimi i këtyre shërbimeve, tarifat dhe probleme të evidentuara në lidhje me tarifat celulare me pakicë, tregues financiarë të kompanive celulare dhe strukturë/pjessët e tregut etj., si dhe pritshmëritë e AKEP për ecurinë e tregut me pakicë të shërbimeve celulare në vitet e ardhme. Ndërsa dokumenti “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*”, përmbante propozimet e AKEP për metodën e rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celularë Telekëom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom dhe Plus Communication, të cilët sipas dokumentit të Analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik propozoheshin si sipërmarrës me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet individuale të tyre, duke përfshirë dhe propozimin për vendosjen e masës rregulluese të kontrollit dhe rregullimit të tarifave me shumicë të terminimit nga AKEP.

Këshillimi publik për të dy dokumentat perfundonte me 7.02.2017 dhe kjo perudhë u zgjat pas pranimit të kërkesës së Vodafone Albania për shtyrje të procesit për shkak të negociatave midis operatorëve celularë për transferimin e radio-frekuancave të operatorit Plus Communication, cka pritej të sillte dhe një ndryshim në strukturën e tregut celular si dhe në qëndrimet e operatorëve celularë për dokumentat e nxjerrë në këshillim publik nga AKEP.

Procesi i transferimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication përfundoi me miratimin nga Autoriteti i Konkurrencës (AK) më 23.11.2017 dhe AKEP më 13.11.2017 dhe 1.12.2017 të kërkesës së këtij sipërmarrësi dhe sipërmarrësve të tjerë të përfshirë në proces.

AKEP me shkresën nr.2285 prot., datë 16.12.2017 i kërkoi operatorëve celularë Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom që në vijim të përfundimit të procesit të konsolidimit të tregut celular, brenda datës 15.01.2018, të depozitojnë komentet finale në lidhje me dokumentat “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*”⁷ dhe “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*”⁸, të nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016.

Tre operatorët celularë në vijim të komenteve të dërguara në Shkurt 2017 dhe Prill 2017, më datë **15.01.2018** depozituan në AKEP komentete/qendrimet finale në lidhje me dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik.

Pas marrjes se komenteve finale, AKEP me vendimin Nr.11 datë 22.02.2018 miratoi dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*” dhe me Vendimet nr.12, 13 dhe 14, datë 22.02.2018 vendosi:

- "Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese",
- "Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Telekëom Albania dhe vendosjen e masave rregulluese",
- "Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom dhe vendosjen e masave rregulluese".

Sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme sipas vendimeve të Këshillit Drejtues kanë detyrimet e mëposhtme për FNT për terminimin e thirrjeve:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39),
- Detyrimi i transparencës (Neni 40),
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42),
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto (Neni 45).

Duke reflektuar zhvillimet në treg gjatë vitit 2017, si dhe ndryshimin e strukturës së tregut nga 4 në 3 operatorë dhe rritjen e indeksit të përqendrimit të tregut, impakti i masave rregulluese dhe proporcionaliteti i tyre etj, AKEP me miratimin e dokumentit përfundimtar të analizës së tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, dhe vendimeve përkatëse për FNT dhje masat rregulluese për terminimin e thirrjeve kombëtare, vendosi të nisë dy procese të reja këshillimi publik:

⁷ Miratuar me Vendimin Nr.2699, datë 1.12.2016, për “*Miratimin për Këshillim Publik të Dokumentit: Analizë e tregut të shërbimeve celulare:Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*”

⁸ Vendim nr. 2700, datë 22. 12. 2016 për “*Miratimin për Këshillim Publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*”

- *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik nr.2.”*

AKEP, bazuar në ndryshimet e ndodhura në treg, ndryshimet në MTR benchmark në vendet e BEREC si dhe bazuar në komentet finale të operatorëve të dërguara në Janar 2018 (për dokumentin e parë të nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016), vendosi që të kryesjë një këshillim publik të ri për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare (MTR) duke përditësuar dokumentin e nxjerrë në këshillim publik më datë 22.12.2016 me të dhënat më të fundit të tarifave MTR në vendet e BEREC si dhe për të reflektuar më mirë ndryshimet e rëndësishme të ndodhura në treg gjatë vitit 2017. Afati i këshillimit publik të këtij dokumenti ishte 30 ditë dhe përfundoi më datë 29.03.2018.

- *“Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare- Këshillim Publik”*

Ky dokument përfshin një ri-vlerësim të pritshmërive të AKEP për tregun me pakicë celular dhe gjithë tregjet e tjera justifikueshme për ndërhyrje ex-ante pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular duke filluar nga data 1.01.2018. Dokumenti përmban dhe një diskutim më të gjerë për rishikimin ose jo të masës rregulluese të mos-diskriminimit në tarifatat me pakicë on-net/of-net dhe terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, propozim për FNT në tregun me pakicë celular dhe tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare. Procesi i këshillimit publik është 2 muaj (sipas nenit 34 të ligjit 9918) dhe përfundon më datë 28.04.2018.

1.2.3. Analiza e tregjeve me shumicë të telefonisë fikse

AKEP me Vendimin nr.28, datë 27.12.2017 miratoi mxjerren ne këshillim publik të dokumentit: *Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse– Këshillim Publik.*

Me këtë vendim, AKEP vendosi gjithashtu të shtyjë aplikimin e reduktimit të tarifave me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet publike telefonike fikse të parashikuar të fillojë më datë 1.01.2018, sipas Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2617-2620, datë 8.10.2015, të ndryshuara me VKD nr.2651, datë 03.12.2015, deri në afatet dhe nivelet e përcaktuara në vendimet përkatëse që do merren nga Këshilli Drejtues i AKEP në përfundim të procesit të këshillimit publik të dokumentit të miratuar.

Procedura e këshillimit publik për dokumentin e analizës së tregut si dhe masave rregulluese të propozuara për FNT, përfshirë rregullimin e tarifave me shumicë për FNT, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës, u krye për një periudhë 2 (dy mujore) dhe përfundoi me datë 28.02.2018.

AKEP me Vendimet Nr.21, datë 30.03.2018 miratoi versionin final të dokumnetit të analizës së tregut dhe me Vendimet Nr.22-24 përcaktoi Albtelecom, Telekom Albania dhe 67 operatorë Alternativë të rrjeteve fikse si sipërmarrës me FNT për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetete e tyre individuale fikse. Albtelecom u përcaktua me FNT dhe për tregun me shumicë të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse. Masat rregulluese përfshijnë detyrime për mos-diskriminim (për Albtelecom dhe detyrimi për RIO), transaprencë, dhënie aksesit dhe kontroll të tarifave të shërbimeve me shumicë të përcaktuar me FNT. Në lidhje me metodën e rregullimit të tarifave, AKEP me vendimin nr.25, datë 30.03.2018 miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumnetit: *Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendodhje fikse – Këshillim Publik*. Periudha e këshillimit publik për këtë dokument mbyllet më datë 7.05.2018.

1.3 SISTEMI I AUTORIZIMEVE, ADMISNITRIMI I BURIMEVE TË FUNDME DHE DOMAINIT

1.3.1 Regjimi i autorizimeve të përgjithshme

Me qëllim përditësimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator ekzistues për regjimin e autorizimit të përgjithshëm, AKEP me Vendimin Nr.19, datë 26.10.2017 miratoi Rregulloren Nr.47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, Rregullorja e re u miratua pas procesit të këshillimit publik dhe zëvendësoi rregulloren e mëparshme të miratuar më 2.02.2012. Nëpërmjet ndryshimeve të kryera AKEP vendosi për heqjen e pagesave që kryheshin nga sipërmarrësit për lëshimin e certifikave të konfirmimit, lehtësimin e barrierave administrative për autorizimet e përgjithshme, dhe rritjen e kërkesave për garantimin e ofrimit të shërbimeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe mbrojtjen e të drejtave të pajtimtarëve dhe përdoruesve.

Tabela më poshtë paraqet numrin e sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar për ofrim të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun deri në fund të vitit 2017.

TABELA 1:10 NUMRI I SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE/OSE SHËRBIMEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE (31.12.2017)

Shërbimi	Numri i sipërmarrësve të rregjistruar
Rjeteve dhe/ose shërbimeve publike të	204
Rrjete të komunikimeve elektronike që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale	139
Shërbim publik telefonik:	
- Rrjete fikse	76
- Rrjete celulare	2
- Kartë me parapagim	2
Shërbim të aksesit në Internet	170
Shërbime me vlerë të shtuar	26
Transmetim të dhënash	50
Linja me qira	23

Dhënia e autorizimeve, licencave dhe certifikatave për shërbimet ajrore/detare etj.

AKEP gjatë vitit 2017 në bashkëpunim me shoqatat e radioamatoreve shqiptarë zhvilloi në dy faza provimet për pajisjen me certifikata e aftësisë së radioamatorit dhe certifikatat e nivelit CEPT NOVICE ose HAREC të rreth 30 kandidatëve.

Subjektet e pajisur me Certifikata/Licenca për periudhën: 1 Janar 2017 - 31 Dhjetor 2017 janë:

1. Certifikatë Operatori Radiodetar të lëshuara	13
2. Licencë për stacionet radio anije të lëshuara	8
3. Licencë Radioamator i Huaj të lëshuara	6
4. Licencë Radioamator shqiptar të lëshuara	23
5. Autorizim për stacionet radio avion të lëshuara	2
6. Autorizim për stacionet radio bregdetar të lëshuara	2

Harmonizimi i pajisjeve radio / konfirmimi i miratimit të tipit / njoftimet për 2.4 / 5.8

Në veprimtarinë e AKEP, përfshihen e procedurat e njohjes së konformitetit të pajisjeve radio të telekomunikacioneve dhe kushtet/kërkesat teknike të përdorimit të frekuencave pa autorizim. Këto procedura AKEP i kryen në zbatim të rregulloreve:

- Rregullore Nr. 25, datë 14.06.2012 “Për Pajisjet Radio dhe Fundore të Telekomunikacioneve dhe Njohjen e Konformitetit të tyre”;
- Rregullore nr. 33, datë 15.05.2014 “Për kushtet e përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza”;

Në total për vitin 2017 janë lëshuar 39 konfirmime të Njohjes së Konformitetit të Pajisjeve për subjektet dhe janë kryer 82 deklarime për brezin 2.4/5.8 GHz aplikime të bëra nga 7 sipërmarrës në sistemin e aplikimeve.

1.3.2 Spektri i frekuencave

Administrimi i spektrit të frekuencave përbën një ndër drejtimet kryesore të veprimtarisë së AKEP dhe gjatë vitit 2017 kjo veprimtari është orientuar në zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit për rritjen e efektivitetit të përdorimit të tij si dhe zbatimit të politikës spektrale të Këshillit të Ministrave për zhvillimin e sektorit.

Rekomandimet e Kuvendit për:

- *Të marrë masa për administrimin eficient të spektrit të frekuencave dhe dhënien në përdorim të frekuencave në brezat që mundësojnë rritjen e kapaciteteve transmetuese për ofrimin e shërbimeve celulare 4G dhe ofrimin e shërbimeve 5G në të ardhmen sa më të afërt.*
- *Të marrë masat e nevojshme për hartimin e dokumenteve mbi strategjinë dhe objektivat për futjen e shërbimeve të lëvizshme në brezat e frekuencave 800 MHz, duke qenë se ecuria procesit të kalimit të transmetimeve audiovizive nga analoge në digjitale parashikon që në vitin 2017 ky brez do të kalojë në administrimin e AKEP-it,*

janë konsideruar maksimalisht dhe për zbatimin e tyre AKEP është angazhuar si në bashkëpunimin me Ministrin për përditësimin e Planit Kombëtar të Frekuencave ashtu dhe në përmbushjen e detyrimeve sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë dokument.

Përditësimi i Planit Kombëtar të Frekuencave

Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 277, datë 29.3.2017 miratoi Planin e ri Kombëtar të Frekuencave, i cili zëvendëson planin e miratuar me VKM nr.466, datë 27.02.2013. Ky plan është i bazuar tek Rregulloret e ITU dhe Publikimet e CEPT për radiofrekuencat. Plani është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizata ndërkombëtare.

Plani përcakton brezat e frekuencave dhe shërbimet përkatëse të radiokomunikimit, gjithashtu për secilin përdorim plani ka përcaktuar edhe administratorin e spektrit. Plani ka të përcaktuara edhe rekomandimet dhe standardet teknike respektive që aplikohen për çdo përdorim të brezave të frekuencave.

AKEP ka kontribuar në dhënien e informacionit dhe parashikimin e futjes së aplikimeve të reja në breza të caktuar frekuencash në përputhje me vendimet e Konferencës Botërore të Radiokomunikacioneve dhe CEPT. Kemi koordinuar me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme, SHISH etj. për të parashikuar në PPF përdorimin e brezave për qëllime ushtarake dhe sigurie kombëtare. Janë asistuar dhe mbështetur vazhdimisht sipas nevojave të tyre me frekuenca për qëllime të sigurisë dhe veprimeve ushtarake.

AKEP ka qënë pjesë e disa grupeve të punës për studimin e futjes së shërbimeve të lëvizëshme në brezat 800 MHz, 700 MHz dhe strategjinë e zhvillimit të spektrit në Shqipëri. Me propozimin e AKEP, Këshilli i Ministrave miratoi ndryshimet në vendimin për pagesat në AKEP duke e përshtatur atë me vendimet e fundit të ERC dhe CEPT. Pjesë e këtyre ndryshimeve ishte edhe heqja e pagesës për radioamatorët e huaj që operojnë në Shqipëri për një periudhë të caktuar kohe.

Përgatitja e Planit të Përdorimit të Frekuencave dhe administrimit të brezave të frekuencave të caktuara për qëllime civile

Plani Kombëtar i Frekuencave i miratuar me VKM Nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” i cili ka implementuar ndryshimet e pasqyruara në ECA (*The European Table of Frequency Allocations and Applications-June 2016*), ka sjellë si pasojë që breza të caktuar frekuence të pësojnë ndryshime. AKEP në zbatim të detyrimeve ligjore, ligji 9918, dhe VKM Nr.277 përgatiti dhe miratoi në KD me Vendimin Nr.18, datë 26.10.2017, Planin e Përdorimit të Frekuencave, duke shtuar përdorimin e një sërë shërbimesh radio dhe duke bërë të mundur:

- Teknikisht dhe ekonomikisht planifikimin optimal, caktimin dhe përdorimin efikas të frekuencave, duke marrë parasysh që spektri i radiofrekuencave dhe orbita gjeostacionare janë në vetvete burime të rralla dhe të fundme;
- Përfitim të kushteve për përgatitjen e rregullave mbi kushtet teknike dhe operative për përdorimin e disa frekuencave;
- Mbrojtjen nga interferencat e dëmshme;
- Rregullimin e Planit me modifikimet në nivel ndërkombëtar, si edhe bashkërendimet që rezultojnë nga përmbushja e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe me fqinjët dhe vendet e tjera;
- Rregullimin e përdorimit të brezave të frekuencave ndërmjet shërbimeve radio dhe përdoruesve; dhe
- Implementimin e teknologjive të reja dhe zhvillimin e komunikimeve radio.

Plani i përdorimit të frekuencave përfshin:

- a) brezat e frekuencave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF) të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave” (PKF), për përdorime “civile”, të cilat mund të përdoren për qëllime civile, si dhe zbatimet e shërbimeve radio të përcaktuara në këto breza frekuencash;
- b) rregullat lidhur me përdorimin e brezave të frekuencave, përfshi karakteristika të administrimit të frekuencave për rrjete të radiokomunikimeve dhe radio stacionet dhe të pajisjeve radio, metodën e dhënies së frekuencave, raste të ndryshëm nga autorizimi individual i përdorimit të frekuencave, kërkesat teknike dhe kushtet e operimit lidhur me operimin e radio sistemeve;
- c) Implementimin e ndryshimeve të rëndësishme që kanë pësuar brezat GSM, IMT, BWA, etj. si përsa i përket teknologjive të aplikuara në këto breza ashtu edhe shërbimeve të ofruara.

Dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave

AKEP një ndër funksionet kryesore të tij ka edhe trajtimin e aplikimeve dhe pajisjen me autorizim individual për përdorimin e frekuencave. Bazuar në Rregulloren nr.30 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, miratuar me VKD nr. 2395, datë 05.12.2013, procedura e aplikimit për Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave, bëhet duke plotësuar nga aplikanti/kërkuesi që kërkon të pajiset me Autorizim Individual, format përkatëse të cilat gjenden të publikuara në faqen elektronike të AKEP web:www.akep.al në seksionin *e-Aplikime*.

Gjatë vitit 2017, për operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike nga AKEP janë lëshuar 21 autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në 326 lidhje fikse të reja/ndryshuara. Gjithashtu, janë në total **211 subjekte** të pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave në sisteme PMR radiokomunikimi/radioalarmi. Nga këta 10

subjekte kanë shtrirje më të madhe duke mbuluar me shërbim pothuajse gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Pjesa tjetër e subjekteve kanë sisteme PMR në një zone më të kufizuar shërbimi.

Mbi procedurën e transferimit të frekuencave të brezave 900/1800/2100 MHz të sipërmarrësit Plus Communication sh.a

Sipërmarrësi Plus Communication sh.a. ushtroi veprimtarinë e vet në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 745, datë 26.06.2009, i ndryshuar me VKD Nr. 2567, datë 11.05.2015 dhe është pajisur nga AKEP me Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 me qëllim ndërtimin e rrjetit të lëvizshëm të komunikimeve publike GSM, për ofrimin e shërbimit publik telefonik të lëvizshëm tokësor në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKEP, me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2677, datë 21.04.2016 kishte pajisur me Autorizim Individual sipërmarrësin “Plus Communication” sh.a., për përdorimin e frekuencave në brezin 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160 - 2170 MHz.

Me kërkesën e Plus Communication AKEP me Vendimin Nr.20, datë 13.11.2017 për *“Dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication Sh.a., tek sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a., dhe Vodafone Albania Sh.a”* vendosi dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e kërkuar.

Procesi i transferimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication përfundoi me miratimin nga Autoriteti i Konkurrencës (AK) dhe AKEP të kërkesës së këtij sipërmarrësi dhe sipërmarrësve të tjerë të përfshirë në proces.

AK miratoi transaksionet me vendimet e mëposhtme:

- Vendim Nr. 484, Datë 23.11.2017 Për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication Sha tek Vodafone Albania Sha”
- Vendim Nr. 485, Datë 23.11.2017 Për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication Sha tek Telekom Albania Sha”

Pas vendimeve të mësipërme të AK, AKEP miratoi përfundimisht këtë proces me Vendimet e mëposhtme:

- Vendim Nr.21, datë 01.12.2017 Mbi “Dhënien e Autorizimeve individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication Sh.a tek Sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.a.”
- Vendim Nr.22, datë 01.12.2017 Mbi “Dhënien e Autorizimeve individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të

përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication Sh.a tek Sipërmarrësi Telekom Albania Sh.a.”

Transaksionet e mësipërme përfshinë transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave që dispononte sipas autorizimeve individuale përkatëse sipërmarrësi Plus Communication sh.a në brezat 900/1800/1900/2100 MHz tek sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a dhe Telekom Albania sh.a. Plus transferoi të gjithë spektrin e frekuencave në brezat e cituar në mënyrë të barabartë tek dy operatorët e tjerë celularë, Vodafone Albania dhe Telekom Albania, dhe ky transferim u reflektua në autorizimet individuale të këtyre operatorëve për radiofrekuenca sipas vendimeve të mësipërme të AKEP. Pjesë e këtij procesi ishte edhe Albtelecom, i cili megjithëse nuk përfitoi frekuenca nga transferimi, shprehu dakortësinë për procesin si dhe për marrëveshjet që palët nënshkruan për pagesat për tarifat e terminimit të aplikueshme në rrjetin Plus nga data 1.04.2015 e në vijim dhe zgjidhjen me dakortësi të proceseve gjyqësore midis Plus dhe tre operatorëve të tjerë celularë.

Në bazë të vendimeve të AKEP, transferimi i radiofrekuencave u bë efektiv më datën 1.01.2018, dhe prej kësaj date Plus Communication nuk ofron më shërbime rrjeti celular. Gjatë muajit Dhjetor 2017, pajtimtarët e rrjetit Plus që zotëronin numër celularë me kod 067, 068 dhe 069 mund të kryenin portim të numrit në një prej operatorëve të tjerë celularë sipas preferencës së tyre, ndërsa nga data 1.01.2018 këta numra i kaluan operatorëve dhënë fillestare apo që zotërojnë kodet përkatëse, Albtelecom, Telekom Albania dhe Vodafone Albania përkatësisht. Ndërkohë për shkak të mos-gjetjes së zgjidhjes teknike dhe komerciale, të gjithë numrat me kod 066 kaluan në administrimin e AKEP, si burime të fundme natyrore, duke filluar nga data 1.01.2018.

Proceset për brezin 800 MHz/DD1 (Digital Divident 1)

Brezi 800 MHz (790-862 MHz) ose ndryshe i quajtur DD1 (Digital Divident 1) me gjithë përcaktimin e vendosur në Planin Kombëtar të Frekuencave për përdorimin e tij nga operatorët celularë si dhe afatin e parashikuar (30.62017) për kalimin e administrimit të tij nga AMA tek AKEP edhe gjatë vitit 2017 vazhdoi të ishte nën administrimin e AMA deri në përfundimin e procesit të kalimit nga transmetime analoge në transmetime dixhitale. Pas përfundimit të këtij procesi ky brez pritet të bëhet i disponueshëm për futjen e shërbimeve të lëvizshme, nën administrimin e AKEP.

Në zbatim të akteve ligjore si Vendimi Nr. 468, datë 30.05.2013, të Këshillit të Ministrave, për “Miratimin e planit Kombëtar për zhvillimin e Broadband-it”, i ndryshuar, Strategjinë ndërsektoriale “Afhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020” parashikohej që viti 2017 të ishte vit kur ky brez do të kalonte në administrimin e AKEP dhe do të bëhej e mundur futja e shërbimeve të lëvizshme në brezin 800 MHz.

Bazuar në përcaktimet dhe rekomandimet ndërkombëtare si dhe në eksperiencat e vendeve të tjera me marrjen në administrim të spektrit (siç përcaktohet në PKF të miratuar me VKM Nr.277, datë 29.03.2017) AKEP realizoi një këshillim publik me tregun. Ky këshillim publik do të bënte të mundur që nëpërmjet çështjeve që do të trajtonte të merrte maksimumin e mundshëm për ndërtimin e një procedure të saktë, transparente, asnjwanëse për dhënien në përdorim të tyre. Në përfundim të këshillimit publik nuk u vijua me procedurën e dhënies në

përdorim për shërbimet e lëvizshme pasi brezi ishte akoma në përdorim nga transmetuesit analoge audiovizive.

Aktualisht, me kërkesë të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, AKEP ka nisur një proces të ri këshillimi publik me palët e interesuara, i cili përfundon në muajin Prill 2018, për të mundësuar dhënien e këtij brezi në përdorim nga operatorët celularë për ofrimin e shërbimeve LTE ose siç njohën ndryshe si shërbimet 5G.

Bashkërendimi i punës me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave.

AKEP vitet e fundit ka shtuar të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur nënshkrimin e marrëveshjeve teknike me qëllim koordinimin ndërkuftar. Kryesisht është punuar për arritjen e marrëveshjeve të koordinimit për sistemet GSM/DCS1800 për të shmangur në maksimum interferencat në zonat kufitare. Janë në fuqi marrëveshjet me Autoritetin e Kosovës, të Malit të Zi dhe Autoritetin Maqedonas. Ndërkohë AKEP vazhdon bashkëpunimin me Autoritetin e Malit të Zi dhe Kosovës për menaxhimin e parametrave teknike të stacioneve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse dhe vendosjen e tyre në normat e lejuara.

1.3.3 Numeracioni

Numeracioni për shërbimet e komunikimeve elektronike

Një ndër detyrat kryesore të AKEP për menaxhimin e burimeve të fundme është menaxhimi i mirë i numeracionit nëpërmjet trajtimit të aplikimeve për caktimin dhe anulimin e numeracionit bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Procedura e aplikimit për caktim ose anulim numeracioni, bëhet online në sistemin RevZone duke u plotësuar nga aplikanti/kërkuesi që kërkon të pajiset/anullojë numeracion, nëpërmjet formave përkatëse të cilat gjenden të publikuara në faqen elektronike të AKEP web: www.akep.al në seksionin e-Aplikime.

Gjatë viti 2017 janë përpunuar dhe procesuar:

- Alokime numra dhe seri numerike, janë trajtuar 33 aplikime.
- Anullim numeracioni, janë trajtuar 27 aplikime

Numrat për shërbimet e mergjencës

Bazuar në ligjin 9918 dhe aktet ligjore dhe nënligjore për shërbimin e urgjencës mjekësore, AKEP në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë gjatë vitit 2017 konfirmoi njohjen e përdorimit të numrit 127 për shërbimin e urgjencave mjekësore nga Qendra Kombëtare e Urgjencave Mjekësore (QKUM), Tiranë. Për bërjen funksional të tij AKEP bashkëpunoi me operatorët dhe institucionet përkatëse.

AKEP, në cilësinë e organit rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, ka koordinuar veprimet me Ministrinë e Brendshme dhe operatorët, për masat që do të ndërmerren nga ana e operatorëve, mbi implementimin e numrit të emergjencave kombëtare dhe të sistemit për zbatimin e AML dhe aktivizimin e shërbimit të dërgimit të mesazheve SMS drejt Numrit Unifikuar të Emergjencave 112.

Sigurimi i disponueshmërisë së bazës qendrore të të dhënave për portabilitetin e numrit

Në mënyrë të vazhdueshme AKEP ka ndjekur funksionimin e sistemit të portabilitetit të numrit CRDB. Objektivat e AKEP janë funksionimi dhe operimi normal i sistemit të CRDB sipas Rregullores dhe realizimi i procesit të bartjes së numrave për pajtimtarët. Edhe gjatë vitit 2017 është kryer menaxhimi i sistemit dhe komunikimit midis operatorëve dhe ofruesit të CRDB dhe gjenerimi i raporteve përkatëse periodike në lidhje me mbarëvajtjen nga ana teknike e procesit të bartjes së numrit dhe operatorëve. Sipas të dhënave të CRDB (bazës së të dhënave të këtij sistemi) rezulton një shifër prej afro 250738 numrash mobile dhe 742 numrash fiks të bartur. Tabela e mëposhtme paraqet sasinë e numrave të bartur deri në fund të viteve 2016 dhe 2017.

TABELA 1.11: NUMRTA E PORTUAR DERI NE FUND TE VITIT 2016-2017

Shërbimi Telefonik	I lëvizshëm		Fiks	
	2016	2017	2016	2017
Viti Numra të bartur	150703	250738	1361	742

1.3.4 Administrimi i domain cc.TLD.al dhe nëndomanët e tij

Nr. domain-eve të regjistruar për vitin 2017 është 5848 dhe është arritur në total një numër prej 20178 domain-e. Në terma statistikore vihet re se kemi pothuajse të njëjtin numër të domain-eve të regjistruar krahasur me vitin 2016, ndërsa rritja totale e numrit të domain-eve nën.al është 10% krahasuar me një vit më parë.

Vazhdon përsëri edhe për vitin 2017 trendi i regjistrimit të domain-eve tek regjistrarët e akredituar ku AKEP mbetet regjistrar në vendin e tretë për sa i perket numrit total të domain-eve. Numri i domain-eve sipas regjistrarëve është paraqitur në tabelën më poshtë:

TABELA 1.12. NUMRI I DOMAIN-EVE SIPAS REGJISTRARËVE

Regjistrari	Nr. Domain në 2016	Regjistrime në 2017	Nr. Domain në 2017
AKEP	3068	260	3200
Albtelecom sh.a	68	24	72
ShqipëriaCom sh.p.k	7272	2330	7992
Webhost sh.p.k	5885	2364	6227
Keminet sh.p.k	1105	286	1309
Studio Driar	680	150	680

Digicom shpk	0	0	0
EderHost	0	434	698

Është kryer administrimi dhe mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të regjistrimit të domain name dhe të root server-ave të .al, procesimi i aplikimeve kryesisht për regjistrim dhe modifikim teknik në përputhje me Rregulloren nr.2. Për regjistrimin e domain-eve në zonën .al dhe nën domain-eve .gov.al, .edu.al, .org.al, .com.al, .mil.al, .net.al

Bazuar në numrin e domain-eve të regjistruar gjatë vitit 2017 dhe në numrin e tyre në fund të vitit 2017, rezulton se më shumë se 3500 domain-e nuk janë rinovuar. Për këtë arsye dhe rritja e numrit të domain-eve të regjistruar është në vlerën e rreth 11%. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare të dhenat e detajuara të numrit të domain-eve, deri në fund të vitit për pesë vitet e fundit.

TABELA 1.13: NUMRI AKUMULATIV I DOMAINEVE TE REGJISTRUAR

Domain	Domain-e të regjistruar deri 2012	Domain-e të regjistruar deri 2013	Domain-e të regjistruar deri 2014	Domain-e të regjistruar deri 2015	Domain-e të regjistruar deri 2016	Domain-e të regjistruar deri 2017
.al	8334	11466	12530	14621	16529	18493
.com.al	630	748	676	774	899	990
.gov.al	301	337	265	275	296	338
.org.al	134	165	145	145	159	156
.edu.al	133	129	106	120	137	143
.net.al	28	35	30	37	56	56
.mil.al	8	8	2	3	2	2
Total	9568	12888	13760	15975	18078	20178

Gjatë vitit 2017 janë ngritur disa problematika për regjistrimin dhe përdorimin e emrave në zonën .al, nga palë të interesuara të fushave të ndryshme.

AKEP me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator lidhur me ushtrimin e kompetencës ligjore për administrimin e domain-eve .al, ka nisur një proces veprimesh administrative të përcaktuara dhe të bëra të ditur për palët e interesuara nëpërmjet Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 25 datë 15.12.2017 “Për marrjen e disa masave mbi shqetësimet lidhur me emrat nën domainet .al”. AKEP ka nxjerrë për konsultim publik disa ndryshime në rregulloren për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”. Gjithashtu AKEP ka kryer shqyrtime të disa Ankimeve Administrativ dhe ka marrë masa për analizën e situatës. Në ndryshimet e parashikuara janë shtruar për shqyrtim çështjet mbi mundësinë e shqyrtimit të mos-marrëveshjeve nga AKEP, mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe asaj industriale.

Gjithashtu gjatë vitit 2017 është kryer administrimi i sistemeve mbështetëse të cctld.al si:

- Monitorim i aksesit të jashtëm të Sistemit DNS, lidhjet përkatëse me ISP, ku shërbimi është ofruar nga 2 ISP, linja primare nga Altelecom sh.a dhe linja sekondare nga ABCOM shpk kanë qënë në nivelin e kërkuar, pra një aksueshmëri në internet prej 100% për cctld.al,
- Monitorim dhe administrim i sistemit FRED, sistem i menaxhimit të domain .al.,
- Ndjekja e problematikës dhe implementimi i zgjidhjeve për raportimet e regjistruësve të akredituar.

Sa i përket sistemit qendror të administrimit të domain-eve .al janë kryer disa përmirësime në shërbimet e ofruara për regjistrarët e akredituar dhe në administrimin e domain-eve në tërësi. Janë shtuar shërbimet e njoftimit dhe raportimit si më poshtë:

- Gjenerimi automatik i raporteve mujore,
- Raport i ndarjes së poseduesve,
- Raport sipas statusit, listimi i aplikanteve,
- Raport sa herë janë bërë kërkesa në API (implementimi dhe ruajtja e vlerës së Databazës).

Gjatë vitit 2017 është përmirësuar komunikimi i regjistrarëve nga API dhe janë shtuar funksionalitetet si vijon:

- Ofrimi i IPv6
- Implementimi i shërbimit për updatë të NS me gtld të rinj,
- Gjenerimi i çertifikatave të reja të sigurisë për regjistrarët (nga sistemi qendror).

Shërbimet e mësipërme u shtojnë më shumë lirshmëri veprimi dhe komunikimi regjistrarëve të akredituar si dhe përmirësojnë komunikimin e sistemin qendror të administrimit të domain-eve .al.

Gjithashtu gjatë vitit 2017 është kompletuar sistemi i shpërndarjes së zonës .al dhe nën-zonave me shërbimin Anycast si dhe është kryer përmirësimi i Hardware mbi të cilat funksionon ccTLD.al si dhe janë përmirësuar komunikimet e tij në ndërfaqet API dhe Web.

1.4 INSPEKTIMI DHE MONITORIMI I SPEKTRIT TE FREKUENCAVE

Gjatë vitit 2017, krahas zbatimit të detyrimeve ligjore në këtë drejtim, vëmendja dhe veprimtaria e AKEP është orientuar për përmbushjen e rekomandimeve të Kuvendit:

- *Të monitorojë me rigorozitet zbatimin e rregullave teknike, të përcaktuara në rregulloren nr. 22, datë 24.6.2011, “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”, për stabilizimin dhe standardizimin e rrjeteve kabllore të komunikimeve elektronike, situatë e cila, me gjithë përmirësimet e bëra, mbetet akoma problematike.*
- *Të marrë masa për ushtrimin e kërkesave rregullatore në adresë të sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike për zbatimin e standardeve teknike, në përputhje të plotë me kërkesat dhe rekomandimet e ITU, si dhe të treguesve cilësorë (QoS) të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve.*
- *Të vijojë monitorimin e mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS/IMT/LTE në qytetet kryesore të Shqipërisë, rrugët kryesore kombëtare, zonat urbane dhe pikat turistike, si dhe në zonat me densitet të ulët të popullsisë, të cilat do të mbulohen me shërbime broadband.*
- *Të marrë masa për administrimin e interferencave dhe zgjidhjen e tyre në rastet e ankesave për ndërhyrje të dëmshme që vijnë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.*

1.4.1 Inspektimi i operatorëve të komunikimeve elektronike

Në vitin 2017 AKEP ka kryer gjithësej 69 inspektime tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm. Gjatë këtyre inspektimeve u konstatua se 40 sipërmarrës ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm (të cilëve ju lanë disa detyra dhe rekomandime), dhe 12 sipërmarrës nuk kishin zbatuar rregulloret e miratura nga AKEP dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative me gjobë dhe 17 sipërmarrës u çregjistruan sipas ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Për zbatimin e rregullave teknike të përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008 dhe Rregulloren Nr.22 datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”, është punuar për detyrimin e sipërmarrësve të cilët ndërtojnë ose përdorin rrjete të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, që të zbatojnë kushtet e parashikuara në legjislacion për të mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

Gjatë vitit 2017 u arrit të bëhet një përmirësim rrënjësor i këtyre rrjeteve në qytetet kryesore të vendit, ku u shmangën rrjetet e komunikimeve elektronike nga rrjetet e energjisë dhe në shumicën e rrugëve kryesore dhe qendra tashmë kanë përfunduar ose është në proces përmbyllja e shmangieve. Kjo është një arritje e rëndësishme për garancinë e rrjeteve në uljen e rrezikshmërisë të këtyre instalimeve të rrezikshme për jetën e personelit të sipërmarrësve, përmirësimi i mirëmbajtjes si të rrjeteve të komunikimeve elektronike, por dhe të energjisë dhe ndriçimit. Masat e marra deri tani kanë sjellë në zonat e ndërhyra një gjendje krejtësisht tjetër si në sigurimin teknik dhe treguesit e cilësisë së shërbimit por edhe në aspektin estetik dhe urbanistik të këtyre zonave. AKEP ka krijuar mundësinë e konsultimit me web-in e AKEP në adresën: <http://www.akep.al/foto-galeri>).

AKEP, gjatë gjithë vitit 2017 ka mbikëqyrur vazhdimisht punën e sipërmarrësve të rrjeteve për largimin dhe sistemimin e kabllave të rrjeteve të tyre dhe ndërhyrjen në fasadat e apartamenteve në disa zona të nxehta të Tiranës. Vlen të përmendet rritja e përgjegjshmërisë së sipërmarrësve të rrjeteve ndaj këtij problemi, pasi sistemimet e kabllave pas largimit nga shtyllat bëhet në mënyrë më të kujdesshme dhe tentohet drejt instalimeve të teknologjive bashkëkohore me preferencë fibrën optike ku siç dihet një fibër optike zëvendëson shumë kablo të tjera.

Ashtu siç ka vepruar deri më tani, AKEP do të koordinojë punën mes operatorëve dhe OSHEE, për koordinimin e veprimeve operative në zona ku ka ndërthurje të rrjeteve si dhe do të jetë në ndjekje të planit në dinamikë.

Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike kanë ngritur shqetësimin se jo në të gjitha rastet iu krijohet mundësia për shtrimin e tubacioneve të tyre. Ata janë duke u përballur me vështirësi në marrjen e lejeve për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme apo për të drejtat e përdorimit të tubacioneve nëntokësore që janë në administrim nga Bashkitë, të cilat në disa raste janë edhe selektive.

AKEP iu ka derguar secilës bashki, rrjetin nëntokësor që aktualisht është i ndërtuar në qytetin respektiv, sipas sipërmarrësve përkatës. Për të dhëna më të detajuara mbi këtë informacion, AKEP ka krijuar mundësinë e konsultimit me platformën dixhitale të infrastrukturës që AKEP ka ngritur, në adresën <http://broadband.akep.al/akepi/atlas/>.

AKEP është i gatshëm të ndihmojë në koordinimin e punës me sipërmarrësit gjatë fazës së kryerjes të këtyre punimeve, për të disiplinuar përfundimisht këtë pjesë shumë problematike dhe jashtë kushteve, në disa raste dhe atyre më minimale, që kërkohen për mirëfunktionimin e tyre në standartet e kërkesave të rrjeteve broadband (me brez të gjerë).

1.4.2 Monitorimi i përdorimit të frekuencave

Gjatë vitit 2017 në zbatim të Rregullores Nr. 35 datë 23.12.2014 për “Administrimin e interferencave”, miratuar me Vendim Nr. 2529, datë 23.12.2014 të Këshillit Drejtues të

AKEP, janë trajtuar ankesa nga subjektet e radionavigacionit brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë dhe janë marrë masat përkatëse.

AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me AMA-n për marrjen e masave ndaj subjekteve *broadcast* që shkaktojnë interferenca. Njëkohësisht është koordinuar me veprime të përbashkëta me Ablcontrol për mbajtjen në kontroll të brezit të frekuencave të cilat përdoren për shërbime radionavigimi.

Ngritje e Urdhërit të përbashkët midis AKEP dhe AMA Nr.88, datë 18.04.2017 “Për Monitorimin e procesit të lirimit të Dividentit të Parë Numerik (DDI) nga transmetimet audiovizive në të gjithë territorin e vendit” në mënyrë që të jepet garanci procesit të lirimit të brezit 790-862 MHz nga transmetimet audiovizuale dhe të krijohen kushtet për një proces teknikisht të sigurtë, nga çdo interferencë ose përdorim i pa autorizuar i spektrit, nga subjekte të ndryshme. Sipas një plani monitorimi janë realizuar matje në qarqet kryesore të vendit gjatë muajt Maj 2017, nga grupi i përbashkë me përfaqësues të AMA dhe AKEP.

Gjatë vitit 2017 janë mbajtur marrëdhënie institucionale dhe është bashkëpunuar me rregullatorin e Malit të Zi EKIP dhe Ministria e Transportit, Infrastruktues dhe Rrjetit të Republikës së Greqisë, për trajtimin e problematikave që janë shfaqur në rastet e ndërferncave të shkaktuara.

Për monitorimin e treguesve të cilësisë së rrjeteve dhe shërbimeve të ofruara për publikun nga operatorët, AKEP ka kryer monitorimin e cilësisë së shërbimit të qyteteve dhe akseve rrugore për teknologjitë GSM/UMTS/LTE për tre operatorët mobile në Republikën e Shqipërisë përkatësisht: Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom të pajisur me autorizime për ofrimin e shërbimit për këto teknologji, si më poshtë:

1.4.3 Përmirësimi i mbulimit me sinjal celular në zonat turistike

Me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimit broadband në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas marrëveshjes së arritur midis operatorëve mobile përkatësisht: Telekom Albania, Vodafone Albania dhe ALBtelecom, u kryhen matje në disa prej zonave turistike gjatë vitit 2017 dhe do të kryhen matje përgjatë vitit 2018 për verifikimin e tyre sipas specifikimeve përkatëse.

Për investime të përbashkëta të operatorëve mobilë për shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve GSM/UMTS/LTE përkatësisht:

- Vermosh Qendër,
- Valbona Qendër,
- Gërmenj,
- Kepi i Rodonit,
- Shkopet,

- Grykë Nokë.

Për bashkëpunim midis operatorëve mobile për shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve GSM/UMTS/LTE përkatësisht:

- Qafë Shtama,
- Lura Fshat,
- Qafa e Vishës,
- Thethi,
- Gorica,
- Tri Porti (Vlorë).

Shkak i shtrirjes së verifikimit përgjatë vitit 2018 të marrëveshjes së operatorëve mobile në Republikën e Shqipërisë për zonat e mësipërme është bërë vonesa e marrjes së lejes së ndërtimit të stacioneve nga autoritetet lokale.

1.4.4 Zhvillimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimi i të drejtës së kalimit

Rekomandimi i Kuvendit në këtë drejtim pune është:

- *Të marrë masat e nevojshme për ndjekjen në vazhdimësi të përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër nga operatorët, si dhe të vijojë bashkëpunimin me institucionet shtetërore si ministritë, njësitë vendore, Autoritetin Rrugor Shqiptar etj., në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it”, të ndryshuar, për mbulimin me shërbim në zonat me densitet të ulët të popullsisë me shërbime broadband dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.*

Për këtë, AKEP në zbatim të Planit Kombëtar të Zhvillimit të Broadband miratuar me VKM 300, datë 8.4.2015, i ndryshuar, ka ndjekur në vijëmbësi përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga sipërmarrësit Altelecom sh.a., Telekom Albania sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a., për mbulimin me shërbime broadband në zonat me densitet të ulët të popullsisë dhe të zonave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Për të koordinuar veprimet mes sipërmarrësve të lartpërmendur dhe institucioneve si Autoriteti Rrugor Shqiptar, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, AKEP, ka nënshkruar më datë 13.05.2016, Marrëveshje Bashkëpunimi, ku palët bien dakord të koordinojnë veprimet dhe shkëmbejnë informacionin e nevojshëm në fushën e ndërtimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike. Në këtë kontekst, informacioni i marrë nga këto institucione ARRSH, FSHZH dhe Bashkitë përkatëse iu është vënë në dispozicion operatorëve duke u publikuar edhe në faqen e AKEP.

Nga AKEP në mënyrë periodike është ndjekur procesi i përmbushjes së detyrimit për mbulim me shërbime broadband nga operatorët, duke iu kërkuar në mënyrë periodike të raportojnë për ecurinë e procesit gjatë gjithë 2017. Gjatë këtyre raportimeve, përveç të tjerave, operatorët kanë ngritur problematika në lidhje me procedurat e pajisjes me leje

infrastrukturore, në disa zona të caktuara ku kanë hasur vështirësi në realizimin e investimeve, duke theksuar procedurat e tejzgjatura të dhënies së lejeve nga disa Bashki apo edhe institucione. Me qëllim përshpejtimin e procesit të marrjes së këtyre lejeve nga operatorët, AKEP iu është drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Urban, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Mjedisit, Ministrinë të Shtetit për Cështjet Vendore, ALUZNI etj. Këto institucione i janë përgjigjur menjëherë kësaj kërkesë duke ofruar bashkëpunim dhe ndihmë në këtë proces, duke sensibilizuar edhe Bashkitë e zonave përkatëse.

1.4.5 Projekti “Sistemi kombëtar i monitorimit të spektrit të frekuencave për Shqipërinë”

Monitorimi i spektrit të frekuencave është një nga mjetet kryesore të administrimit të spektrit të frekuencave. Teknikat e monitorimit të spektrit janë zhvilluar në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfshirjen e të gjithë parametrave dhe standardeve të radiokomunikimeve. Përveç kësaj, monitorimi i spektrit ndihmon në promovimin e një përdorimi eficient të spektrit të radio frekuencave dhe të orbitës së sateliteve gjeostacionarë.

Qëllimi i këtij projekti është të trajtojë karakteristikat thelbësore të teknikave dhe veprimtarisë së monitorimit të spektrit të radiofrekuencave në një sistem kombëtar të vendit tonë. Studimi për sistemin kombëtar shqiptar të monitorimit të spektrit është kryer një grup pune i AKEP-it në bashkëpunim me asistencën e ITU dhe është përcaktuar që pajisjet e monitorimit, në të gjitha funksionet dhe matjet, do të jenë në përputhje me kërkesat e Rekomandimeve ITU- R (si psh SM.1050, SM.1139, SM.1392, SM.1537 etj dhe Manualin e ITU mbi Monitorimin e Spektrit të Frekuencave.

Kontrolli i gjithë sistemit të monitorimit bëhet Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC) e cila është pjesë e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave – QKMF, tek godina e AKEP në Tiranë. Nga QKMF është e mundur të kontrollohen në distancë gjithë Stacionet Fikse të Monitorimit në distancë dhe Stacioni i transportueshem i monitorimit.

Në vijim të zbatimit të “Projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave” hartuar me konsulencën e ekspertëve të ITU-se, është bërë i mundur ndërtimi i 2 (dy) Stacioneve Fikse të Monitorimit (RFMS) të Spektrit të Radiofrekuencave në Pinet dhe Krujë, për monitorimin e zonave të rëndësishme Tiranë – Durrës – Aeroporti i Rinasit, si zona mjaft të okupuara nga radiokomunikimet.

Në vijim të procedurës tenderuese të nisur nga AKEP në datën 21.03.2016 “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave” – Pajisje për stacion të thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë, pas disa proceseve gjyqësore, në datën 09.11.2017 u nënshkrua kontrata me operatorin fitues.

Aktualisht zbatimi i kontratës është në vijim dhe janë instaluar 2 (dy) stacionet fikse të Spektrit të Radiofrekuencave në Shkodër dhe Vlorë. Këto dy stacione janë duke u testuar dhe do të merren në dorëzim pas integritit të software të tyre me software-in e menaxhimit të dy stacioneve të mëparshme të monitorimit dhe software-in e administrimit të spektrit të frekuencave.

Me datë 09.11.2017 është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave” - Ndërtimi i 3 Stacioneve të Thjeshtë Fiks Monitorimi në Distancë (SRFMS) në Korçë, Gjirokastrë, Fier dhe 1 Stacion Monitorimi i Transportueshëm (TMS)”. Kontrata u nënshkrua me datë 26.12.2017.

Aktualisht vijon zbatimi i kushteve të kontratës dhe është kryer studimi i vendvendosjes së këtyre stacioneve fikse të monitorimit në Korçë, Gjirokastrë dhe Fier, janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtyre stacioneve dhe së shpejti fillon montimi i tyre. Edhe për këto stacione fikse monitorimi, procesi do të përmbyllet me testimin dhe vendosjen në funksionim të këtyre stacioneve si dhe me realizimin e integritit të software të tyre me software-t e menaxhimit të katër (dy+dy) stacioneve aktuale të monitorimit dhe software-in e administrimit të spektrit të frekuencave.

1.4.6 Sistemi i përqëndruar i informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike

Rekomandimi i Kuvendit në këtë drejtim pune është:

- *Të marrë masat për përmbushjen e detyrimeve, si dhe miratimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve të nevojshme, në kuadër të ligjit të ri nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.*

Për këtë, duke e vlerësuar si një detyrë e rëndësishme, në zbatim të ligjit nr. 9918/2008, AKEP ka miratuar rregullore lidhur me përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe Rregullore për Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, i cili përmban informacion mbi: rrjetet publike të komunikimeve elektronike, objektet e komunikimeve elektronike, të dhëna për rruge kabllorë dhe për radio transmetuesit. Ky informacion hidhet nga Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike të cilët kanë akses online në regjistrin elektronik.

Akses tek ky regjistër elektronik, kanë edhe subjekte të tjerë të interesuar për të dhënat mbi rrjetet e komunikimeve elektronike si Bashkitë apo njësitë e tjera administrative. Sipërmarrësit dhe përfaqësuesit e bashkive, janë njoftuar në vazhdimësi nga AKEP në lidhje me mundësimin e aksesit duke u pajisur me kodet përkatëse.

Për 2017 ka vijuar bashkërendimi i veprimeve me të gjithë aktorët e interesuar për shkëmbim i informacioni për rrjetin e komunikimeve elektronike. Është bashkëpunuar me ministrinë përgjegjëse në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 120/2016 për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit; Në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të kësaj infrastrukture dhe për të rritur nivelin e sistemit ekzistues është parë mundësia e përmirësimit të sistemit aktual dhe veçanërisht në penetrimin me informacion deri në njësinë fundore të rrjetit, kryerjen e analizave ad-hoc, gjenerimin e raporteve të rregullta etj.

Në kuadër të “Projektit të Binjakëzimit” me Rregullatorin SIloven⁹, janë shkëmbyer vizita mes palëve, me qëllim vlerësimin në praktik të sistemit ekzistues të AKEP dhe njëkohësisht marrjen propozimeve lidhur me hartimin e specifikimeve teknike për t’u bërë pjesë e dokumentit të tenderit. Gjithashtu është përgatitur Raporti teknik mbi “Upgrade” in e sistemit, duke u fokusuar në specifikimet teknike të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të tenderit për sistemin e hartës së rrjeteve broadband në Shqipëri.

Pas marrjes së raportit final nga konsulenti me specifikimet teknike të cilat do të jenë pjesë e procedurës për zbatimin e projektit “Upgrade i Sistemit të Përqendruar të Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike” u përcaktua vlera e projektit në shumën 14,000,000 lekë, e cila është pjesë e planit të investimeve të AKEP.

Projekti konsiston në:

- *Përmirësim (Upgrade) dhe mirëmbajtje e platformes Web GIS - Atlasi Elektronik i AKEP,*
- *Konsulencë teknike për shtesa në standardin e formatit të të dhënave të shkëmbyera për rrjetet e komunikimit elektronik dhe përmirësimin e bazës së të dhënave për menaxhimin optimal të shtresave hapësinore,*
- *Krijimi i një sistemi për pranimin, monitorimin dhe administrimin e të dhënave të rrjeteve të komunikimeve elektronike,*
- *Implementimi i një rregulli dhe analizë "ad hoc" në varësi të kërkesave të AKEP-it.*
- *Sigurimi i mbështetjes profesionale teknike në menaxhimin e të dhënave dhe konsulencë GIS.*

U zhvillua tenderi me objekt “Upgrade të Sistemit të Përqendruar të Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike”. Procedura u finalizua me sukses dhe ka filluar implementimi i projektit.

1.4.7 Kontrolli për sigurinë e rrjeteve

AKEP në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë dhe veçanërisht kapitullit të sigurisë së komunikimeve elektronike, gjatë vitit 2017 i kushtoi një rëndësi të vecantë sigurisë së rrjeteve dhe informacionit nga sipërmarrësit që janë pajisur me autorizim të përgjithshëm të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Në mënyrë më të detajuar, në kuadër të përcaktimeve të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, janë vlerësuar raportimet sipas 6 fushave kryesore të mëposhtme, që minimalisht duhet të kenë dhe të aplikojnë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që të vendosin masat bazë teknike dhe organizative për të

⁹ Eksperiencia e shtetit SIloven në lidhje me sistemin e pasqyrimin në hartë të infrastrukturës së broadband –it është vlerësuar si eksperiencia më e mirë në BE.

garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike:

- 1) Sigurinë fizike të ambienteve dhe asetëve të sipërmarrësve,
- 2) Sigurinë e rrjeteve, sistemeve dhe aplikacioneve mbështetëse,
- 3) Plani i trajtimit ose reagimit ndaj incidenteve të sigurisë dhe Plani i Vazhimit të Biznesit,
- 4) Politikën e Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale në ruajtje, procesim dhe transmetim,
- 5) Politikën e aksesit të kontrollit, rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve që merren me çështjet e sigurisë,
- 6) Regjistër ose regjistra të shkeljeve ose incidenteve të sigurisë ku të specifikohet shkelja, kategorizimi i saj, shkaku, pasoja, masat e ndërmarra etj.

AKEP ka vlerësuar raportimet e sipërmarrësve duke përcaktuar rast pas rasti se cilat pika janë plotësuar në raport dhe cilat pika nuk janë adresuar, gjithnjë duke pasur në konsideratë origjinalitetin e këtyre raportimeve, pra faktin që raporti të përshkruajë realisht sistemet, pajisjet, masat dhe zgjidhjet që ata kanë të instaluar dhe në përdorim në rrjetet e tyre dhe të mos përmbaj të dhëna të rreme apo të kopjuara.

Pas vlerësimit të raportimeve në bazë të 6 kriterëve të përcaktuara në pikën e mësipërme, është kryer një kategorizim i sipërmarrësve të komunikimeve elektronike sipas shkallës së mospërmbushjes së detyrimeve mbi masat teknike dhe organizative mbi sigurinë e rrjetit dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

AKEP ka kryer inspektime për të verifikuar nëse masat teknike dhe organizative të sigurisë të implementuara prej sipërmarrësve të komunikimeve elektronike janë reale, të plota dhe në përputhje me ato masa teknike dhe organizative të raportuara nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike. Sipas rezultatit të kontrollit ka vendosur masa administrative për sipërmarrësit për shkak të mosrespektimit të detyrimit të dorëzimit të raportit mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, të përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 9 të Rregullores Nr.37, datë 27.10.2015.

Në total, gjatë vitit 2017, janë kryer gjithsej 85 inspektime ku ndaj 27 sipërmarrësve janë vendosur masa administrative dhe në 50 sipërmarrës janë dhënë rekomandime në lidhje me:

- Vendosjen e regjistrit të shkeljeve ose incidenteve të sigurisë ku të specifikohet shkelja, kategorizimi i saj, shkaku, pasoja, masat e ndërmarra etj., sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 6 të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi Masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” në AKEP;

- Vendosijen e Planit të Trajtimit ose reagimit ndaj incidenteve të sigurisë dhe Plani i Vazhimit të Biznesit në rastet e situatave të jashtëzakonshme apo katastrofave sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 6 të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi Masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” në AKEP.

Në fund të vitit 2017, në konkluzion nga evidentimi i **164** sipërmarrësve, **147** sipërmarrës kishin përmbushur detyrimet ligjore dhe ato rregullatore përkatëse dhe **17** sipërmarrës nuk përmbushin detyrimet ligjore dhe ato rregullatore përkatëse.

2 TREGU I SHËRBIMEVE POSTARE

2.1 ECURIA E VOLUMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE

Në sektorin e shërbimeve postare ushtrojnë aktivitet Posta Shqiptare si dhe 11 operatorë të tjerë të pajisur nga AKEP me “Çertifikatë të Konfirmimit të Njoftimit” për ofrimin e shërbimeve postare, disa prej të cilëve janë filiale të kompanive të mëdha postare ndërkombëtare si DHL, TNT et.

Volumi i objekteve postare

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2017 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 25 milionë. Numri i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare gjatë vitit 2017 është rritur me rreth 7 % ndërsa numri i përgjithshëm i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ka pësuar një rritje me 2% krahasuar me vitin 2016. Posta Shqiptare sh.a vazhdon të ruajë pozicionin e saj dominues në tregun e shërbimeve postare, duke zënë rreth 94 % të tregut të shërbimit postar kundrejt 6 % që zënë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

FIGURA 2. 1- ECURIA E OBJEKTEVE POSTARE 2012-2016




Tabela e mëposhtme paraqet numrin e objekteve postare, sipas kategorive kryesore, të pranuar nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare gjatë vitit 2017.

TABELA 2.1. TË DHËNA MBI KATEGORITE KRYESORE TË OBJEKTEVE POSTARE (2015-2016)

Shërbime postare të ofruara	Objekte postare 2016	Objekte postare 2017	Ndryshim 2016/2017	
Posta Shqiptare				
1	Shërbim Universal Postar			
1.1	<i>Postë brenda vendit</i>	18,416,556	18,599,662	1.0%
1.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	1,221,931	1,322,758	8.3%
1.3	Totali 1.1+1.2	19,638,487	19,922,420	1.4%
2	Shërbim joniversal postar			
2.1	<i>Postë brenda vendit</i>	2,479,064	2,603,017	5.0%
2.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	6,534	9,702	48.5%
2.3	Totali 2.1+2.2	2,485,598	2,612,719	5.1%
3	Shërbim ekspres			
3.1	<i>Ekspres brenda vendit</i>	679,095	724,794	6.7%
3.2	<i>Ekspres ndërkombëtar</i>	23,221	25,764	11.0%
3.3	Totali 3.1+3.2	702,316	750,558	6.9%
Ofruesit e shërbimeve postare				
4	Shërbim JoUniversal Postar			
4.1	<i>Postë brenda vendit</i>	167,275	277,504	65.9%
4.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	11,408	34,632	203.6%
4.3	Totali 4.1+4.2	178,683	312,136	74.7%
5	Shërbim ekspres			
5.1	<i>Ekspres brenda vendit</i>	1,216,225	1,050,783	-13.6%
5.2	<i>Ekspres ndërkombëtar</i>	182,996	206,705	13.0%
5.3	Totali 5.1+5.2	1,399,221	1,257,488	-10.1%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	24,404,305	24,855,321	1.8%

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2017, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:

- Objekte postare gjithsej **24,855,321** në raport me popullsinë (banorë rezidentë) 2.870.324 janë: **8.66 objekte / banorë**.
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me popullsinë 2.870.324 janë: **3,189 banorë / zyrë**.
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me sipërfaqen 28,748 Km² janë: **31.94 Km² / zyrë**.

Tregues të rrjetit postar

Posta Shqiptare e cila ofron shërbim në të gjithë vendin në **568** zyra të hapura për publikun ka treguesit më të mirë të rrjetit, e ndjekur nga Albanian Courier, United Transport, Albanian Delivery Express, DHL International Albania, etj. Në përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Postës Shqiptare, është në qytetet kryesore të vendit.

Përsa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim 399 mjete transporti, Albania Courier 42, Rad Mail 28, Albanian Delivery Express 25, FEDEX 25, TNT Express Albania 13, DHL International Albania 12, të pasuar nga Ofruesit e tjerë. Në mjetet e transportit përfshihen kamiona, furgona, vetura, motocikleta dhe bicikleta.

TABELA 2.2. NUMRI I ZYRAVE POSTARE TË HAPURA PËR PUBLIKUN (2016-2017)

Ofrues të shërbimeve postare	2016	2017
Posta Shqiptare	559	568
Ofruesit e tjerë	324	332
Totali	883	900


TABELA 2.3. TREGUES TË RRJETIT TEKNIK SIPAS VITEVE 2012-2017

	Zyra postare të hapura për publikun	Zyra postare jo të hapura për publikun (qendra përpunimi)
Viti 2012	839	21
Viti 2013	1278	34
Viti 2014	928	23
Viti 2015	995	28
Viti 2016	892	47
Viti 2017	901	47

Të punësuarit

Sektori postar karakterizohet nga përdorimi intensiv i forcës së punës dhe në shumë vende të BE, operatori postar publik është një ndër punëdhënësit më të mëdhenj të ekonomisë. Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga Posta Shqiptare sh.a dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, për vitin 2017 në sektorin postar ishin të punësuar 2,810 punonjës, duke shënuar një rritje me rreth 8% krahasuar me vitin 2016. Më poshtë jepet ecuria e numrit të të punësuarve në sektorin e shërbimit postar për vitet 2012-2017.

FIGURA 2.2. ECURIA E NUMRIT TË TË PUNËSUARVE 2012-2017




Posta Shqiptare ka 2,463 të punësuar, apo 88% të punësuarve në sektorin postar. Operatorët e tjerë postarë kanë një numër shumë më të vogël të punësuarish dhe operatori me numrin më të madh të të punësuarve në vitin 2017 është Ulysses Enterprises (FEDEX) me 61 punonjës.

2.2 TË ARDHURAT DHE INVESTIMET NË TREGUN POSTAR

Të ardhurat


Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2017 nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2,3 miliard Lekë. Të ardhurat nga shërbimet postare për vitin 2017 janë rritur me 10% në krahasim me vitin 2016. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,3 miliard lekë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total rreth 1 miliard lekë. Pjesa tregut në të ardhura e Posta Shqiptare në vitin 2017 ishte rreth 58% që është dukshëm më ulët se pjesa e tregut në volumin e objekteve postare prej 94%. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2017.

FIGURA 2.3 PJESË TREGU NË TË ARDHURA



Posta Shqiptare zotëron 58 % të tregut, e pasuar nga DHL Albania me 22 % të tregut dhe më pas nga TNT Express Albania me 7.9 %, Ulysses Enterprises 6 %, Albanian Courier me 4 %, ADEX me 3 % dhe United Transport me 2.8%


FIGURA 2.4 POSTA SHQIPTARE – SHËPRNDARJA E TË ARDHURAVE SIPAS SHËRBIMEVE



Investimet

Figura e mëposhtme parqet e curinë e të ardhurave dhe investimeve në sektroin postar në vitet 2012-2017. Në vitin 2017 totali investimeve në sektorin postar ishte 251 milionë lekë, me një rritje prej 10%, që është e njëjtë me normën e rritjes së të ardhurave në krahasim me vitin 2016. Nga të dhënat vihet re se të ardhurat dhe investimet janë në rritje prej vitit 2014.

FIGURA 2.5 - ECURIA E TË ARDHURAVE DHE INVESTIMEVE



2.3 INSPEKTIMI DHE MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE POSTARE

Në mbështetje të nenit 9, nenit 60 e vijues të Ligjit 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores Nr.45, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të

veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare”, AKEP ka ndërmarrë masat administrative përkatëse për mbikqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare. *Plani Vjetor i Inspektimit të Ofruesve të Shërbimeve Postare për vitin 2017* është hartuar në përputhje të plotë me Planin Strategjik të Inspektimit miratuar nga Këshilli Drejtues i AKEP dhe përcakton më në detaje veprimtarinë e inspektimit që do të ndërmerret gjatë vitit ushtrimor nga AKEP.

Në referim me planin vjetor të inspektimeve, gjatë vitit 2017 AKEP ushtroi veprimtarinë inspektuese pranë ofruesit të shërbimit universal postar Posta Shqiptare, dhe 10 subjekteve ofrues të shërbimeve alternative postare:

Në zbatim të Autorizimit të Inspektimit Nr.1920, datë 11.10.2017, grupi i inspektimit të AKEP, ushtroi inspektimin pranë subjektit ofrues të shërbimit universal postar Posta Shqiptare Sh.a, dhe në përfundim të inspektimit për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, me qëllim marrjen e masave brënda afateve kohore të parashikuara në ligj nga ofruesi i shërbimit universal, ka vendosur detyrat përkatëse për zbatim:

- Marrjen e masave organizative dhe teknike për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare (pako/kolipostë) në adresën e marrësit, në përputhje me nenin 40 të Ligjit 46/2015.
- Hartimi dhe publikimi një dokumenti në të cilin duhet të paraqitet informacioni i detajuar dhe përgjithësuar mbi kushtet e përgjithshme të aksesit sipas kërkesave të nenit 14 të Ligjit 46/2015 dhe Rregullores Nr. 36 datë 29.10.2015 “Për ofrimin e Shërbimit Universal Postar”.
- Plotësimin e kërkesave e nenit 31 të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores Nr. 41 date 3.03.2016 “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”.

Veprimtaria inspektuese pranë ofruesve të shërbimeve postare jouniversal për vitin 2017, është fokusuar kryesisht mbi kontrollin dhe mbikqyrjen e objektivave dhe kërkesave të përcaktuara në ligjin 46/2015 dhe akteve rregullatore përkatëse. Subjekteve ofrues të shërbimeve alternative postare të kontrolluara, ju caktuan detyra mbi evidentimin dhe vlerësimin efektiv të treguesve të cilësisë së shërbimit/standartet e shërbimit postar ekspres për postë brenda vendit dhe postë me jashtë vendit, miratimin e rregulloreve mbi organizimin e punës mbi transportin dhe dorëzimin e objekteve postare në të gjithë territorin e vendit apo pranimin në qytetet e deklaruar nëpërmjet zyrave postare, agjenteve postar apo bashkëpunim me subjektet e tjerë ofrues të shërbimeve postare etj.

3 MBROJTJA E KONSUMATORIT

3.1 TRANSPARENCA DHE LEHTËSIA E KRAHASIMIT TË TARIFAVE

Me qëllim mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve Kuvendi rekomandon:

- *Të marrë masat e nevojshme për të bërë të mundur publikimin në faqen ëeb të AKEP-it të informacionit krahasues të tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të pasurimit të faqes me informacione, të cilat i vijnë në ndihmë si përdoruesve, ashtu edhe operatorëve të komunikimeve elektronike dhe postare.*

Tendenca e konsumit drejt paketave bundle me shërbime të integruara thirrje telefonike kombëtare, SMS dhe akses në Internet e shoqëruar me ndryshimet e për tarifrat e thirrjeve on-net/off-net ka çuar në krahasim më të lehtë të paketave të një operatori dhe ato midis operatorëve të ndryshëm dhe kontroll më të lehtë të shpenzimeve nga përdoruesit celularë. Tendenca e operatoreve celularë në ofrimin e paketave për përdoruesit me parapagim është ofrimi i tyre në bazë konsumi 1 ditor, javor dhe mujor (30 ditorë) ose 4 javor/28 ditorë, duke përfshirë në shumicën e tyre përveç thirrjeve telefonike dhe SMS edhe akses në Internet. Këto paketa krijojnë mundësinë e zgjedhjes për përdoruesit me parapagim dhe janë lehtësisht të krahasueshme në bazë të çmimit, njësisive të konsumit të përfshira në paketa dhe kohëzgjatjes së tyre.

Gjatë vitit 2017 AKEP ka ndërmarë masa për publikimin dhe informimin e konsumatorëve në lidhje me krahasimin e paketave të shërbimeve celularë dhe fikse të operatorëve nëpërmjet publikimit në një seksion të faqes së internetit të AKEP (<https://www.akep.al/perdoruesi/roli-akep-ne-mbrojtje-te-perdoruesit>). Qëllimi i kësaj nisme është publikimi i informacionit për konsumatorët, për të pasur mundësi krahasimi të tarifave të sipërmarresve të shërbimit nga rrjetet celularë. Dokumenti përmban tarifrat/planet kryesore të shërbimit të telefonise celularë në datën referencë të vendosur në fillim të dokumentit. Duke qënë se tregu është aktiv dhe në këtë dokument informacioni është i përmbledhur, konsumatorëve iu këshillohet të drejtohen në faqet e internetit, pikave të shitjes ose kujdesit të klientit përpara se të bëjnë zgjedhjen e tyre. Dokumenti përditësohet afërsisht cdo tre muaj.

3.2 AFATI I PËRDORIMIT TË OFERTAVE MUJORE (30 DITORE) v 28 DITORE

Megjithë ndryshimet pozitive të cituara më sipër në këtë dokument, në tregun celular janë vërejtur disa praktika që kanë dëmtuar interesin e konsumatorit. Ndër këto ndryshime janë dhe ndryshimet e aplikuara nga Albtelecom, Telekëom Albania dhe Vodafone Albania në

Mars 2016 të afatit të përdorimit të ofertave mujore nga 30 ditë në 28 ditë, të cilët kanë vazhduar të aplikohen për të njëtin afat 28 ditor edhe gjatë vitit 2017.

Duke marrë shkas, nga shfaqja e vazhdueshme dhe në rritje e shqetësimit të grupeve të interesit si dhe deputetëve të Kuvendit lidhur me aplikimin nga operatorët celularë të kohëzgjatjes 28 ditore të vlefshmërisë së paketave tarifore celulare, si dhe nga qëndrimi i Autoritetit të Konkurrencës në Vendimin nr. 475, datë 21.09.2017 për “Mbylljen e Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare dhe Dhënien e Disa Rekomandimeve” për këtë çështje me qëllim, mbrojtjen e interesit publik, AKEP me Urdhërin nr.64, datë 26.03.2018, ngriti një grup pune për fillimin kryesisht të procedurës administrative për Për vlerësimin e ndryshimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 30 në 28 ditë.

AKEP po bashkëpunon dhe me AK dhe me Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit, pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe qëndrimi zyrtar i AKEP për këtë çështje është që operatorët duhet të rikthejnë kohëzgjatjen mujore (30 ditore) të vlefshmërisë së paketave tarifore celulare standard *bundle* me parapagim 28 ditore.

3.3 NDRYSHIMET NË RREGULLOREN E PORTABILITETIT

KD i AKEP bazuar në problematikat për portabilitetin e numrave në rrjetet celulare, të evidentuara nga ankesat e konsumatorëve, nga mediat si dhe nga sistemi i bazës së të dhënave, në mbledhjen e datës 21.12.2017, me Vendimin Nr.26 vendosi nxjerrjen në këshillim publik të disa ndryshimeve në Rregulloren Nr.43 për portabilitetin e numrave.

Ndryshimet e propozuara nga AKEP synojnë lehtësimin dhe optimizimin e procesit të portimit të numrave për konsumatorët. Ndër ndryshimet kryesore të propozuara nga AKEP janë:

- Përdorimi i Numrit Personal të Identifikimit si kriteri kryesor i identifikimit të pajtimtarit për procesin e portimit. Numri Personal është numër unik që gjendet në të gjitha dokumentet e identifikimit të shtetasve Shqiptarë si Karta e Identitetit, Pasaporta apo dhe certifika e lindjes dhe nuk ndryshon gjatë gjithë jetës. Përdorimi i këtij numri pritet të sjellë lehtësira në procesin e identifikimit dhe të shmangë problemet kur pajtimtari është regjistruar me mjet tjetër identifikimi tek operatori dhënës dhe me një mjet të ri identifikimi tek operatori marrës, pasi numri personal nuk ndryshon pavarësisht ndryshimit të mjetit të identifikimit. Numri Personal ka përdorim të gjerë edhe në vende të tjera si dhe nga Qeveria e RSH për shërbimet ICT dhe e-government.
- Heqja si kriter refuzimi i kërkesës për portim i mospërputhjes së emrit/mbiemrit të pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit dhënës me atë në kërkesën për portim tek operatori marrës, duke përdorur vetëm Numrin Unik Personal si identifikim të përdoruesit. Mospërputhja e emrit/mbiemrit të pajtimtarit është arsyeja kryesore e përdorur për refuzim të kërkesës për portim. Propozimi i AKEP është që kërkesa të mos refuzohet në rast përputhshmërie të Numrit Personal. Në rast të problemeve me

numrin personal, pajtimtarët do kenë mundësi të kryejnë saktësimin tek operatori dhënës shumë shpejt nëpërmjet kartës së identitetit ose pasaportës dhe operatori dhënës duhet që brenda 1 ore nga saktësimi të pranojë kërkesën për portim.

- Vendosja e afateve të qarta për operatorin dhënës dhe marrës për procesin e portimit, përfshirë kryerjen e portimit brenda 24 orëve/1 dite pune nga kërkesa e pajtimtarit.
- Formulari i kërkesës për portim propozohet të ketë të shënuar dhe orën e kërkesës për portim, e cila do të jetë koha mbi të cilën do të llogariten të gjitha afatet procesit të portimit për operatorin marrës dhe dhënës. Pajtimtari propozohet të pajiset me një kopje të formularit të plotësuar që do të shërbejë si provë në rast ankesash për vonesa apo refuzim për portim nga operatorët.
- Zgjatja e orarit të pranimit të kërkesave për portim si dhe të kapacitetit ditor të pranimit dhe përgjigjeve të kërkesave për portim nga operatorët celularë.

Periudha e këshillimit publik ishte 26.12.2017-26.01.2018, dhe AKEP pas disa takimeve me operatorët celularë më datë 16.03.2018 miratoi versionin final të ndryshimeve të Rregullores së Portabilitetit. Ndryshimet e miratuara hyjnë në fuqi më datë 1.07.2018.

3.4 ANKESAT E PËRDORUESVE

Ankesat e përdoruesve për komunikimet elektronike

Rastet e ankesave të paraqitura në AKEP kanë qenë nga persona fizikë dhe persona juridikë, ankesa të cilat në shumicën e rasteve janë trajtuar dhe kanë gjetur zgjidhje administrative në fazën e parë të zhvillimit të tyre, me qëllim ekonomizimin e kohës dhe kostos për pajtimtarët dhe vetëm një numër i kufizuar i tyre janë trajtuar dhe zgjidhur si mosmarrëveshje ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve. Në mënyrë të përmbledhur, problematika kryesore për ankesat e trajtuara konsiston të jetë e lidhur kryesisht me:

- Zbatimin e kushteve të kontratës me pajtimtarin në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale;
- Faturimin e shërbimeve të ofruara;
- Tarifimin dhe transparencën e informacionit të ofruar;
- Cilësinë e shërbimeve të kontraktuara;
- Shërbimin e portabilitetit të numrit në nivelin pajtimtar-sipërmarrës;
- Kompensimin për pezullimin dhe/ose ndërprerjen e shërbimit;
- Shërbimet Roaming, tarifimin dhe transparencën e ofruar;

të cilat pasi janë shqyrtuar administrativisht nëpërmjet korrespondencës shkresore të nevojshme në trajtimin e këtyre praktikave si dhe duke përdorur edhe komunikimin elektronik në adresat zyrtare të AKEP. Zgjidhja administrative është ofruar nga AKEP, pavarësisht stadiit dhe llojshmërisë së ankesës, llojit të mosmarrëveshjes ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve, për të cilat është ofruar zgjidhje duke konsumuar të gjitha

fazat e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, nga seanca e pajtimit deri në nxjerrjen e rekomandimeve dhe përgjigjeve përkatëse me shkrim.

Një statistikë e përmbledhur për numrin e ankesave të trajtuar dhe zgjidhur administrativisht për vitin 2017, si ne vijim:

- Reth 90 ankesa të nivelit pajtimtarë_sipërmarrës.
- 3 praktika të cilat janë konsideruar si mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrësve dhe trajtimi i tyre është bërë në nivel KZM, të cilat kanë gjetur zgjidhje nëpërmjet seancave të pajtimit pa kaluar në nivel rekomandimi për palët.
- Praktikant e trajtuara nëpërmjet komunikimit elektronik nepermjet adresave zyrtare te AKEP dhe që përbëjnë një numër të konsiderueshem nuk janë të përfshira në statistikën e referuar.

Ankesat e përdoruesve të shërbimit postar (Reklamacionet)

“Posta Shqiptare” ka pranuar gjatë vitit 2017, 1146 ankesa, ndër të cilat ka zgjidhur 736 me një shumë kompensimi rreth 826 mijë lekë.

Gjatë vitit 2017 pranë subjekteve ofrues të shërbimeve postare janë depozituar 26 reklamacione të cilat kanë gjetur zgjidhje të gjitha nga ofruesit e shërbimeve postare, me një shumë kompensimi komplekse rreth 278 mijë lekë.

4 RAPORTI PËR STATUSIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL

4.1 STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

AKEP në vijim të Planit të Veprimit 2013-2016 për Shërbimin Universal në fushën e komunikimeve elektronike në periudhën Tetor-Nëntor 2016 kreu procesin e këshillimit publik për dokumentin “Statusi i Shërbimit Universal të Komunikimeve Elektronike-këshillim publik”. Qëllimi i këtij dokumenti ishte kryerja e procesit të rishikimit të statusit të SHU, duke evidentuar zhvillimet kryesore në këto vite në tregun e komunikimeve elektronike që kanë lidhje me SHU, si dhe trajtimi i nje sërë çështjeve të lidhura me zhvillimin e regjimit të shërbimit universal në Shqipëri.

Pas këshillimit publik, AKEP me Vendimin nr.12, datë 19.04.2017, miratoi dokumentin “Statusi i Shërbimit Universal të komunikimeve elektronike-2017”. Dokumenti është publikuar në faqen zyrtare të internetit të AKEP dhe përfundimet kryesore të këtij dokumnti të AKEP janë dhënë më poshtë.

4.1.1 Propozimi i KE për rishikimin e kuadrit rregullator

KE më datë 14.09.2016, publikoi propozimet për rishikimin e kuadrit aktual rregullator të komunikimeve elektronike. Ndër elementët kryesorë të propozimeve të KE, janë:

- Përcaktimin e objektivave jo-detyruese për Shoqërinë Gigabit (Gigabit Society) për vitin 2025 (të gjitha familjet të kenë akses broadband me shpejtësi 100 Mbps, që mund të rritet në shpejtësi me Gigabps);
- Plan veprimi për mbulimin me rrjete celulare 5G;
- Ndërmarrja e masave për stimulimin e instalimit të rrjeteve me fibra optike;
- Përcaktimin e afatit minimal prej 25 vitesh për autorizimet e reja individuale për përdorimin e radiofrekuencave;
- Përfshirjen në fushën e SHU të aksesit bazik broadband me çmime të përballueshme;
- Vendosje të taveve për tarifën e terminimit në rrjetet fikse dhe celulare;
- Zgjerimi i rolit dhe reformimi i BEREC.

Propozimet e KE për rishikimin e kuadrit rregullator do të jenë objekt i këshillimit me palët e interesuara dhe parashikohet që të miratohen nga Parlamenti dhe Këshilli Europian fundi i vitit 2017. Në lidhje me SHU, propozimet më të detajuara të KE përfshijnë ndër të tjera:

Dy elementët e detyrueshëm të SHU që duhet të jenë të disponueshme për të gjithë përdoruesit fundorë, me çmime të përballueshme nga vendndodhje fikse janë:

- Shërbimet e komunikimit zanor, d.m.th. shërbime që i ofrohen publikut për të kryer dhe marrë thirrje telefonike nëpërmjet një numri të planit të numeracionit, bazuar në teknologjitë e komutimit në qarqe ose me paketa (circuit sëitching ose packet sëitching) propozohet të vijonë të jenë pjesë e SHU.
- Akses funksional në Internet, i përkufizuar si aftësia e të gjithë përdoruesve fundorë për të patur akses në shërbimet bazë (themelore) online që përdoren nga shumica e individëve (p.sh. navigim në faqet web, akses në shërbimet e-Government etj), të dhëna në Aneks V të Direktivës:

Ndërkohë detyrimet për numeratorët, shërbimet DES dhe telefonat publikë propozohet të hiqen nga fusha e SHU si detyrime, pasi konsiderohen elementë të vjetëruar, megjithëse vendet që i kanë mund të vazhdojnë ti mbajnë këto detyrime.

Propozimi i fundit i KE nuk parashikon kufizime se si shërbimet (telefoni dhe akses broadband) mund të ofrohen tek përdoruesi fundor nga vendndodhje fikse, ato mund jenë me rrjete me tela (ëired) ose pa tela (ëireless).

Në lidhje me sigurimi i disponueshëmrisë së SHU për zona ku nuk ka shërbim/mbulim, KE propozon që vendet anëtare do të kenë të drejtë të përcaktojnë një ose disa operatorë si ofrues të SHU për të garantuar disponueshëmrinë e SHU, kur ajo nuk mund të sigurohet nëpërmjet praktikës normale tregtare ose nëpërmjet instrumentave të tjerë të politikave publike si fonde të ndihmës shtetërore ose fonde të BE. Komisioni shpjegon se fokusi duhet të jetë më shumë në përballueshmërinë e konkativitetit aktual se sa në ndërtimin e rrjeteve të reja. Për të stimuluar investimet në rrjete duhet të përdoren instrumnta të tjerë.

Bazuar në analizën e tarifave me pakicë (retail) vendet anëtare mund të vendosin që operatorët të ofrojnë plane tarifore në nivel kombëtar, të ndryshme nga ato të ofruara nga praktika normale komerciale, me qëllim plotësimin e nevojave të përdoruesve me të ardhura të ulëta ose përdoruesit me nevoja specifike (të moshuarit, përdoruesit me aftësi të kufizuara, përdoruesit që jetojnë në zona të largëta). Vendet anëtare gjithashtu mund të vendosin të zgjedhin alternativën e suportit direkt të konsumatorit (p.sh. ofrimi i kuponave).

Propozimi i KE sjell ndryshim të madh në metodën e financimit të SHU. Sipas propozimit SHU duhet të financohet vetëm nëpërmjet fondeve të buxhetit të shtetit, dhe jo më nëpërmjet fondit të SHU që krijohet vetëm nga kontributet e operatorëve/sectorit të komunikimeve elektronike.

4.1.2. Përvoja nga implementimi i SHU në vendet e BEREC

Dokumenti i BEREC, BoR (17) 41 “*BEREC update survey on the implementation and application of the universal service provisions – a synthesis of the results*” përbën një përditësim të raportit të brendshëm të BEREC të vitit 2014 dhe përmban një përmbledhje/sintezë të rezultateve të sondazhit në lidhje me zbatimin dhe aplikimin e dispozitave të shërbimit universal në 29 vende të BEREC. Dokumenti përmban informacion në lidhje me caktimin e ofruesve të SHU, vlerësimin e kostove neto, mekanizmat e kompensimit, barrës së padrejtë financiare të OSHU, impaktin në konkurrencë dhe masat për përballueshmërinë e tarifave.

Në lidhje me caktimin e ofruesit të SHU, në çdo vend është caktuar të paktën një ofrues, përveç 6 vendeve (nga 29). Mos-caktimi i OSHU nuk nënkupton domosdoshmërisht se shërbimi universal nuk ofrohet, por që SHU mund të sigurohet në mënyre komerciale nga tregu. Mekanizmat e caktimit të SHU kanë ndryshim të madh midis vendeve.

Në lidhje me aksesin broadband vetëm 7 vende kanë deklaruar se kanë përfshirë atë si pjesë të SHU (Spanja, Finlanda, Kroacia, Letonia, Suedia, Malta dhe Çekia):

- Letoni: aksesit broadband si pjesë e SHU është vetëm për përdoruesit me aftësi të kufizuar.
- Kroaci: OSHU ka detyrimin të ofrojë akses broadband me shpejtësi minimale 1 Mbps nga 1 Janari 2015, dhe aktualisht janë 12000 përdorues të këtij shërbimi (pjesë e SHU).
- Spanjë dhe Suedi: shpejtësia minimale për SHU është 1 Mbps. Në Çeki dhe Finlandë është 2 Mbps, ndërsa në Maltë 4 Mbps
- Austria nuk ka përcaktuar shpejtësi minimale.
- UK është duke vlerësuar përfshjen e aksesit broadband në SHU, por nuk ka vendosur ende në lidhje me specifikimet teknike.

Ndërkohë në lidhje me masat e ndërmarra për promovimin e aksesit broadband jashtë fushës së SHU, shumica e vendeve referojnë se kanë parashikuar në Strategjitë Broadband masa për zhvillimin e infrastrukturës broadband dhe kryesisht me ndihmë shtetërore dhe/ose fonde të BE ndërsa disa vende kanë parashikuar për bashkëfinancim për akses/rrjete broadband në zona të caktuara. Disa vende përfshijnë detyrime mbulimi me broadband celular në licencat/autorizimet e spektrit të frekuencave të MNO-ve.

4.1.3. Përballueshmëria e tarifave: Raportet e ITU 2015-2017

Në raportin periodik të ITU “Measuring the Information Society”, (Report Volume 2. ICT Country profiles 2017) është dhënë konkluzioni që Ekosistemi i ICT në Shqipëri ka parë një zhvillim pozitiv gjatë dekadës së kaluar. Strategjitë e inovacionit të sjella nga qeveria dhe procesi i zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE) kanë nxitur reformën e politikave, veçanërisht në sektorin e ICT (Komisioni Evropian, 2014). Aksesit dhe përdorimi i ICT është rritur për shkak të vizionit strategjik të qeverisë dhe liberalizimit të tregut të ICT. Ndërsa infrastruktura e ICT është e zhvilluar mirë në qendrat urbane, lidhja rurale mbetet një sfidë. Në disa zona, veçanërisht ato rurale, shpenzimet mund të jenë të larta dhe penetrimi i ulët. Mungesa e lidhjes rurale është "një nga boshllëqet kryesore" dhe që pengon rritjen në vend (ITU, 2016).

Raportet periodike të ITU Measuring the Information Society Report, siç është thënë dhe më parë, janë dhe një burim i mirë për krahasimin e tarifave për shërbimet e telefonisë fikse dhe celulare dhe aksesit broadband nga rrjetet fikse dhe celular dhe përballueshmërisë së tyre. Këto raporte përmbajnë të dhëna për zhvillimin e ICT, duke përdorur ndër të tjera tregues të numrit të përdoruesve të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit broadband (rrjete fikse dhe celulare) dhe përballueshmërisë së çmimeve të këtyre shërbimeve, duke bërë dhe renditje në bazë të indekseve të llogarituar nga ITU.

TABELA 4.1. RENDITJA E SHQIPËRISË PËR INDEKSIN E ÇMIMEVE TË ICT NË RAPORTET E ITU 2015-2016-2017

	Renditja 2014		Renditja 2015		Renditja 2016	
	%GNI	Renditja ITU	%GNI	Renditja ITU	%GNI	Renditja ITU
IPB	3.9	106	N/A	N/A	N/A	N/A
Telefoni Fikse	1,77	91	N/A	N/A	N/A	N/A
Broadband Fiks	1.77	58	2.57	83	2.7	N/A
Telefoni Celulare	8.03	138	1.71	84	1.8	N/A
Broadband Celular	1.26 -2.53	58-79	1.18	63-74	1.2	N/A

Burimi: Raportet e ITU 2015-2016-2017

Në raportin e ITU 2017:

- Shqipëria renditet e 89-ta në IDI për vitin 2016 dhe për vitin 2017 me një përmirësim të vlerës së saj nga 4.9 pikë për vitin 2016 në 5.14 pikë për 2017 me një diferencë prej 0,24;
- Progresi më i rëndësishëm në vend është bërë në aksesin e internetit dhe rritjen e familjeve me një kompjuter nga 4.9% në vitin 2006 në 25.7% në vitin 2015, dhe 27.7% në vitin 2016. Shkalla e penetrimit fikse broadband ka pësuar një rritje të lehtë nga 6.5% në vitin 2014 në 7.6% në vitin 2015, dhe 8.3% në vitin 2016;
- Rritja e penetrimit të mobile-broadband, nga 30.9% në vitin 2014 në 40.6% në vitin 2015, dhe 52.6% në vitin 2016, është ndikuar nga hedhja në treg e shërbimeve LTE dhe LTE-A, të mundësuar nga ndryshimet ligjore/rregullatore të AKEP për procesin e re-farming të spektrit të frekuencave për shërbimet LTE.

Duke marrë në konsideratë tarifatat aktuale të shportave të integruara (telefoni/SMS dhe Internet) në rrjetet celulare për përdoruesit me parapagim rezultojnë se me 800-1000 lekë/muaj (me TVSH) një përdorues mund të përfitojë rreth 2000 minuta kombëtare, qindra SMS dhe 1-2 GB Internet 3G/4G. Ky nivel konsumi është shumë më i lartë se konsumi i referuar nga ITU si benchmark për krahasimin midis vendeve për përballueshmërinë e tarifave. Në terma të përballueshmërisë shpenzimi 800-1000 lekë/muaj për akses në telefoni dhe Internet celular është 1.75-2.15% e GNI për frymë të Shqipërisë në 2014 (4505 USD). Për nivelin mesatar të të ardhurave, ky nivel shpenzimesh (për konsumin e cituar) vlerësohet të jetë i përballueshëm.

4.1.4 Përfundimi i AKEP për Rishikimi i objektit të SHU

Perfundim për anën e ofertes për SHU

Nga analiza e kryer në dokumentin e miratuar më 19.04.2017 në lidhje me anën e ofertes së shërbimeve, AKEP arrin në përfundimin se:

- Aksesin në shërbimet e telefonisë nga vendndodhje fikse nëpërmjet rrjeteve fikse ka ardhur në rënie, në terma të numrit të përdoruesve si dhe të përdorimit mesatar të thirrjeve telefonike. Kjo rënie nuk rezultojnë të ketë ardhur për shkak të tarifave, pasi ato konsiderohen të përballueshme, apo të zvogëlimit të zonave të mbulimit me rrjete fikse, pasi ato gjykohej të jenë rritur (rritje e qendrueshme e aksesit broadband nga rrjete fikse). Rënia rezultojnë të jetë rezultat kryesisht i efektit të zëvendësimit me akses dhe përdorim të rrjeteve celulare. Ky efekt zëvendësimi është evidentuar dhe analizuar në mënyrë me të detajuar në Analizën e tregut të telefonisë fikse në vitin 2015 nga AKEP.
- Aksesin broadband nga rrjete fikse është zhvilluar me ritme të kënaqshme dhe është shoqëruar me rritje të zonave të mbulimit, shpejtesisë së aksesit broadband dhe prezantimin e shërbimeve të reja si IPTV, e cila vlerësohet të jetë shtyftesi kryesor i rritjes së aksesit broadband në vitin 2015 dhe pritet të vijojë këtë ndikim edhe në vitet në vijim.
- Shërbimet nga rrjetet celulare kanë pasur zhvillim të qendrueshëm dhe investimet në rrjetet 3G/4G kanë rritur ndjeshëm përdorimin e aksesit në Internet nga rrjetet celulare si në terma të numrit të përdoruesve dhe në terma të përdorimit mesatar të të dhënave. Megjithatë mbulimi me rrjet GSM është në nivele shumë të mira, sic është konkluduar edhe në vitin 2012, mbulimi me sinjalin rrjeti celular 3G/4G për të mundësuar akses broadband në zona me popullsi të vogël dhe pa interes komercial ka nevojë të përmiresohet, dhe AKEP ka marrë tashmë masa në bashkëpunim me operatorët celulare për përmirësimin e mbulimit dhe cilësisë së sinjalit në zona të caktuara gjeografike, nga secili operator dhe/ose në bashkëpunim me njëri tjetrin.
- Bazuar në përvojat ndërkombëtare, rritja e mbulimit dhe cilësisë së shërbimeve të aksesit broadband (4G) celular përmiresohet ndjeshëm me përdorimin e brezit 800 MHz (sidomos në zona rurale) dhe venia në dispozicion e këtij brezi për MNO-të në Shqipëri vlerësohet se do të ketë impact shumë pozitiv për përmirësimin e këtij shërbimi.
- Tarifatat e shërbimeve telefonike dhe aksesit broadband në Internet nga rrjete fikse dhe rrjete celulare janë në nivel të përballueshëm për familjet me nivel mesatar të të ardhurave, madje ka dhe oferta/plane tarifore me tarifa shumë të ulëta që janë të arsyeshme edhe për familjet me të ardhura të ulëta.

Per sa me siper rezulton se ne anen e ofertes, operatorët celularë dhe fikse ofrojnë shumë mundësi zgjedhjeje për shumë kategori të përdoruesve: me përdorim të ulët deri në përdorim të lartë, me mënyra pagese me parapagim dhe me paspagim, me shpejtësi të ulëta dhe të larta, etj. Mbi 93% e përdoruesve të shërbimeve celularë janë në paketa tarifore me parapagim, duke krijuar mundësi të kontrollit të shpenzimeve midis të tjerave. Kjo metode pagese me parapagim aktualisht ofrohet edhe nga disa prej operatorëve kryesorë të rrjeteve fikse, që tradicionalisht ofrojnë shërbime me paspagim. Tarifat për paketa të ndryshme të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (rrjete fikse dhe sidomos celulare) me parapagim dhe me paspagim rezultojnë të jenë të arsyeshme dhe të përballueshme, dhe kjo vëhet re dhe në raportet e insitucioneve ndërkombëtare.

Një ndër çështjet më të diskutuara në këshillim publik ishte propozimi i AKEP për përfshirjen e aksesit broadband nga rrjete fikse dhe celularë dhe paketat përkatëse tarifore në objektin e SHU. AKEP bazuar në një sërë faktorësh të analizuar në miratimin e versionit final të dokumentit vendosi që megjithëse zhvillimet shumë të mirat të aksesit broadband, sidomos nga rrjetet celularë vitet e fundit, dhe nivelit të përballueshëm të tarifave me pakicë të aksesit broadband dhe telefonisë (fikse dhe celularë) të ofruara në mënyrë komerciale nga tregu pa ndërhyrjen direkte të AKEP, përfshirja e aksesit broadband në objektin e SHU aktualisht do të ishte e parakohshme (në vendet e BE aplikohet vetëm në 7 vende), dhe mënyra më mirë për promovimin dhe më pas universalizimin e këtij shërbimi janë masat e tjera të ndërmarra nga AKEP si përmirësimi i sinjalit të mbulimit dhe cilësisë së rrjeteve 3G/4G në zona të caktuara nga 3 operatorët kryesorë celularë, masa rregulluese për aksesin broadband fikse, përfshirë masa që ndërmerren nga Qeveria në anën e kërkesës për nxitjen e shtresave në nevojë për përdorimin e këtij shërbimi dhe ICT në përgjithësi.

Sic është cituar në këtë dokument si dhe në Strategjinë dhe Planin e veprimit të AKEP për vitin 2018, AKEP ka filluar dhe do të monitorojë zbatimin e detyrimeve të operatorëve celularë sipas kushteve të autorizimeve individuale me qëllim rritjen e mbulimit dhe cilësisë së mbulimit në zonat që kanë probleme me signalin/shërbimet celularë (mungesë mbulimi ose cilësi e ulëtmbulimi/sinjali). Gjithashtu, AKEP gjatë vitit 2018 do t'i kushtojë rëndësi të vecantë detyrimeve për cilësinë e shërbimeve (QoS) duke publikuar dhe të dhëna krahasuese të QoS sipas operatorëve, përfshirë për tregues të mbulimit, shpejtësisë së aksesit në Internet etj

4.2 STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR

Sipas kërkesave të Autorizimit Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, Posta Shqiptare duhet të zbatojë:

1. Detyrimin e ofrimin të shërbimit universal postar çdo përdoruesi në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, duke përfshirë shërbimet postare brenda vendit dhe ndërkombëtare.

2. Organizimin e rrjetit postar me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar sipas kërkesave të ligjit 46/2015 dhe akteve rregullatore të miratuara nga AKEP për ofrimin e shërbimit universal postar.
3. Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar;
4. Parimet për percaktimin e tarifave dhe kostove për ofrimin e shërbimit universal postar.

4.2.1 Tregues të volumit dhe cilësisë së shërbimit universal postar

Sipas të dhënave të raportuara nga Posta Shqiptare për vitin 2017, shërbimi universal postar me një numër prej 19,922,420 objektesh të pranuar zë 75% të totalit të objekteve postare, përkundëjt 15% që zë shërbimi ekspres dhe shërbimi jouniversal për objekte postare të pranuar.


Posta Shqiptare për përmbushjen e detyrimit ligjor, dhe akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP, ofron shërbimin universal postar me një rrjet postar të organizuar, në 559 zyra, me 654 sportele për ofrimin e shërbimit universal postar, nga të cilët 432 sportele janë të automatizuara/kompjuterizuara, duke mbuluar me shërbim të gjithë territorin e vendit. Për pranimin e objekteve postare ka venë në dispozicion të përdoruesve 565 kuti postare dhe për dorëzimin e objekteve postare 606 kuti postare.

TABELA 4.2. TREGUES TË NUMRIT TË OBJEKTEVE TË SHU POSTAR 2017

Shërbim universal postar 2017	19,922,420
Postë brenda vendit	18,599,662
Objekte të thjeshta	15,614,286
Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta	2,985,376
Postë ndërkombëtare	1,322,758
Objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit	418,574
Objekte të thjeshta	241,416
Objekte të regjistruara / shërbime të veçanta	177,158
Objekte të tjera postare të SHU (ndërkombëtare dalëse)	
Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri	960,343
Objekte të thjeshta	644,736
Objekte të regjistruara / shërbime të veçanta	315,607

Deri në fund të tremujorit të katërt të vitit 2017 rezultojnë objekte postare të shërbimit universal postar të pranuar, si më poshtë:

FIGURA 4.1. ECURIA E OBJEKTEVE POSTARE TË SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR TË OFRUARA 3M-1 2016 - 3M-4 2016



Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me **86%** ose 19,922,420 objekte postare, ndjekur nga shërbimi jo universal me **11 %** ose 2,612,719 objekte postare. Shërbimi ekspres zë vetëm **3 %** ose 750,558 objekte postare.

4.2.2. Tregues të rrjetit dhe shërbimit universal postar

Posta Shqiptare, me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar sipas detyrimit të nenit 12, te Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” si dhe përcaktimet e pikës 3 të Autorizimit Individual me të cilën është pajisur Posta Shqiptare për ofrimin e shërbimit universal postar, ka të organizuar rrjetin postar në **568** zyra të hapura për publikun në të cilat ofrohet shërbim universal postar dhe shërbime jo universale/ekspres, prej të cilave **37** kryejnë funksionin dhe si qendra përpunimi.

- a) Në disa nga zyrat postare, përveç shërbimeve postare, ofrohen shërbime financiare dhe shërbime të biznesit.
- b) Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal **684** sportele nga të cilët **445** sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar.
- c) Për pranimin e objekteve postare ka vënë në dispozicion të përdoruesve **528** kuti postare dhe për dorëzimin e objekteve postare **609** kuti postare, nga të cilat të paktën një kuti postare është e vendosur në çdo zyrë postare.
Me qëllim mbulimin e të gjithë teritorit të vendit, prezenca e zyrave postare është në të gjitha bashkitë dhe në zonat rurale.
- d) Përsa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim **399** mjete transporti. Në mjetet e transportit përfshihen kamiona, furgona, vetura, motocikleta dhe bicikleta.

Në funksion të organizimit dhe shpërndarjes së rrjetit postar Posta Shqiptare për vitin 2017, ka realizuar në ofrimin e shërbimit universal postar këta tregues kryesore:

- a) *Vendodhja dhe të dhënat për çdo zyrë postare që janë paraqitur online në aplikacionin “Map – Google Earth”, në të cilin prezenca e pozicionit gjeografik të çdo zyre postare është shoqëruar me një tabelë ku është paraqitur emertimi i zyrës postare, kodi postar, shërbimeve postare që ofrohen dhe orari i punës, zona e ofrimit të shërbimit si dhe distanca nga zyra në zyrë si dhe midis zyrës postare dhe përdoruesve.*
- b) *Ne lidhje me zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Urdhërin e Ministrit Nr.6174, datë 16.12.2015, si dhe duke i'u referuar statistikave të Censurit të vitit 2011, ku numri i popullsisë të Republikës së Shqipërisë është 2.870.324 banorë për sipërfaqe 28,748 km², rezulton se Posta Shqiptare në vitin 2017 ka realizuar treguesit si më poshtë:*
 - *Shërbimi universal postar ofrohet në 568 zyra postare të hapura për publikun;*
 - *Një zyrë postare ofron shërbim universal postar për një numër mesatar të popullsisë prej 5,100 banorë.
Është plotësuar detyrimi prej 5,100 banorë i pikës 2/a të Urdhërit të Ministrit Nr.6174, datë 16.12.2015;*
 - *Mesatarisht në një sipërfaqe prej 51.79 km² është prezente një zyrë postare që ofron shërbim universal postar.
Është plotësuar detyrimi prej 53 km² i pikës 2/b të Urdhërit të Ministrit Nr.6174, datë 16.12.2015;*
 - *Në zonat urbane, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit është mesatarisht 5 km.
Është plotësuar detyrimi prej 5 km i pikës 3 të Urdhërit të Ministrit Nr.6174, datë 16.12.2015.*
 - *Në zonat rurale, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit është mesatarisht 8 km për 95% të popullsisë.
Është plotësuar detyrimi prej 8 km i pikës 4 të Urdhërit nr.6174, datë 16.12.2015.*

Shërbimet postare kryesore janë të detajuara në zëra të veçantë dhe të saktësuara me peshën dhe përmasat e objekteve postare që pranohen, në përputhje me standardet e UPU-së. Sipas nevojës së përdoruesve në disa prej zyrave postare ofrohen dhe shërbime financiare si dhe shërbime të biznesit.

Sa me sipër, konstatohet se përcaktimi i shërbimeve postare universale të ofruara dhe orari i zyrave postare ka qënë në respektim të kërkesave të nenit 12 të ligjit 46/2015.

4.2.3. Cilësia/standartet e shërbimit universal postar

Në zbatim të kërkesave të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, të Autorizimit Individual për ofrimin e shërbimit universal me të cilin është pajisur “Posta

Shqiptare”, Rregullores Nr.36, datë 29.10.2015, “Për ofrimin e shërbimit universal postar”, si dhe duke ju referuar rezultateve të inspektimit në muajt Tetor – Nëntor 2017, treguesit e cilësisë së shërbimit dhe standardet e shërbimit universal postar rezultojnë të jenë:

➤ ***Në zbatim të kërkesave të pikës 9 të nenit 12 të ligjit 46/2015:***

Rezulton se përmasat minimale dhe maksimale për objektet postare (letra dhe pako postare), sipas këtij neni, janë në përputhje me aktet e miratuara nga UPU-ja, si për postën ndërkombëtare dhe për postën brënda vëndit.

➤ ***Pika 2 e nenit 33 te ligjit 46/2015:***

Rezulton se Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare”, ka plotësuar detyrimin ku të paktën një herë në vit, të publikojnë informacion për cilësinë e shërbimit universal postar, pasi informacioni është i evidentuar në faqen zyrtare online, rubrika “Standartet e Cilësisë”, të subjektit ofrues të shërbimit universal postar “Posta Shqiptare”.

➤ ***Pika 3 e nenit 33 te ligjit 46/2015:***

Mbi cilësinë e shërbimit, e cila përfshin, në veçanti, kërkesen për kohën e shpërndarjes së objekteve postare, sistemin e informimit për ndjekjen e objekteve postare, rregullsinë dhe besueshmërinë e shërbimeve kombëtare dhe ato ndërkufitare/ndërkombëtare:

i) ***Testet mbi kohën e shpërndarjes së objekteve postare.***

Lidhur me standardet mbi kohën e shpërndarjes së objekteve postare, “Posta Shqiptare” në bazë të Programit të Punës nr.499, datë 16.02.2017 ka zhvilluar teste për postën brënda vëndit mbi standardet e kohës së shpërndarjes së objekteve postare.

- Me shkresën nr.338, datë 06.02.2017, dërguar Filialeve të Postave, janë dërguar udhëzime dhe formularët e evidencave mujore për treguesit e cilësisë së shërbimit universal postar për objektet deri në 2 kg dhe koliposte per jashte vendit deri 10 kg, për shpërndarjen brënda qytetit, ndërmjet qyteteve, ndërmjet fshatrave dhe ndërmjet qyteteve dhe fshatrave;
- Me shkresën nr.1335, datë 09.05.2017, dërguar Filialeve të Postave, janë dërguar udhëzime mbi organizimin e testit të postës brënda vëndit për matjen e cilësisë së shërbimit postar për objektet letër rekomande, ndërmjet qyteteve të filialeve dhe degëve të Postës Shqiptare;
Udhezimet janë dërguar dhe për kategori të tjera të shërbimeve universale.
- Me shkresën nr.2029, datë 11.07.2017, u janë dërguar filialeve postare rezultatet e testit të cilësisë së shërbimit të brëndshem postar për objektet letër rekomande ndërmjet panelisteve në qytete dhe masat për përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
- Në përgjigje të shkresave të sipërcituara, filialet e postës kanë dërguar rezultatet e testeve të kryera për objektet postare të kërkuara për të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Posta Shqiptare ka bërë vlerësimet përkatëse;

Rezultatet e testit ndërmjet qyteteve për objektet letër e thjeshtë, për periudhen 13 deri 18 Mars 2017 krahasuar me vitin 2016 janë si më poshtë:

	Standardi	Fakti 2016	Fakti 2017
D + 1	85.0 %	98.09 %	97.3 %
D + 2	15.0 %	1.86 %	1.6 %
Mbi D + 2	–	0.05 %	1.1 %

➤ *Rezultatet e testeve janë brënda standardit të vendosur nga AKEP.*

Rezultatet e testit ndërmjet qyteteve për objektet letër rekomande, për periudhen 15 deri 20 Maj 2017 krahasuar me vitin 2016 janë si më poshtë:

	Standardi	Fakti 2016	Fakti 2017
D + 1	85.0 %	98.7 %	98.9 %
D + 2	15.0 %	1.3 %	1.1 %
Mbi D + 2	–	0.0 %	0.0 %

➤ *Rezultatet e testeve janë brënda standardit të vendosur nga AKEP.*

ii) Realizimi i treguesve të cilësisë së shërbimit postar për periudhen 8 mujore të vitit 2017:

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës mbi përpunimin mujor të evidencave statistikore të treguesve të cilësisë së Filialeve realizimi i treguesve të cilësisë së shërbimit postar sipas standarteve të shërbimit, në forme tabelare paraqitet si më poshtë:

Standarti i shërbimit ndërmjet qyteteve në D+1 %	Realizimi i standartit të shërbimit në D+1 %
85.0	94.5
Standarti i shërbimit brenda qytetit ne D+1 %	Realizimi i standartit të shërbimit ne D+1 %
95.0	95.5
Standarti i shërbimit ndërmjet fshatrave ne D +2 %	Realizimi i standartit të shërbimit ne D+2 %
60.0	78.4

iii) Standardet e kohës së shpërndarjes për postën ndërkombëtare.

Standardet e kohës së shpërndarjes për postën ndërkombëtare ndërmjet Postës Shqiptare dhe shteteve të BE dhe shteteve që nuk janë anëtare të BE realizohet nëpërmjet testeve të zhvilluara nga kompanite postare nën monitorimin e UPU-së si dhe standardeve të Post Europës.

Rezultatet e këtyre testeve shërbejnë si referencë për matjen e standarteve për kohën e shpërndarjes së postës ndërkombëtare.

Posta Shqiptare gjatë vitit 2017 ka marrë pjesë në sistemin GMS (Global Monitoring System) të monitoruar nga Unioni Postar Ndërkombëtar për matjen e cilësisë së shërbimit me objekt letrën e thjeshtë. Posta Shqiptare ka kërkuar të shkëmbejë teste me operatorë postare ndërkombëtar të tjerë, por vetëm operatori postar Kroat ka pranuar bashkëpunimin me Postën Shqiptare. Rezultatet e testeve me operatorin postar të Kroacisë, janë brënda standartit të vendosur nga AKEP për shërbimin universal postar ndërkombëtar.

Dorëzimi i objekteve postare.

➤ **Në pikën 1 të nenit 40 të Ligjit 46/2015 është përcaktuar se:**

Shpërndarja dhe dorëzimi i objekteve postare duhet kryer në njërin nga këto adresa të marrësit:

- a. në banesën e tij;
- b. në ambientet e punës ose të biznesit;
- c. në kutinë postare, të vendosur në ambientet përkatëse.

Nga kontrolli i ushtruar në Zyrën Postare nr. 5/1, Tiranë, mbi dorëzimin e objekteve postare (pako/koli) konstatohet se:

- a) Për objektet postare kolipostë/pako, për shkak të pamundësisë tekniko/ logjistike, dhe të problemeve lidhur me sistemin e adresave, subjekti ofrues i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare”, nuk i dorëzon objektet postare kolipostë në adresë të marrësit, por dorëzohen në zyrat postare përkatëse.
- b) Paketat e vogla postare për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin ekspres ndërkombëtar apo brënda vëndit dorëzohen në adresën e marrësit;
- c) Paketat e vogla postare për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin universal postar apo jo universal dorëzohen pjesërisht në adresën e marrësit, dhe pjesërisht dorëzohen pranë zyrave postare përkatëse.

Në referim të pikës a) dhe c), për objektet postare të cilat nuk dorëzohen në adresë por pranë zyrave postare përkatëse, subjekti ofrues i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare”, kryen njoftimin për tërheqjen e objektit postar nëpërmjet dëftesës së shkruar mbi mbërritjen e objektit postar, dhe nëpërmjet njoftimit telefonik (sms).

Pas njoftimit mbi tërheqjen e objektit postar, marresi paraqitet në zyrën postare për tërheqjen e objektit postar. Në këtë rast marrësi detyrohet të paguajë sipas tarifave të miratuara e cila sipas objektit postar rezulton të jetë:

- Për paketat e vogla 30 lekë;
- Për kolipostat 50 lekë.

iv) ***Cilësia e shërbimit / standardet e shërbimit universal postar dhe shërbimit postar ekspres në Filialin Shkoder, Vlorë dhe Korçe.***

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Filiali Shkoder, Vlorë dhe Korçë lidhur me verifikimin e plotësimit të standarteve dhe cilësisë së shërbimit sipas pikes 2 te objektit të inspektimit të përcaktuar në Autorizimin e Inspektimit Nr.1920, datë 11.10.2017, grupi i inspektimit konstatoi si më poshtë:

Nga verifikimi ne vend i dokumentacionit përkatës mbi përpunimin mujor të evidencave statistikore per periudhen 9 mujore të vitit 2017 të treguesve të cilësisë së Filialit Shkoder, Vlorë dhe Korçë, rezulton se realizimi i treguesve të cilësisë së shërbimit postar është sipas standarteve për ofrimin e shërbimit universal postar, me konstatimet e mëposhtme, fakt i cili konstatohet dhe në të dhënat e regjistruara në database-in përkatës on-line për pranimin, regjistrimin dhe dorëzimin e objekteve postare.

Në analizë të procedurave për verifikimin e respektimit të standarteve dhe cilësisë së shërbimit, rezulton se Filiali Shkodër, Vlorë dhe Korçë është subjekt i verifikimit periodik sipas sistemit të testimit të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Postës Shqiptare Sh.a. në të cilin është evidentuar plotësimi i standarteve nga Ligji 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” dhe nga Rregullorja nr.36, datë 29.10.2010 “Për ofrimin e Shërbimit Universal Postar”.

Nga kontrolli i ushtruar në Filialin Shkodër, Vlorë dhe Korçë, mbi dorëzimin e objekteve postare (pako/koli) deklarohet se:

- Për objektet postare pako postare me peshë mbi 2 Kg, për shkak të pamundësisë tekniko/logjistike, dhe të problemeve lidhur me sistemin e adresave, subjekti ofruer i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare”, Filiali Shkodër, Vlorë dhe Korçë nuk dorëzon një pjesë të tyre në adresë të marrësit, por dorëzohen në zyrat postare përkatëse.
- Paketat e vogla postare për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin ekspres ndërkombetar apo brenda vëndit dorëzohen në adresën e marrësit;
- Paketat e vogla postare për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin universal postar apo jo universal dorëzohen sipas përcaktimit të dërguesit në adresën e marrësit apo pranë zyrave postare përkatëse.

5 MENAXHIMI, KONTROLLI I BRENDSHËM DHE TREGUESIT FINANCIARË TË AKEP

5.1 Menaxhimi dhe kontrolli i brendshëm

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është person juridik, publik, jo buxhetor, i krijuar me ligj të veçantë, Ligj nr. 9918, datë 19. 05. 2017 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. AKEP drejtohet nga Këshilli Drejtues i përbërë nga pesë anëtarë të propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe miratuar nga Kuvendi, i cili është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP. Kryetari i Këshillit Drejtues zgjidhet nga Kuvendi ndërmjet anëtarëve të KD dhe është drejtuesi ekzekutiv i AKEP.

AKEP ushtron veprimtarinë si organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar sipas përcaktimeve të parashikuara në Ligj nr. 9918, datë 19. 05. 2017 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligj nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Struktura dhe organika e AKEP miratohen me vendim të Kuvendit sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9584, datë 17. 7. 2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” të ndryshuar (**ligji nr. 9584**). Struktura dhe organika e AKEP që ka qenë në fuqi në vitin 2017 është miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 88/2015 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”. Organika e AKEP në fuqi në fund të vitit 2017 përbëhet në total nga 73 punonjës, në të cilën janë përfshirë edhe anëtarët dhe Kryetari i Këshillit Drejtues, Kabineti ndihmës i Kryetarit të Këshillit Drejtues, dhe sekretari i Këshillit Drejtues.

AKEP ushtron aktivitetin e tij si rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe postare sipas kompetencave ligjore të parashikuara në:

- Ligj nr. 9918, datë 19. 05. 2017 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar (Ligji nr. 9918/2008),
- Ligj nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 46/2015) dhe,

- Ligj nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” (Ligj nr. 120/2016).

AKEP gjithashtu vepron si agjent tatimor për mbledhjen e taksës së radikomunkacionet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9975 dt. 28.07.2008, "Per Taksat Kombetare ", i ndryshuar dhe Udhëzimin e perbashket te Ministrit te Financave nr. 30 date 23.12.2014, i ndryshuar me Udhëzimin nr 28. datë 12.01.2015.

Transparenca

AKEP në bazë të përcaktimeve ligjore kryen rregullisht procese këshillimi publik për dokumenta me impakt në treg. Dokumentat për këshillim publik dhe vendimet përkatëse të AKEP publikohen dhe janë të disponueshme në faqen zyrtare të Internetit AKEP. Në shumë raste AKEP zhvillon takime me palët e interesuara për qartësimin qëndrimeve dhe diskutimin e alternativave të rregullimeve të propozuara.

Me qëllim rritjen e transparencës dhe efikasitetit të punës së AKEP dhe komunikimit me palët e interesuara, AKEP me Vendimin Nr.29, datë 29. 12. 2017, miratoi dokumentin “Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2018”. Ky dokument përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike ku do fokusohet puna e AKEP gjatë vitit 2018, të cilat janë dhënë në kapitullin 6 të këtij raporti vjetor.

Dokumenti u përgatit pas seminarit “Strategjia dhe plani i veprimit të AKEP për vitin 2018”, të organizuar nga AKEP në Shkodër më datë 19-20.12.2017, me pjesëmarrjen e punonjësve të AKEP dhe përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës si dhe ekspertë të fushës. AKEP do të vijojë të publikojë në muajin Dhjetor të çdo viti planin e veprimit për vitin pas-ardhës, duke synuar edhe një përfshirje më të madhe të palëve të interesuara në këtë proces.

Kontrolli i brendshëm

Në kushtet kur AKEP nuk disponon strukturë të tijën për Auditimin e Brendshëm, me shkresë Nr. 2139 prot., datë 24.11.2017 “Kërkesë për miratimin e një Marrëveshje për Auditim Financiar” në mbështetje të germës c, të nenit 10 të ligjit nr. 114/2015, AKEP i është drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (MFE), duke kërkuar që shërbimi i Auditimit të Brendshëm në AKEP të kryhet nga struktura e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi bazën e një Marrëveshje.

Në vijim të komunikimit institucional për këtë çështje, AKEP dhe MFE ranë dakort dhe nënshkruan midis tyre Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Kryerjen e Shërbimit të Auditimit të Brendshëm (Nr. 2139/1 prot i AKEP, datë 24.11.1017) dhe (Nr. 17208 prot. i MFE, datë 6.12.2017) në AKEP.

Grupi i Auditimit të MFE me shkresë nr.17208/5 prot., datë 1.3.2018 (Nr. 2139/20Prot. i AKEP, datë 2.3.2018) ka depozituar në AKEP Raportin Përfundimtar i Auditimit. Këshilli

Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.20, datë 30.03.2018, ka miratuar Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga Grupi i Auditimit.

5.2 Raporti për realizimin e treguesve financiare vjetorë të AKEP

Të ardhurat dhe shpenzimet

Bazuar në përcaktimet e ligjit 9918/2008, fondi i shpenzimeve të AKEP miratohet nga Këshilli i Ministrave, i cili me Vendimin Nr.62 datë 3.02.2017 “Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2017, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare” miratoi fondin i shpenzimeve të AKEP në shumën 363,020,000 lekë. Tabela e mëposhtme paraqet treguesit kryesorë financiarë të AKEP për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe komisionet e përfituara si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit për vitin 2017.

TABELA -5.1. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET (NË MILIONË LEKË)

Nr	Emërtimi	Viti 2017		Diferenca Fakt-Program	% e realizimit vjetor
		Programi	Fakti		
I	Të ardhurat gjithsej:	363.02	357.58	(5.44)	98.5%
II	Shpenzime gjithsej:	363.02	295.96	(67.06)	81.5%
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	86.50	79.59	(6.91)	92.3%
2	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	11.00	10.59	(0.41)	96.3%
3	Shpenzime për materiale	7.90	5.58	(2.32)	70.6%
4	Shpenzime për shërbime	110.07	86.17	(23.90)	78.3%
5	Shpenzime për Investime	147.55	114.03	(33.52)	77.3%
III	Tarifa e shërbimit të radikomunikacionit				
1	Arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e Shtetit		518.35		
2	Të ardhurat si agjent tatimor nga arkëtimi dhe derdhja e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit Nga kjo:		25.92		
a	Për shërbime nga të ardhurat si agjent tatimor		20.97		
b	Për blerje pajisje dhe investime		4.92		

Realizimi i Pagesave

Të ardhurat totale (të ardhura nga pagesat) për vitin 2017 në terma nominale arritën rreth 357,578,668 lekë nga 363,020,000 lekë të parashikuara në fillim të vitit. Po t’i referohemi programit, mund të themi që ky zë është realizuar rreth 99%. Burim i këtyre pagesave të realizuar janë pagesat e sipërmarrësve që ofrojnë shërbime/rrjete të komunikimeve

elektronike, shërbime postare dhe regjistrim domain. Pagesat që llogariten dhe kryhen në AKEP nga sipërmarrësit bazohen në Vendimin e KM nr.599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP”, i ndryshuar; në Ligjin 9918; si dhe në aktet normative të dala në zbatim të këtij Ligji. Të ardhurat në AKEP janë përfituar nga pagesat:

- Për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare;
- Për dhënien dhe përdorimin e frekuencave;
- Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike;
- Për mbulimin e kostos së mirëmbajtjes së bazë së të dhënavë të portabilitetit
- Për regjistrim domain.al;
- Të tjera (çertifikata radio operator, certifikata miratim tipi, radioamator, interesa bankare);


Një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe ndjekjes së debitorëve, me qëllim arkëtimin e detyrimeve që kanë si ndaj AKEP-it, ashtu dhe për tarifën e shërbimit të radiokomunikacionit. Procesi i mbledhjes së detyrimeve nga sipërmarrësit debitor është ndjekur nëpërmjet:

- Dërgimit të shkresave zyrtare, kontaktimit me telefon dhe postë elektronike;
- Njoftimeve të publikuara në faqen ëeb zyrtare të AKEP;
- Inspektimit të kryer nga Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit të Spektrit;
- Ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga zyra përmbarimore.

Realizimi i shpenzimeve

Totali i shpenzimeve të AKEP për vitin 2017 në terma nominale është 295,957,465 lekë nga 363,020,000 lekë të parashikuara dhe miratuar ose e shprehur në përqindje rreth 82% e programit. Kjo diferencë midis faktit dhe programit vjen si rrjedhojë e uljes së vleres së prokuruar sipas objekteve, nga mosrealizimit i disa objekteve të shpenzimeve për investime dhe shpenzimeve administrative. Struktura e shpenzimeve sipas zërave të miruar për periudhën 2015-2017¹⁰ ka treguar trendin sic paraqitet në figurën mëposhte.

FIGURA 5.1. STRUKTURA E SHPEZIMEVE PËR PERIUdhËN 2015-2017




¹⁰ Në fondin e shpenzimeve të vitit 2016 është përfshirë edhe objekti i investimit, procedura e prokurimit të cilit nisi që në vitin 2016 dhe përfundoi në vitin 2017, i cili është në proces implementimi

Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative, ku përfshihen shpenzimet për paga e shtesa, për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për materiale dhe për shërbime, janë realizuar në shumën 181,929,185 lekë nga 215,470,000 lekë të programuara ose në rreth 85 %. Figura mëposhtë shfaq ecurinë e këtyre shpenzimeve për periudhën 2015-2017.

FIGURA 5.2. ECURIA E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE NE MILIONË LEKË PËR PERIU DHËN 2015-2017



Shpenzime për paga dhe shtesa

Shpenzimet e Personelit gjatë vitit 2017, përfaqësuan rreth 50% përqind të totalit të shpenzimeve administrative korrente ose 30% e shpenzimeve në total të AKEP për vitin 2017. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 90.2 milionë lekë, përfaqeson një realizim në nivel optimal për këtë zë në planin e vitit 2017, në masën rreth 93 përqind në krahasim me programin. Krahasuar me vitin 2016, ky zë është rreth 13% përqind më i lartë ose rreth 10.88 milionë më shumë. Gjithashtu pjesa e shpenzimeve për personelin në totalin e fondit të shpenzimeve për tre vite me radha ka variuar në intervalin rreth 24-30 përqind, duke përfshirë në rezultatin e vitit 2016 edhe shpenzimet për sistemin kombëtar të frekuncave për vitin 2016.

Shpenzimet për paga e shtesa përgjatë vitit 2017, reflekëtuan koston e administratës së AKEP, politikën e rritjes së pagave, sipas VKM nr.187, datë 087.03.2017, si dhe shpërblimin e dhënë për punonjësit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave për *Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2017, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare*. Ky zë i planifikuar për 86,500,000 lekë, u realizua rreth 79,588,082 lekë ose 92%. Mos realizimi i shpenzimeve për paga dhe shtesa në krahasim me programin ka ardhur nga mos plotësimi i numrit mesatar vjetor të punonjesve sipas programit për vitin 2017, i cili nga 73 punonjës të

miratuar në strukturë, varioi nga 63 - 69 punonjës, si dhe nga fakti që ka pasur disa punonjëse me leje lindje.

Shpenzime për sigurime shoqërore

Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore nga 11,000,000 lekë të planifikuara janë realizuar në një nivel optimal me rreth 10,592,435 lekë ose 96.3 përqind. Në mosrealizimin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ndikoi mos plotësimi i numrit mesatar vjetor të punonjësve sipas programit për vitin 2017. Po t'i referohemi një viti më parë, duke qënë se shpenzimet për paga u rriten me rreth 6%, për rrjedhojë edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan më rritje.

Shpenzime për materiale

Shpenzimet materiale për vitin 2017 janë realizuar në shumën 5,576,055 lekë nga 7.900,000 lekë të programuara ose 71%. Në totalin e shpenzimeve administrative korrente ky zë rreth 3% dhe në totalin e fondit të shpenzimeve të AKEP ky zë ka rreth 2% të peshës specifike. Për vitin 2015 dhe 2016 (duke marrë parasysh këtu edhe shpenzimet për sistemin kombëtar të frekuncave) pesha e këtij zëri në totalin e fondit të shpenzimeve ka qënë në të njëjtat nivele përqindjeje. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për kancelari, karburant, pjese këmbimi për automjete, goma/bateri, bojë printeri/fotokopje, materiale pastrimi dhe të tjera. Shpenzimet për materiale shtesë, që u parashikuan për funksionimin e zyrave të reja rajonale morën parasysh koston për një vit të plotë, por duke qënë se hapja e tyre vijoi përgjatë vitit 2017, një pjesë e shpenzimeve materiale të lidhura me to nuk u realizuar në masën e parashikuar.

Shpenzimet për shërbime

Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën 86,172,613 lekë nga 110,070,000 lekë të programuar ose rreth 78% me një kursim prej rreth 23,897,387 lekë. Në këtë rezultat kanë ndikuar disa faktore që kanë cuar në kursimin e këtij zëri sipas parashikimeve. Në diferencën midis faktit dhe programit, kanë ndikuar realizimet me normë më të ulët për shpenzimet e: *“Mirëmbajtje Pajisje Kompj. Programe dhe Internet”*; *“Udhëtim e Dieta dhe kualifikim stafi”*; *“Shpenzime të tjera”*; si dhe *“Shpenzime për mirëmbajtje dhe suport teknik për sistemin e monitorimit të spektrit të frekuencave (QKMF, RFMS, QLMSF)”*. Konkretisht,

- Gjatë 2017 nuk u realizuan pjesëmarrja në disa aktivitete të planifikuara, si rrjedhim kjo ndikoi në realizim më të ulët sesa parashikimi për shpenzimet për kualifikim dhe pjesëmarrje në evente ndërkombëtare, si dhe nuk u realizua forumi rajonal i parashikuar;
- Nuk u blenë disa licenca vjetore kompjuterike dhe aksesit në internet për zyrat e reja, të cilat filluan operimin përgjatë vitit;
- Nuk u kryen publikime në mediane huaj, sic ishte parashikuar për tendera të rendesishme të veçante për alokimin e 800Mhz e disa njoftime të tjera;
- Shpenzime për mirëmbajtjen dhe suportin teknik për sistemin e monitorimit të spektrit të frekuencave (QKMF, RFMS, QLMSF), përfaqësojnë shpenzimet e kryera vetëm

për një pjesë të vitit (në plan ishin parashikuar për një periudhë 1 vjeçare), duke qenë se procedura e prokurimit, ishte në varësi të të miratimit të fondit të shpenzimeve të AKEP në muajin shkurt nga KM, si edhe disa faktorëve të tjerë të jashëm;

- Nuk u arrit të realizohej me sukses procedura e tenderit të Shpenzime për Software support për Qendrën Kombëtare të Lëvizëshme të Monitorimit të Cilesisë (TEMS);

Zëri i shpenzime për shërbime bazë dhe kuotizacione ne organizata nderkombetare, në krahasim me programin vjetor rezultuan me realizim optimal rreth 93%. Shpenzimet për qera, vendparkim dhe mirëmbajtje dhe operim bazës së të dhënave të centralizuar të (CRDB) po ashtu kishin realizim mbi rreth 98%.

Ky zë në totalin e fondit të shpenzimeve ka zënë për vitin 2018 rreth 29%. Ne dy vitet paraardhese ka levizur ne intervalin rreth 18-29 përqind¹¹. Në qoftese si bazë krahasimi marrim vetem shpenzimet administrative korrente atehere pesha që kane zene këto shpenzime per sherbime kundrejt shpenzimeve korrente për periudhen 2015-2017 ka rezultuar në intervalin nga 41-51 përqind. Një faktor që ndikon në këtë rezultat janë edhe softwarët dhe sistemet teknike me rendësi kombëtare që disponon dhe administron AKEP.

Shpenzimet për Investimet

Shpenzimet për investime për vitin 2017 nga 147,550,000 lekë të programuara janë realizuar në shumën 114,028,280 lekë ose rreth 77% me një mos realizim/kursim në shumën 33,521,720 lekë. Zëri i shpenzimeve për investimeve për vitin 2017 zuri një peshë specifike rreth 39 përqind e fondit total të shpenzimeve të AKEP. Po ta shohim këtë tregues për vitin 2015 dhe 2016 si dhe të marrim parasysh që procedura e prokurimit për objektin *Zhvillim i sistemit kombëtar të monitorimit të spektrit të frekuencave, pajisje për stacion të thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë* për vitin 2016, që u realizuar në 2017, ky tregues ka qendruar përkatësisht në nivelet rreth 56 dhe 42 përqind. Nga të gjitha objektet e investimit që ishin planifikuar për vitin 2017, vetëm për tre objekte, procedura e prokurimit nuk u arrit të përmbylej me fitues. Ndërsa procedurat e objektevë të tjeta të investimeve përmbledhtazi paraqiten si më poshtë vijon:

1. Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave, Ndertimi i dy Stacioneve te Thjeshte Fiks Monitorimi (SRFMS) në Korce, Gjirokaster nga 100,000,000 lekë të programuara, u realizuar procedura e prokurimit me vlerën 83,112,740 lekë për vitin 2017, duke u kursyer një fond prej rreth 16,887,260 lekë lekë si rrjedhim i uljes se cmimit të objektit të programuar me cmimin e prokuruar. Ky objekt është në proces implementimi;
2. Upgrade i Sistemit të Përqendruara të Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike u programua në vlerën 14,000,000 lekë dhe u realizau në vlerën 8,274,000;
3. Blerje Pajisje IT për infrastrukturën e cctld.al e programuar në vlerën 8,200,000 lekë nu realizuar në vlerën 7,958,220 lekë;


¹¹ Në fondin e shpenzimeve të vitit 2016 është përfshire edhe objekti i investimit, procedura e prokurimit te cilit nisi qe ne vitin 2016 dhe perfundoi ne vitin 2017, i cili është në implementim

4. Blerje pajisje kompjuterike e programuar në vlerën 8,000,000 lekë u realizua në vlerën 7,903,020 lekë;
5. Blerje e Radiobaza digjitale dual band VHF/UHF per sektoret rajonale te monitorimit, në program u parashikua më një vlerë prej 950,000 lekë dhe u realizua në vlerën 936,000 lekë;
6. Upgrade i sistemit E – Arkiva u programua më vlerën 2,100,000 lekë dhe u realizua në vlerën 2,016,000 lekë;
7. Blerja e Sistemit të monitorimi të rrjetit LAN/WAN për QKMF dhe pikat në distancë u parashikua me vlerën 950,000 lekë dhe u realizua me vlerën 948,000 lekë;
8. Blerja e Sistemit audio për sallën e mbledhjeve të Këshillit Drejtues, u parashikuan në vlerën 800,000 lekë u realizua në vlerën 779,760 lekë;
9. Blerje e pajisje për zyra u parashikua në vlerën 900,000 mijë dhe u realizuar në vlerën 978,00 lekë;
10. Blerje pajisje të tjera u programua në vlerën 900,000 lekë dhe u realizuar në vlerën 982,260 lekë

Gjithashtu, gjatë vitit 2017 mbaroi shqyrtimi nga Gjykata e Lartë për ankimin e ofertës së objektit të investimit për “Zhvillimi i sistemit kombëtar të monitorimit të spektrit të frekuencave pajisjeve për stacion të thjeshtë Fiks monitorimi (SRFMS) në Shkoder dhe Vlore” dhe u zhvillua procedura e prokurimit duke u finalizuar me lidhje kontrate në vlerën 98,881,128 lekë, nga 100 milionë të programuara.

Në figurën më poshtë paraqitet realizimi i shpenzimeve për periudhën 2015-2017¹², si dhe përqindja e realizimit fakt ndaj programit.

FIGURA 5.3. REALIZIMI I FONDIT TË SHPENZIMEVE DHE PËRQINDJA E REALIZIMIT 2015-2017



Mbi tepricën e të ardhurave

Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2017 rezulton në shumën 61,646,970.00 lekë, si rezultat i diferencave nga pagesat e sipërmarrësve dhe mosrealizimit/kursimit të disa zërave

¹² Në realizimin e vitit 2016 është përfshirë edhe objekti i investimit, procedura e prokurimit të cilit nisi që në vitin 2016 dhe përfundoi në vitin 2017

të miratuar në fondin e shpenzimeve të AKEP. Teprica e akumuluar do të derdhet në Buxhetin e Shtetit sipas dispozitave që përcakton Ligji 9918/2008.

Mbi taksën e radiokomunikacionit

Në referencë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar si dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 06.10.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit” i ndryshuar, AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

Për vitin 2017 janë arkëtuar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit nga tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit shuma 518,348,159 lekë. AKEP ka punuar dhe ndjekur në vazhdimësi mbledhjen e tarifës së radiokomunikacionit, dhe e ka raportuar dhe derdhur atë në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë brenda afatit cdo muaj, sipas akteve ligjore në fuqi.

Të ardhurat e përfituara si agjent tatimor nga komisione në masën 5 % të shumës së derdhur në Buxhetin e Shtetit janë në vlerën 25,917,408 lekë. Të ardhurat e përfituara nga komisionet si agjent tatimor janë përdorur për shpërblimin e punonjësve në shumën 20,974,631 lekë dhe për blerje pajisje monitorimi në shumën 4,917,006 lekë.

Rritja e performancës dhe efektiviteti i realizimit të treguesve financiarë të AKEP

AKEP gjatë vitit 2017 ka punuar për rritjen e performancës dhe efektivitetin e realizimit të treguesve financiarë si dhe në administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare duke bërë:

- Kontabilizimin në kohë të veprimeve të arkës, bankës, magazinës për të ardhurat nga pagesat dhe shpenzimet që kryen institucioni;
- Mbyllja e bilancit financiar të vitit 2016, dhe dërgimin e tij brenda afateve ligjore në organet tatimore;
- Ndjekja e vazhdueshme e sipërmarrësve debitor për likuidimin e pagesave për AKEP dhe tarifën e radiokomunikacionit dhe bashkëpunim me organet tatimore;
- Informatizimi i llogaritjeve të pagesave dhe mundësimi on-line në faqen e internetit të AKEP, për sipërmarrësit me qëllim rritjen e transparencës dhe uljen e debitorëve;
- Llogaritjen, arkëtimin dhe derdhjen e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit në buxhetin e shtetit

6 STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT TË AKEP PËR VITIN 2018

Në kuadër të objektivave rregullatore, AKEP planifikon programin e tij të ardhshëm të aktiviteteve në përgjigje të nevojave të tregut, duke marrë parasysh prioritetet kryesore strategjike. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 29.12.2017 “Për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit të AKEP për vitin 2018” u miratua dokumenti “Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2018”.

Qëllimi i këtij dokumenti është që AKEP të përcaktojë fushat kryesore dhe prioritetet strategjike për vitin 2018 si dhe veprimet që do ndërmerren nga AKEP gjatë vitit 2018 për të përmbushur objektivat rregullatore të përcaktuara në legjislacionin për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare si dhe në politikat dhe strategjitë përkatëse sektoriale të qeverisë.

Ky dokument përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike ku do fokusohet puna e AKEP gjatë vitit 2018. AKEP do të punojë që gjatë vitit 2018 të ketë progres në katër fusha kryesore nëpërmjet prioriteteve strategjike të identifikuara për secilën fushë dhe masat specifike për realizimin e tyre, pra Planin e Veprimit të AKEP për vitin 2018.

Fushat Kryesore dhe Prioritetet Strategjike

Bazuar në ecurinë e sektorëve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare, problematikës së evidentuar në këto sektorë si dhe me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktuara në ligjet organike për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare si dhe në politikat dhe strategjitë përkatëse sektoriale të qeverisë, AKEP ka evidentuar katër fusha kyce ku duhet të fokusojë punën e tij gjatë vitit 2018:

1. Kushte të favorshme për Investitorët,
2. Nxitje e konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve të rrjeteve dhe ofruesve të shërbimeve,
3. Përfitimet për konsumatorët,
4. Efikasitet i brendshëm i AKEP dhe partneriteti me institucionet në vend.

Për secilën prej fushave të mësipërme AKEP ka evidentuar prioritetet strategjike dhe veprimet specifike që do të ndërmerren gjatë vitit 2018 për të bërë progres në secilën prej fushave kryesore. Skema e mëposhtme përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike për vitin 2018.

SKEMA 6.1: FUSHAT KRYESORE DHE PRIORITETET STRATEGJIKE TË PUNËS SË AKEP PËR VITIN 2018.

1. Kushte të favorshme për Investitorët

- Rregulla të qarta dhe të qëndrueshme në kohë për zhvillimin e hapur të infrastrukturës broadband.
- Nxitja e investimeve në infrastrukturen me Fiber Optike.
- Përshtetja e procedurave për vendim në dispozicion të operatorëve të spektit të pershtatshëm për shërbimet broadband.
- Mbështetja e iniciativave për zhvillim broadband në zonat komercialisht jo-tërheqëse.
- Nxitja e sigurisë së rrjeteve dhe informacionit në linjë me rregullat e BE për sigurinë kibernetike

2. Nxitje e konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve të rrjeteve dhe ofruesve të shërbimeve

- Përshtetja e procesit për përmbajtjen e rrethit përkatës të Analizave të tregjeve dhe përcaktimit të detyrimeve proporcionale.
- Identifikim i qarte dhe në kohë i sjelljeve strategjike të operatorëve të Operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse dhe veçanërisht për cmimet pajustificueshmerisht të uleta
- Analize e situatës me kompensimet ndërmjet operatorëve rishikim i masave rregullatore në këtë drejtim.
- Garantimi i Integritetit të dhenave që raportohen nga operatorët. Grumbullim edhe nga burime alternative dhe krahasim me praktiken me të mirë të industrisë.

3. Përfitimet për konsumatorët

- Portim brenda 24 orësh
- Mbështetja e veprimtarive të qeverisë për Roving zero me vendet fqinje dhe ulje e ndjeshme e tarifave roaming me vendet e Bashkimit Europian
- Përshtetja e procedurave për fillimin e operimit të skemës së Shërbimit Universal
- Mbrojtje e kujdeshme për përdoruesit me të ardhura shumë të uleta.
- Përqendrimi i përpjekjeve për arritjen e objektivave broadband (30mbit/sec për 100% të popullsisë dhe 100 mbit/sec për 50% të popullsisë).
- Integriteti i të dhenave të pajtimtarit; rishikim i situatës ekzistuese dhe sigurimi i saktësisë së plote të të dhenave të pajtimtareve.
- Mbulimi me shërbim celular në zona me dendësi të ulët dhe rritja e cilësisë së shërbimeve
- Masa për garantimin e Shërbimit Universal postar dhe cilësisë së shërbimeve postare

4. Efikasiteti i brendshëm AKEP dhe partneritetet me institucionet

- Garantimi i funksionimit ligjor dhe institucional të AKEP. Vlerësim i nevojës për amendime të legjislativës.
- Rritja e metejshme e kapaciteteve strategjike, menaxheriale dhe teknike të stafit të AKEP.
- Funksionim i hapur dhe transparent në përputhje me praktiken me të mirë rregullatore të BEREC/ERGP dhe vendeve të BE
- Bashkëpunim i ngushtë dhe arritje e koherencës së plote me rregullatorin ex-post, AK, dhe KMK
- Kontribut për rishikimin e strategjisë broadband për përshirjen e aksesit broadband në objektin e shërbimit universal

AKEP në dokumentin Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2018 ka dhënë në mënyrë të detajuar përshkrimin e fushave kryesore dhe prioriteteve strategjike për vitin 2018 si dhe veprimet specifike që do të ndërmerren nga AKEP për vitin 2018 dhe në disa raste për një periudhë afat-mesme deri afat-gjatë. AKEP ka parashikuar 53 veprime specifike dhe rezultatet e synuara të tyre sipas fushave dhe prioriteteve strategjike.